

PETRAQ RISTO

# VDEKJA E PALAÇOS

*tregime*

BIBLIOTEKA

814-32

R 79



814-32

1279.

Petraç

Risto

VDEKJA

E

PALAÇOS

BIBLIOTEKA E BRETANË  
 GJITHKASHTER  
 NR. 45/78

tregime

# Grindja në radio plazhi

Mbase ia rrit shumë vlerën një qendre të thjeshtë zëri kur e quaj radio, po ky përcaktim më tepër ishte i njerëzve që pushonin në plazh, se imi, që bëja punën e folësit

në mikrofon. Kisha mbaruar studimet e vitit të parë në degën e Gazetarisë dhe, si shumica e shokëve të mi studentë, në muajt e verës punoja si punëtor sezonal.

Një djalosh i gjatë, ezmer, nuk e di nga e mori vesh se unë flisja në mikrofon dhe m'u afrua. E quanin Resul. Pushonte në hotelin e vjetër që ngrihej pranë qendrës së zërit. Kisha botuar disa shkrime e cikle me poezi në gazetën kryeqytetë, kështu që ai e kishte mundësinë të ma bënte qejfin. Diskutoni për letërsinë, për shkrimtarët tanë të rinj. E kishte ves që gjatë bisedës, me njërin dorë, të majtën ose të djathtë, sipas rastit, kapte një tufëz të vogël flokësh dhe e zbriste nga balli në gojë. Kishte vetinë e çuditshme që të të ngjitej. Mbjaj mend si m'u ngjit edhe atëherë kur unë u njoha me shkrimtarin S., që në muajt e verës pushonte në një vilë të vogël njëkatëshe, diku pas hotel «Adriatikut». Novelat dhe romanet e viteve të fundit e kishin bërë tepër të njohur, megjithëse nuk ishte më shumë se tridhjetë e pesë vjeç. Unë çdo mëngjes dëgjoja të rrahurat e makinës së tij të shkrimit dhe ëndërroja për veprat e ardhshme të shkrimtarit. Kisha një lloj adhurimi për të. Doja ta njihja, po druhesha ta takoja. Isha vetëm njëzet vjeç.

Një mëngjes plazhi ishte mbuluar nga një mjegull e dendur. Zakonisht mëngjese-

ve bëja kontrolle të shpejta nëpër sektorët e plazhit. Mirëpo ai mëngjes tërë mjegull nuk ishte për kontrolle të tilla prozaike, ai ishte vetëm poezi e avulluar. Ecja i vetëm mbi ranishte, mes plepave që ishin trullosur nën baticën e njomë të mjegullës. Nuk dukej askush. Edhe zogjtë sikur kishin harruar të zgjoheshin. apo mbase ishin hutuar nga bukuria e plazhit nën mjegull, ose, kushedi, ruanin fytet këngëtare nga të ftohtët. Përpitmas, larg, përballë meje pashë të dilte nga mjegulla silueta e një njeriu. Kur u afrua, njoha shkrimtarin S. Sytë i lëviznin nga një kureshti e veçantë.

— Mirëmëngjes! — mora guximin dhe e përshëndeta.

— Mirëmëngjes! — ma ktheu dhe çuditërisht u ndal. — Poet? — më pyeti.

— Po, — iu përgjigja dhe ndjeva dridhjen e zakonshme prej emocioneve.

— Mëngjes i bukur, apo jo?

— Më i bukur i kam parë gjatë kësaj vere.

— Je durrsak?

— Po. Student në Tiranë.

— Për çfarë studion?

— Gazetari...

— Aha... Atëherë qenkemi kolegë. Haide shkoimë pimë një kafe tek «Iliria».

— Ju falemnderit! — i thashë.

U ktheva për kafe. Dëgjoheshin vetëm

valët e detit dhe cicërima e ndonjë zogu. Nuk mund ta prishja heshtjen. Kisha druajtje e më dukej sikur fjalët do të më ngatërroheshin. Pastaj gjërat që më vinin ndër mend nuk mund t'ia thosha shkrimtarit. Më dukej naive t'i tregoja se shpesh kisha përgjuar tak-taket e makinës së tij të shkrimit, apo se njëherë, para dy vjetësh, kisha shkruar një letër për të, madje e kisha mbyllur edhe në zarf, po natyrisht nuk e kisha postuar e nuk do ta nisja kurrë.

— Nga Durrësi erdhe sot? — më pyeti.

— Po, — iu përgjigja. — Punoj këtu, në qendrën e zërit.

— Shumë mirë ke bërë. Po si të quajnë?

— Petrit Stari.

— Më duket se të kam lexuar diçka. Po të them të drejtën konkretisht nuk më kujtohet.

Unë qesha. Pra, më kishte lexuar. Kjo nuk ishte gjë e vogël.

Tek «Iliria» ishin vetëm kamerierët dhe një plak që lexonte gazetën. Ne zumë një tryezë pranë banakut dhe porositëm kafet, të dv të rregullta. Papritmas, s'di se si, po si të kish dalë nga ekspresi i kafes, të kish zbritur nga mjegulla, përpara meje, dy metra larg tryezës, u shfaq Resuli. U bëra gati të fërkoja sytë për t'u bindur që nuk ishte një fanitje a një lojë mjegullore. Por ja, ai shpen-guar u afrua vërtet, i foli shkrimtarit në

emër, i zgjati dorën, mua më rrahu supet dhe, pa marrë leje, zuri vend. Shkrimtari e pa njëherë me një buzëqeshje të lehtë të papërcaktuar.

— Çfarë po punoni tani? — e pyeti Resuli.

— Rërën e plazhit, — bëri shaka shkrimtari duke gjerbur kafën dhe Resuli qeshi me të madhe.

— Bukur! Bukur! — tha dhe instinktivisht, me tre gishtërinjtë e pëllëmbës së majtë, kapi tufën e flokëve të zinj dhe e zgjati drejt buzëve.

Shkrimtari S. kish ulur sytë dhe diçka shikonte në syprinën prej fibre.

Resuli papritur u ngrit dhe shkoi te kamrieri.

— E ke shok? — më pyeti shkrimtari.

— Këtu më ka njohur. Ka disa ditë, — ia ktheva.

— Përpiqet të jetë praktik, — vërejti shkrimtari. — Tipa të tillë sot janë në modë.

Resuli erdhi shënd e verë, a thua se kish porositur të na sillnin në tryezë vetë lavdinë.

— Nga një fërnet tani në mëngjes nuk bënë keq, apo jo? — tha ai lirshëm.

— Në asnjë mënyrë jo! — ia preu shkrimtari! — Ju, po të doni, pini. Nuk kam dalë të trullosem, po të kthjellohem,

— Ashtu?! — tha Resuli me tre gish-  
tërinjtë të tufa e flokëve. — Po ti, Petrit,  
do?

— Jo, nuk pi.

— E po, po shkoj ta kthej porosinë, —  
tha dhe u ngrit përsëri për të folur me ka-  
merierin.

Kur u kthye, shkrimtari u ngrit, na tha  
«ditën e mirë!» dhe unë me Resulin mbetëm  
vetëm në tryezë.

— Është kokë e madhe, — tha Resuli.  
— Edhe pikën e alkoolit nuk pranon, ngaqë  
kërkon kthjelltësi mendimi. Po pse s'më ke  
thënë që e njihje?

— Nuk ka rënë fjala, — i thashë shkurt.  
Humori i mirë dhe poezia e atij mën-  
gjesi më ishin prishur.

## 2

Bora atë vit kishte mbaruar maturën  
dhe ashtu si unë, në muajt e verës, do të  
punonte si sporteliste tek «Adriatiku». Priste  
që të vazhdonte studimet në universitetin e  
Tiranës. Njohja jonë ishte disi e rastësishme.  
Bora atë ditë kishte marrë me vete dhe dja-  
lin e së motrës, Artanin trevjeçar, i cili sesi



ishte larguar nga hoteli dhe kishte humbur. Dy djem e kishin marrë dhe ma sollën te qendra e zërit. Dhoma ime atë ditë ishte kthyer në një çerdhe të vërtetë. Gjashtë fëmijë dhe Artani shtatë, qanin, më shikonin disi me frikë. Herë pas here i pyesja, ca më përgjigjeshin, kurse më të vegjlit, të hutuar, vetëm qanin. Kur sollën Artanin, e pyeta se me kë kish ardhur në plazh. Me tezen, më tha. Si e quajnë tezen? Bora. Kaq tha. Bëra lajmërimin në mikrofon:

«Vini re! Vini re! Në qendrën e zërit ndodhet Artani trevjeçar, i cili ka ardhur në plazh me tezen e tij, Borën. E interesuara të vijë ta marrë!»

Gjatë kohës që flisja në mikrofon, Artani ia shpërtheu së qarës. Bora erdhi me një frymë. Ishte vërtet e bukur. Pushtoi Artanin dhe m'i drejtoi sytë e kulluar.

— Falemnderit! — më tha. — Sa shumë fëmijë paskan humbur sot!

— Plazh i madh, — ia ktheva dhe guxova të bëja humor. — Rrezikohen të humbasin edhe të rriturit.

Ajo qeshi me gjithë shpirt.

— Punoj këtu pranë, — më tha, — sporteliste tek «Adriatiku».

— Shumë mirë. — i thashë. — Po të të humbë prapë Artani, ta sjell unë.

— Tani Artanin s'e lëshoj më nga dorë, po shiko se mos më humbë ndonjë turist,

— bëri shaka ajo. — Mirupafshim! Fa-  
lemnderit edhe një herë!

Ky qe takimi ynë i parë. Të nesërmen  
Bora erdhi përsëri. I kish blerë Artanit aku-  
llore. Unë rrija mbështetur te dera.

— A ka humbur ndonjë i rritur? — më  
pyeti duke u afruar.

— Ju jeni e para, — ia ktheva.

Biseduam disa minuta. Ajo më foli për  
dëshirën që të bëhej arkitekthe. Pastaj më  
tha se i pëlqente të lexonte veçanërisht pro-  
zën e gjatë. Ndenjëm afër gjysmë ore dhe  
gjatë kësaj kohe u miqësova edhe me Artan-  
nin, i cili kërkoi të qëndronte me mua.

Sapo doli Bora, në dhomë mbiu Resu-  
li.

— Ti nuk je shok i mirë, — më tha.

— E përse?!

— E para, sepse për njohjen me shkrim-  
tarin nuk më kishe folur: e dyta, edhe me  
këtë vajzën që sapo doli nuk më ke njohur.

U ndeza i tëri. Aq sa nuk e dëgjova kër-  
citjen e lehtë të çelësit të mikrofonit, që  
Artani e kishte lëvizur duke luajtur. Kështu  
që biseda, ose më saktë grindia ime me  
Resulin, u dha në altoparlantët e plazhit.  
Dialogu ynë ishte afërsisht ky:

·Unë: E ke gabim, Resul! Unë nuk kam  
ndonjë detyrim ndaj teje.

Ai: Janë detyrime shoku.

Unë: Më fal, por edhe shokë nuk jemi.

Ne vetëm pak ditë kemi që jemi njohur.

Ai: Megjithatë kemi diskutuar gjatë, ia kemi hapur zemrën njëri-tjetrit. Ose më saktë, unë ta kam hapur zemrën, kurse ti...

Unë: Kurse zemra ime rri gjithnjë e hapur, prandaj dhe ti ke hyrë në të disi harbutçe!

Ai: Ashtu?! Ti po më fyen.

Unë: Këtë e di ti. Je i çuditshëm. S'ke druajtje. Edhe atë ditë kur qeshë me shkrimtarin, pa pyetur hyre si pilaf.

Ai: Kush tha?... Unë edhe dje isha me shkrimtarin. Shëtitëm një copë herë dhe biseduam. Më pyeti dhe për ty. (Kjo ishte e papritur për mua. Pra Resuli kish arritur që të bisedonte sërish me shkrimtarin dhe kushedi se ç'broçkulla të tjera kish nxjerrë.)

Unë: Ashtu?!

Ai: Folëm gjatë. Kryesisht për letërsinë. Më pyeti për ty. Nuk është dukur, më tha. Unë heshtja. Nuk e dija se ti paske halle të tjera. Kjo Bora është e bukur, bijë drejtori...

Unë: I paske marrë vesh të gjitha, ma-

dje para meje! Po për ç'qëllime,  
vallë?

Ai: Për të shuar kuriozitetin e moshës.  
Mbase vjen në Tiranë dhe vitet stu-  
denteske i kalon si jo më mirë...

Nuk durova dot më, thirra:

— Maskara! Ik, shporru!

Ai nuk reagoi. Pikërisht në këtë çast  
vura re se ishte hapur mikrofoni. Ktheva  
çelësin dhe hodha shikimin nga dritarja, për  
të parë pushuesit shtrirë në rërë. Nië meso-  
burrë u ngrit dhe erdhi në drejtim të qend-  
rës së zërit duke thirrur:

— O dialë, hape radion se paska një  
dramë të bukur.

Rësuli, kur mori vesh se grindien tonë  
e kish dëgjuar tërë plazhi, ia plasi së qeshu-  
rës. Kurse unë u bëra dhé.

— Dil jashtë e mos të të shoh më këtu.  
more vesh?! — i thashë. — As nuk dua të  
di më nër ty.

— Si të duash, — ma ktheu. — kurse  
unë do shkoj të takohem me shkrimtarin.  
E kemi lënë të shihemi në orën dymbëdhje-  
të e shtatë.

Doli. Artani ishte trembur dhe zuri të  
kërkonte Borën.

— Mirë, eja të shkoimë te tezia. — i  
thashë dhe mbylla për pak kohë derën e  
radio plazhit.

Po ja që edhe Bora e kish dëgjuar gri-

ndjen tonë në radio, ndaj ishte skuqur e tëra e gati sa s'qante.

— Kush ishte ai tjetri? — më pyeti.

— Një maskara! — ia ktheva. — Ka vetëm dhjetë ditë që ia shoh surratin dhe më ka sjellë andralla sa për dhjetë vjet.

— Po nga e kish marrë vesh biografinë time?! Vërtet çuditem! — tha ajo.

Më vinte turp prej saj. Ne sapo qemë njohur.

### 3

Atë verë me Resulin nuk u takova më. Edhe ai nuk më ra në sy. Borës i doli e drejta e studimit për arkitekturë dhe nuk mbahej nga gëzimi.

— Jam e lumtur, Petrit, e lumtur vërtet!

Bora zuri vend në një nga konviktet e qytetit «Studenti», disi larg konviktit tim. Veçanërisht në javët e para të shkollës ne takoheshim shpesh, sepse fakultetet i kishim në të njëjtën ndërtesë, bisedonim, shkonim në kinema apo teatër. Megjithëse kishim më shumë se tre muaj që njiheshim, nuk guxoja t'ia shprehja dashurinë. Më dukej

sikur do të më zemërohej. U desh që të hy-  
nim për të parë një shfaqje në Teatrin e Ku-  
kullave, që mua të më zgjidhej gjuha. Ish-  
te një e shtunë e bukur, me diell. Ne u  
takuam në shëtitore, diku përballë hotel  
«Dajtit».

— A do të shkojmë sot në Durrës? —  
e pyeta.

— Patjetër, — ma ktheu. — Me trenin  
e dyshit.

— Duhet dhe tri orë. Ku të futemi?

— Shëtitim ose hyjmë në ndonjë lokal,  
— më tha ajo. — Të qeras unë.

— Jo, do të të qeras unë. Kam marrë  
një honorar nga «Zëri i rinisë», për një re-  
portazh.

Bëmë disa hapa. Bora dukej shumë e  
lehtë, gazmore. A thua ishte dhe ajo e da-  
shuruar!

— Kam një mendim, — tha Bora kur  
ndodheshim përballë ndërtesës së Teatrit  
të Kukullave, — hyjmë të shohim një shfa-  
qje me kukulla?

Megjithëse s'kisha qejf, nuk ia prisha.  
Dhe bëra mirë. Shfaqja ishte një përshtatje  
e baladës së Ago Ymerit. Megjithëse me  
kukulla, edhe Bora edhe unë e ndiqnim me  
ëndje. Agoja i burgosur i kërkonte me besë  
së bijës së mbretit të Spanjës ta linte të  
shkonte në Arbëri e të takohej dy minuta me  
nusen, që e priste prej nëntë vjetësh. «Po

afron dita e dasmës së saj, — i lutej, — sa të shkoj e t'i them se jam gjallë.» E bija e mbretit pranoi dhe Ago Ymeri rendte me kalë. Ishte një kalë i bukur butaforik, i cili hingëllinte sa herë që në qiellin e nxirë feksnin vetëtimat. Rrugë e gjatë. Ago Ymeri, me mjekrën mbuluar nga pluhuri, rendte duke i thirrur kalit, që ia kuptonte gjuhën dhe hallin.

— Kalë i bukur, — i pëshpërita Borës.

— Shumë, — tha ajo. — Është kali i besës. Kali i fjalës së dhënë.

— A ma jep dhe ti fjalën? — e pyeta si me shaka.

— Çfarë? — tha ajo e befasuar, me kokën kthyer nga unë.

Kisha hedhur një hap dhe duhej të hidhja tjetrin. Ago Ymeri hyri në disa udhë të njohura. Një erë e freskët ia përthau djer-sët e ballit. Pas pak përballë u dukën krush-qit dhe e hipur mbi kalë ishte nusja e tij, tashmë e bërë nuse për një tjetër.

— Të dua, Bora, — i thashë natyrshëm, — të dua!

Ajo ktheu përsëri kokën dhe më shikonte si të isha ndonjë i dehur. Ago Ymeri tërhoqi mënjane nusen, gjoja për t'i dhënë porosinë e Agos së vdekur.

— Petrit, po ti...

— Shiko sa bukur, — i thashë dhe bë-

ra me kokë nga skena, ku nusja përcolli  
krushqit dhe hipi në kalin e Agos.

— Edhe unë të dua, — tha Bora.

Përfitova ngaqë isha në rreshtin e fundit dhe e putha.

#### 4

Pas tre vjetësh u martova me Borën. Bëmë dasmën dhe shkuam për t'i kaluar ditët e muajit të mjaltit në Pogradec, buzë liqenit. Dhoma na qëlloi në një ndërtesë njëkatëshe, ngritur mes mollëve. Në të shtatë dhomat ishin vendosur çifte të sapomartuara. Ditë të bukura, me aromën e mollës së pjekur. Vendosa që të bëja një reportazh për gazetën ku isha emëruar. Pas një javë shkrimi u botua. Të gjashtë çiftet e tjera të ndërtesës sonë, natyrisht edhe Bora ime, e pëlqyen shumë. Pasditen e botimit të shkrimit shkuam ta festonim në turizmin e Pogradecit. Pikërisht atje m'u shfaq Resuli.

— Urime, urime, Petrit! Një shkrim i mrekullueshëm! Le që ti çdo shkrim e ke pasur të shkëlqyer.

— Lëri furçat! — ia ktheva. — Po ti këtu?



— Verë, — më tha. — Një herë në Durrës, një herë në Vlorë, një herë në Pogradec. Sa je beqar, mos u kurse... Po ti, qenke martuar, ëë?

— Siç e sheh, — ia ktheva.

— Duhej të më kishe ftuar në dasmë, — më tha. — Ajo që ndodhi tre vjet më parë, ndodhi.

— Nuk më shkoi në mendje, — i thashë shkurt, — pastaj, ne jemi shumë larg njëri-tjetrit, nuk mund të jemi as shokë.

— Atëherë ngjatjeta! — tha ai dhe u largua.

Pavarësisht nga takimi i papritur me Resulin, mbrëmja jonë kaloi shkëlqyeshëm. Mes shakave e romuzeve, treguam historitë e njohjeve me bashkëshortët. Unë tregova për njohjen me Borën në radio plazhi, për grindjen me Resulin, grindje që u dha në altoparlant në tërë territorin e plazhit. Çiftet dëgjonin dhe qeshnin me të madhe.

— Mos ishte Resuli ai që takove? — më pyeti Bora.

— Ai qe.



Mirëpo ndodhi që pikërisht ky Resuli, pesë vjet pas grindjes sonë në radio plazhi, u bë shefi im. Si ia arriti kësaj, nuk ka aspak rëndësi, po mua nuk më erdhi mirë që ai do të më rrinte mbi kokë. Më e keqja ishte se me ato pak shkrime që kish botuar andej-këndej tregonte se ishte një shkruer mediokër. Për krijuesin nuk është e lehtë kur ka mbi krye një të tillë. Zakonin e futjes së flokëve në gojë e kish rralluar, po nuk e kish hequr. Ne silleshim shumë ftohtë me njëri-tjetrin. Vetëm i dorëzoja shkrimet, merrja orientime për probleme që ishin ngritur në kolegjiun, apo në ndonjë mbledhje sektori.

Një ditë, kur Resuli s'kish veçse një muaj që qe emëruar shef sektori, më thirri në zyrë. Kishte vërejtje për një shkrim, mirëpo më fliste me një ton të fryrë, a thua se donte të dukej para ndonjë të treti. (Vërtet ndonjë të treti!)

— Shumë shkrim i dobët! Jashtëzakonisht keq! Vërtet çuditë. Me sa duket, këto kohët e fundit e ke lëshuar shumë dorën.

— Mos shkoni kaq larg, — i thashë. — Ky shkrim edhe mund të mos ju pëlqejë, po për shkrimet e tjera s'është mirë të flisni nxituar.

— Morë Petrit, — toni qe i ashpër, — unë jam shefi yt dhe dua të më dëgjosh deri në fund, pa mendjemadhësi, kupton? Megjithatë, ik, ik, kundërshtimet e tua do t'i bëj problem në kolegjiun, deri te kryeredaktori.

— Bëj ç'të duash! — u nxeha. — Me ty asnjëherë nuk do të merrem vesh!

— Jashtë! Jashtë! — ulëriti.

— Natyrisht që do të dal, — i thashë dhe përplasa derën pas vetes.

Prisja ta bënte vërtet problem «kundërshtimin» tim, po ditët kaluan të qeta. Mbase është bërë i arsyeshëm dhe nuk do që ta prishë të ashtuquajturën shoqëri të vjetër, më thosh Bora, por unë s'kisha atë mendje. Ai njeri sikur më kishte frikë. Edhe ato ulërimat e tij sesi më dukeshin, tepër artificiale. Më kumbojnë në vesh edhe tani.

I tregova shokut të zyrës, Alfredit, që mbulonte rubrikën e shëndetësisë.

— Mos e vra mendjen, — më qetësoi. — Tipa bosh si ai nuk arrijnë të livadhysin në redaksinë tonë.

U qetësova. Marrëdhëniet e mia me Resulin sikur u normalizuan, shkrimet i dorëzoja në kohë e me cilësi dhe ai, pa ndërruar pamjen prej zyrtari, më shikonte në sy me një qesëndi të lehtë dhe mërmëriste një «mirë» nën buzë.

Një pasdite vonë u ktheva në redaksi për një punë. Ngjita shkallët dhe, sapo hyra në korridorin e gjerë, dëgjova një zë. Kanë ndezur radion, mendova. Bëra disa hapa dhe vura re se drita e zyrës së Resultit ishte ndezur. Zëri vinte pikërisht nga zyra e tij.

Ndala i shtangur.

«More Petrit... shefi yt!... Kupton... problem... Jashtë! ... Jashtë!»

Fjalët e mia s'i dëgjova. Duhej t'i kishte fshirë. E mëshirova. Pashë nga xhami mbi derë dhe shqova Resulin të kapardisur në kolltukun e tij, me magnetofonin e vockël japonez mbi tryezë. Pra ai e kish provokuar atë grindje me paramendim, për të incizuar zemërimin dhe prepotencën e tij. Dhe kjo i jepte kënaqësi.

Sesi më erdhi, megjithatë nuk bëra asnjë veprim. Çudi, vërtet çudi me këtë tip. Në sy kisha shefin tim të mjerë, që kënaqej me atë arrogancë të incizuar.

— Më mirë ta kishe hapur derën dhe t'ia kishe përplasur në fytyrë, — u zemërua Bora.

— Kulmi, ka lënë të incizuar vetëm zërin e tij, ato britma që ia përkëdhelin se-drën.

— Qenka vërtetë i lig! — thā Bora. —  
Megjithatë ti mos e lër me kaq.

Atë natë nuk më zuri gjumi. Fytyra e  
Resultit më shfaqej në forma të ndryshme,  
gjithnjë të shformuara.

## 7

Por e papritura më e madhe për mua  
ishte kur në gazetën tonë u botua një shkrim  
i shkurtër i një studenteje, me vërejtje për  
librin e ri të shkrimtarit S. Shkrimi bëri  
bujë. E keqja ishte se, siç mësova më vonë,  
studentja ishte shtyrë ta bënte shkrimin,  
ose më saktë, kishte pranuar të vinte fir-  
mën poshtë një kritike të daktilografuar.  
Dhe gjithë këtë e kish thurur Resuli, i cili  
vazhdonte të mos i ndahej shkrimtarit të  
njohur.

E takova shkrimtarin te «Tirana» dy di-  
të pas botimit të shkrimit.

— Hajde. ulu. — më ftoi. — U bënë  
kaq kohë që s'jemi parë. Vetëm në televizor  
të kam parë dy-tri herë. Po si je, mirë?

— Falemnderit, — i thashë. — Ju, si  
jeni?

— Jo keq. Po ai shoku, Resuli, doli i  
pabesë.

— Unë nuk e njoh shumë, — i thashë.

— Përkundrazi. Më duket se ti e njohë më mirë se unë, — ma priti shkrimtari. — Mirëpo, për dreq, unë nuk arrij ta largoj.

— S'të ndahet ai. Bile kjo është cilësia e tij e rrallë, — i thashë.

— Dhe mbase e vetmja, — qeshi ai. — Ti tani e ke shef, si sillet?

Rrudha buzët.

— Më duket hakmarrës, — shtova pas pak.

— Ruaju prej tij.

— Pikërisht kjo nuk më pëlqen, që të ruhem prej tij, — thashë disi i ndezur, — sepse ai duhet të më ruhet mua, sepse ai është i lig.

— Është një krimb. Dije prej meje. Por e kuptova vonë, pardje, kur pashë të botuar atë shkrim të kurdisur prej tij, — foli i irrituar shkrimtari.

— Nga e morët vesh se e ka kurdisur Resuli? — pyeta.

— Nga autorja. Më telefonoi në shtëpi. Qe penduar. Nga zëri kuptova që ishte e ngashëryer. Ja, pra, me mua rri e bisedon herë pas here, kurse prapa krahëve... Megjithatë s'mërzitem unë, sepse libri është pëlqyer. Shefi yt s'është treguar as i mençur, është ngutur.

Ashtu i papërmbajtur siç isha, i tregova shkrimtarit historinë e grindjes në radio pla-

zhi dhe atë hakmarrjen e vonuar të Resultit,  
i cili kish incizuar fshehurazi e me para-  
mendim një debat të rëndomtë redaksie.

Shkrimtari tundi kokën.

— Ja që paska dhe tipa të tillë. Petrit,  
nesër do të vij te ju në redaksi, do të takoj  
kryeredaktorin.

Unë nuk fola. Isha i bindur se një ditë  
do t'i dilte boja. Dhe ja, s'vonoj.

Jahti i bardhe

...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...  
...the ... of ...



## Jahti i bardhë

Jahti i bardhë, me emrin e burrit të saj të porsavdekur, vazhdonte të qëndronte poshtë në bregun shkëmbor dhe ajo, e mbyllur në një nga dhomat luksoze të kështjellës, e shikonte me nostalgji të veçantë, sikur ajo anije të ishte materializim i shpirtit të

të shoqit, Maksimilianit, e shpirtit të tij të bardhë, si shkumë dallge. Shumë shoqëri detare, veçanërisht të Mesdheut, kërkonin t'ia blinin. Megjithëse kishte kundërshtuar, në thellësi një zë i brendshëm e nxiste ta shiste. Si ta shiste shpirtin e tij?! «O zot, ç'mendoj dhe unë! Këto marrëzira tregojnë se jam tepër e lodhur.» E lodhur vërtet, sepse, qëkurse i vdiq i shoqi, hija e tij vërtitej nëpër reliktet e kështjellës dhe ja tani edhe jahti me emrin e tij. I shoqi e kishte dashur shumë detin, aq sa bëhej xheloze, sepse, kur largohej në lundrim, ai harrohej i ndezur nga ndjenja aventurore. Ndjaj jo rrallë asaj i kishte ndodhur që po nga dritarja e kësaj dhome e hidhte shikimin pritës larg, atje ku qielli puthej me detin e ku anijet dukeshin si vizatime të rëndomta fëmijësh. Ishte përpekur të vizatonte dhe jahtin e Maksimilianit, por ato ishin thjesht mirazhe malli. Shpesh iahti ankorohej kur ajo nuk e priste. Maksimiliani hynte befasishëm në dhomë dhe si në një lojë lumturie e merrte të shoqen në krahët e fuqishëm. «Ti je anija më e bukur, kurse unë jam deti», i thoshte ai dhe ky ishte për të komplimenti më i rrallë. «Ti je anija më e bukur»... Ja pra, nuk duhej ta shiste jahtin. Po vendoste?!

Hoqi shikimin nga bregu shkëmbor dhe u ul në poltronën e rehatshme, përballë letrave të shumta, të cilat kërkonin t'ia blinin

jahtin e bukur, nga më të bujshmit në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Mori dhe një herë në dorë njërën nga letrat që e kish lexuar pak më parë dhe ndali shikimin te fjalët që ajo vetë i kishte nënvizuar: *Jemi të bindur, zonjë e nderuar, se ju keni dëshirë që jahti i mrekullueshëm i bashkëshortit tuaj të vazhdojë lundrimin si një amanet i bardhë, i bardhë, Si një amanet i bardhë, i bardhë...* Bukur e kishin shkruar! Këto fjalë e kishin joshur, madje e kishin ngacmuar më shumë sesa duhej. Pa autorin, ishte një tregtar nga një vend i vogël buzë Adriatikut, që, ashtu si i shoqi, dukej i marrës pas lundrimit. Këtë e tregonte dhe cmimi i lartë që ai ofronte për anijen. Letra, paratë, kishin vërtet dicka magnetike. Vëcanërisht ajo letër e bukur. Jahtin do t'ia shiste tregtarit shqiptar. Thirri njërin nga sekretarët e pallatit dhe i tha shkurt:

— Vendosa që jahtin t'ia shes këtë. Dhe i zgjati letrën me adresën e saktë, megjithëse s'qe nevoja fare për adresën. Tregtari shkodran, bashkë me një ekuipazh të vogël, kishte ditë që vërtitej në bregun e huaj, pranë jahtit të mrekullueshëm. Ndaj të nesërmen, pasi zbrazi kuletën, tregtari u bë pronar i «Maksimilianit».

Pronari i shoqërisë së lundrimit detar «Llojd Triestina» gati u çmend kur e lajmëruan se «Maksimilianin» e kishte blerë tregtari shkodran Zef Zadrimea.

— Çuditëm me atë budallagen e Haub-sburgëve! — shau ai, — si ia dorëzon anijen një tregtari shqiptar, i cili nga injoranca ka për ta shkatërruar brenda vitit.

Lajmësi, Salvadore Asti, një anëtar i shoqërisë lundruese, heshtte dhe, fshehurazi pronarit, vuri lehtë buzën në gaz. Ai ishte një specialist i mirë anijesh, mbase më i miri, dhe natyrisht e njihnte tregtarin shkodran, e dinte se ç'pasion dallgëmadh kishte Zef Zadrimea për detin dhe anijet. Ato ditë pranë kështjellës që vërtitur edhe Salvadorja, që përpjekur dhe ai të joshte njerëzit e kështjellës, po nuk ia kishte arritur. Vejusha kishte vendosur dhe shkodrani kishte fituar.

— Shuma që pagoi Zef Zadrimea, ishte tepër e madhe, zotëri, — i tha Salvadorja padronit. — Po nuk duhet të kenë qenë vetëm paratë që e joshën vejushën. Për këtë jam i bindur, sepse, në fund të fundit, ajo do të kishte një lloj gëzimi dhe sigurie që

«Maksimilianin» e shtrenjtë t'ia shiste një shoqërie serioze siç është kjo jona.

— Atëherë? — u nxeh pronari i shoqërisë dhe mori krejt kot në dorë stilografin e trashë. — Fakti që jahti «Maksimilian» do të lundrojë nëpër dete me ekuipazh shqiptar, do të cenojë autoritetin e shoqërisë sonë. Pikërisht kësaj ia kam frikën.

Stilografi i madh sërish nisi vërtitjen mes gishtërinjve të nervozuar.

— Megjithatë një jaht, sado i bukur, nuk mund të konkurrojë dot një shoqëri të madhe lundrimi, me dhjetëra e dhjetëra anije. Kjo është më se e kuptueshme.

— Megjithatë në këtë rast ai fitoi.

Salvadorja vazhdoi me qetësi:

— E rëndësishme është që ne jemi më të fuqishëm. Pastaj shohim e bëjmë. Deti bën çudira.

Pronari e la stilografin mbi syprinën e shkëlqyer të tryezës së madhe, hoqi syzet dhe ashtu, i çarmatosur, përsëriti fjalët e fundit të Salvadores:

— Vërtet, deti bën çudira...

Kështu u shua përkohësisht shqetësimi i pronarit.

Zef Zadrimea, pronari i «Maksimilianit», ia besoi jahtin një mikut të tij, kapitenit të njohur Lec Tërpana, i cili kishte bërë emër për zotësinë në trajtimin e anijeve.

«Anija duhet të shkëlqejë si lüstrafin», thoshte Leci me shaka dhe tregtari ia pëlqente pa masë këtë shprehje. Jahtit ia ndërruan emrin me propozimin e kapitenit. Në bashin e rrumbullakët detarët shkruan më ca shkronja ngjyrë floriri emrin e ri «Zadrimea». Nuk është mirë, kish thënë kapiteni, që ne shqiptarët të kemi një anije me emrin e një perandori të huaj. Pronari i jahtit tanimë je ti, Zef Zadrimea, dhe me mallin tënd bën ç'të duash. Ke të drejtë, ashtu le të bëhet, ta quajmë «Zadrimea», ia kishte kthyer tregtari, të cilit i ishte bërë zemra mal.

Për jahtin e bukur natyrisht që Zefi bëri një reklamë të madhe. S'ishte pak një jaht, që dikur e kishte përdorur një perandor! Dhe reklama i dha shumë shpirt «Zadrimës», e, si rrjedhojë, edhe xhepave të pronarit të ri. Gati në çdo lundrim të jahtit, veçanërisht kur deti ishte i bukur, bunacë, tregtari kishte dëshirë të lundronte e shpesh përzihej në bisedat e udhëta-

rëve të zakonshëm apo të komisionerëve të ndryshëm.

Gjatë një lundrimi nga Tripoli për në Maltë një komisioner italian i tregoi për zemërimin e pronarit të shoqërisë «Llojd Triestina».

— Ky zemërim më kënaq pa masë, — tha tërë qejf Zef Zadrime. — Ju nuk e kuptoni se ç'kam hequr për ta blerë këtë mrekulli lundruese.

— Vërtet? — pyeti i qetë komisioneri me vështrim të ngulur tej në hapësirën ngjyrë hiri.

— S'ishte e lehtë, zotëri, si të ta them. Ja, përfytyro një lukuni ujqish që vërtiten rreth një mjellme.

— Atëherë si ia arritët?! — tha komisioneri.

— Me para, zotëri.

— Paratë, mirë, janë kryesorja, po më shumë para se ju ka «Llojd Triestina».

— Ashtu vërtet. Po mua më hipi në kokë dhe vura një shumë tepër të madhe...

Zef Zadrime heshti. Iu duk se kishte folur ca si shumë.

Komisioneri, i cili e njihte natyrën e hedhur e të pasionuar të tregtarit shkodran, mendoi t'ia jepte një këshillë dhe me sy të picërruar i tha:

— Jahti vërtet është i mrekullueshëm,

por mos harro se peshku i madh e ha të voglin. Ruaju nga «Llojd Triestina»!

Zef Zadrime shtangu. Nuk dinte si t'i merrte këto fjalë, këshillë miqësore, apo kërcënim të pronarit të shoqërisë «Llojd Triestina», që ia kishte besuar komisionerit.

— Më këshilloni si dashamir?

— Natyrisht, si mik, — tha komisioneri dhe u ngrit e u mbështet lehtë në bandën anësore të jahtit.

Edhe Zef Zadrime u ngrit. Iu duk vetja si mbi një det helmi. Pikërisht kjo nuk i kishte shkuar në mendje. Nxitoi për te dhoma e kapiten Lecit dhe i bisedoi me të të gjitha.

— Mos u tremb, — e qetësoi kapiteni, — nuk është e lehtë të zhdukësh një anije.

Po dhe fjalët e kapitenit nuk ia fashitën dot frikën tregtarit. Që nga ajo ditë Zef Zadrime e pushtoi një ndjenjë e çuditshme shqetësimi, madje i shpeshtoi lundrimet me jaht edhe në ditët e netët me mot të keq, aq sa me maninë e tij bëhej i bezdisshëm për ekuipazhin.

Kapiteni deri diku e justifikonte këtë mani, sepse pabesitë detare as nuk kishin qenë e as ishin të pakta, përkundrazi. Megjithatë nuk ishte mirë që kjo frikë të merrte përmasa të mëdha, e aq më keq t'i shkonte në vesh shoqërisë së huaj. Këtë ia tha edhe Zef Zadrime dhe tregtari, pasi e dë-



gjoi me vëmendje, e vari vath në vesh. Po, megjithëse i rralloi lundrimet, nuk harronte që herë pas here të porosiste Lec Tërpanën e ndonjëherë edhe detarët e tjerë që të ruheshin, të ruheshin, vetëm të ruheshin nga pabesitë e shoqërisë së huaj.

#### 4

«Llojd Triestina» për një kohë të gjatë nuk u ndje. Siç dukej, pronari i shoqërisë priste që deti ta bënte vetë çudinë, por, kur pa që dallgët nuk e bënë dot çudinë e tyre, nisi të mendonte seriozisht.

«Zadrime» vazhdonte të shkëlqente si ditën e parë. Kapiteni Lec Tërpana ishte bërë i njohur kudo për zotësinë e tij e në mënyrë të veçantë për merakun në mirëmbajtjen e jahtit. Anija kishte bërë mijëra milje, kishte mbajtur me mijëra udhëtarë dhe të gjithë kishin mbetur të kënaqur nga lundrimi i rehatshëm.

Pas çdo lundrimi anijen e vizitonin specialistë, lundërtarë të pasionuar apo dhe kursehtarë, të cilët nuk kurseheshin së lavdëruari anijen, ekuipazhin, e natyrisht kapitenin merakli. Lec Tërpana që kthyer në si-

nomim të atij skafi të bukur. Kapiteni kish-  
te pesë vjet që lundronte me atë anije e  
herë-herë i dukej sikur kish një shekull me  
të, herë-herë vetëm pesë ditë. Dhe këtë nuk  
dinte si ta shpjegonte. Jo rrallë i kujtohe-  
shin porositë e tregtarit dhe nuk harronte  
t'i këshillonte detarët që t'i bënin sytë ka-  
tër. Detarët e dëgjonin, po ndonjëherë edhe  
mërziteshin aq, sa nisën të mendonin se ka-  
piteni po lajthiste si pronari, nga dashuria  
e madhe për atë anije.

Mirëpo me gjithë kujdesin dhe porositë,  
e keqja u ngjit një ditë në anije. Në një port  
të Afrikës hipi dhe një agjent i fshehtë i  
«Llojd Triestinës». Quhej Simone. Qëllimi i  
keq dihej vetëm prej tij. Ashtu siç kishte  
biseduar me Salvadore Astin, agjenti u për-  
poq të zbulonte pikat e dobëta të ekuipazhit,  
ata tipa që, me karakterin e tyre të lëkun-  
dur, bien më shpejt për e grepave të artë. Po  
tipa të tillë vështirë të gjendeshin te «Za-  
drima» e Lec Tërpanës. Më në fund, kur do  
të qëndronin në një nga portet e Italisë së  
Jugut, agjentit i ra në sy një detar që mba-  
hej si qejfli pijesh e femrash e që, siç thosh-  
te vetë, shpesh paratë i bënte rrush e ku-  
mbulla nëpër mejhane. Agjenti zuri ca mi-  
qësi me këtë detar që shokët e thërritnin  
«qejfliu». Natën para se të ankoronin në por-  
tin e vogël. Simonia dhe Qejfliu u ngjitën lart  
në verandën e vogël, të mbuluar me një

tendë ngjyrë deti. Ishte fillim vere dhe gjithçka deti, qielli, ajri ta mbushnin gjoksin me një qetësi të paqtë. Thuajse të gjithë udhëtarët vërtiteshin në kuvertë për të soditur atë muzg të magjishëm.

— Natë e bukur, — tha Simonia. — Nuk do të ishte keq të pinim diçka. Kam në valixhe dy shishe verë nga më e mira.

— Me gjithë qejf, — pranoi detari, — veç me një kusht, të pimë pak më vonë në kabinën tënde. Nuk dua që kapiteni dhe shokët të më shohin që pi me një të huaj.

— Ashtu? E keni të ndaluar!... Më falni, po nuk e dija, — iu kthye tjetri. — Po të doni, qëndrojmë dhe këtu...

— Nuk është keq ta provojmë atë verën tuaj, — ngulmoi Qejfliu.

— Mirë, pastaj zbresim në kabinën time.

Qëndruan dhjetë minuta në verandën e vogël dhe, kur deti nisi të sillte pak erë të freskët, ata u ngritën dhe, pa u ndier, hynë në kabinën e Simonës. Vera ishte vërtet e mirë. Qejfliu piu edhe gjysmën e shishes së Simonës dhe, thuajse i dehur, filloi të fliste çfarë i shkreppte në mendje. Italiani dhelparak e ngacmonte me kujdes.

— Mbase mburrem t'ju them, por unë, mik i dashur, jam mjeshtër për pijet... I kam provuar të gjitha pijet kudo, në Egjipt, në Greqi, në Itali, në Stamboll... kudo...

— Po femrat?

— Oh, natyrisht, dhe femrat. Kur kam  
pirë, femrat gjithnjë më kanë shërbyer si  
meze... Ha, ha, ha!... Madje, duhet ta dish se  
këtu shokët më quajnë «Qejfli»...

— Qejfli? — ia bënte Simonia. — Kjo  
qenka e bukur, ha, ha, ha!... Po kjo, dome-  
thënë pijet, femrat, mos të kanë penguar në  
punë?

— O, jo, Simone, bile, kur pi, unë jam  
në formë më të mirë sesa kur jam esëll. Pa  
mburrje, jam mekanik shumë i mirë, mun-  
det më i miri në këtë jaht të bukur... Veç,  
ta lëmë këtu mes nesh, në këto dy vite jemi  
lodhur shumë, veçanërisht unë...

— Po pse?

— Sepse kapiteni, ta lëmë këtu mes  
nesh, po kapiteni ynë dhe pronari i anijes...  
mos më tradhto, Simone... janë tepër të da-  
shuruar me jahtin... E ruajnë...

— Kjo s'është gjë e keqe, përkundrazi...

— Eh, vëlla, mirë thua ti, s'e kanë keq-  
po ec e lyej e vajis çdo ditë, kështu po na  
kalon jeta...

— I lëmë këto tani?... — tha Simonia.

— Po për çfarë të flasim? — gogësinte  
Qejfliu.

— Për pijet, për femrat... Ja, në këtë  
qytet, ku do të hidhni spirancë, është një  
klub nate i mrekullueshëm, me femra nga  
kombësi të ndryshme...

— E di, e di, — ia ktheu Qejfliu. — Do

methënë ti, Simone, më fton në atë klub?

— Me gjithë qejf!

Pasi hodhën spirancën në portin italian, bashkë me disa detarë të tjerë dhe Qejfliu doli për të kaluar pak kohë në qytet. Takimin me Simonen e kishin lënë në klubin e natës. Atmosfera në klub ishte ndezur si rrallëherë dhe detari qejfli mezi e gjeti Simonen xhentil.

— Këtu qenka parajsa! — tha Qejfliu duke u afruar.

— Muzikë dehëse, vërtet. Çfarë do të pish? — tha Simonia.

— Nuk do të ishte keq pak uiski.

— Uiski! — porositi Simonia dhe kamerieri nxitoi drejt banakut.

— Kam qenë dhe një herë këtu, — tha Qejfliu, — veç nuk ka pasur kaq zhurmë.

— Ti më pëlgen si tip, — u hodh Simonia, — dhe unë dua të të ndihmoj.

— Të më ndihmosh? Në ç'kuptim? Femrat unë i gjej vetë, në moshë nuk jam dhe kaq i thyer, apo jo...

— O, nuk e kisha fjalën thjesht te femrat, po te gjithçka. Për shembull, ty do të të interesonte që të kishe parâ sa për të blerë një motovelerë të vogël!

Qejfliu fërshëlleu.

— Do të ishte mrekullia vetë! Kjo është një ëndërr për çdo detar, — tha ai dhe u përkul pak mbi tryezë, me sy të përqendruar te ky bamirës.

— Vetëm që duhet të më ndihmosh, —  
tha Simonia.

— Jam gati. Në ç'mënyrë?

Agjenti e parandjeu suksesin e hapave të hedhur. Detari i «Zadrimës» patjetër do të ngecte në grepin e artë.

— Nuk do të më ndihmosh thjesht mua, po një grup njerëzish.

— Kontrabandë?!... Nuk kam mundësi... Kaniteni...

— Jo, nuk bëhet fjalë për mall kontra-  
bandë. Diçka tjetër. Ti dy orë më parë më  
fole për jahtin...

Simonia e ndërpreu fjalën me dashje,  
për të parë si do të reagonte tjetri. Qejfliu  
u gëlltit. Molla e Adamit zuri t'i ngrihej e  
t'i ulej. Vetëm tani i kish rënë në të. Dome-  
thënë ky Simonia, ky bamirës, kërkonte  
ndihmë për asgjësimin e jahtit. Ç'të bënte?  
Si të vepronte? Dhe i premtonte një shumë  
të majme sa për të blerë një motovelerë.  
S'ishte pak, ai do të bëhej zot i një anijeje.

Erdhën gotat e uiskit. Simonia mori të  
tijën dhe e çiku pak me të Qejfliut. Detari  
ngriti sytë, i picërroi sikur deshi të thithte  
brenda retinës tërë prapësitë e tjetrit, kroi  
njëherë kokën me gishtërinjtë jo shumë të  
pastër, pastaj po me atë dorë mori gotën e  
uiskit.

— Paske qenë djall, Simone. Më duket  
se më fute në thes...

— Si duket, e merr me mend përse do të na ndihmosh? — pyeti agjenti.

— Një tjetër do ta kishte marrë vesh më parë, mbase që kur biseduam në kabinën tënde. Veç duhet thënë troç: është shumë e vështirë ta zhdukësh jahtin.

— Pse?! — pyeti Simonia.

— Sepse kapiteni dhe të tjerët e ruajnë si sytë e ballit.

— Do t'ua gjejmë dhe atyre. Rëndësia ka që ti të jesh kërah nesh.

— Po paratë për motovelerën... — e pveti Qeifliu dhe ndjeu diçka t'i dridhej nën gjoks, mbase në zemër.

— Paratë do të t'i japim në dorë, përpara se të veprosh.

— Po unë, i vetëm, kuptohet, nuk bëj dot gjë... Ata janë shumë...

— Dó të të ndihmojmë ne... Nesër gjej kohë dhe ktheu pak këtu, në klub.

— Në c'orë, Simone?

— Në pesë, a je i lirë?

— Besoj se po.

## 5

Nuk ishin larguar as tri milje nga porti i huaj, kur në sallën e vogël të makinerisë

shpërtheu uji. Kapiteni Lec Tërpana dha alarmin. Dridhej nga një ndjenjë zemërimi që nuk ia përcaktonte dot kahun, drejt të tjerëve apo drejt vetes. E çara e skafit ishte e madhe, patjetër e përgatitur më parë, mendoi. Ah, gabove, gabove, Lec Tërpana! «Llojd Triestina» ia arriti qëllimit. Kishin pënuar hilen pikërisht në portin e vogël italian. Detarët përpiqeshin ta bllokonin të çarën e skafit, por ishte e pamundur. Uji nuk mposhtej, vërshonte si një përbindësh.

— Të kthehem, kapiten, — i tha njëri nga detarët.

— Është e pamundur, — foli Lec Tërpana me një zë të ngashëryer. — Ata i kanë menduar të gjitha. Me këtë vërshim uji nuk bëjmë dot gjë.

Zef Zadrina kishte pasur të drejtë që i porosiste gjithnjë. Tani që anija e bukur «si lustrafin i vërtetë» bëhej gati të binte në fund të detit, Lec Tërpana e ndiente veten si të kapur rob nga turpi e nga vdekja. Një fund i papritur, madje në një mot të mirë. Në sallën e makinerisë ishin të gjithë, përveç timonierit, i cili më kot kishte kthyer timonin për në portin e vogël. Lec Tërpana s'e kishte ndier veten më ngushtë se ato çaste. Kaloi shikimin me radhë te fytyrat e detarëve. Mes tyre patjetër duhej të ishte ai që kishte ndihmuar vrasësit e anijes. Po ci-



— Çfarë, kapiten? — e pyeti njëri.

Kapiteni kuptoi që pyetjen e tij e kishte bërë me zë.

— Asgjë, asgjë, — tha. — Bëhuni gati të braktisni anijen. Hipni në barka!

Detarët kishin ngrirë përballë tij. Të gjithë ishin të tronditur.

— Qejfli, dhe ti, Jani, — foli kapiteni.

— Urdhëro, kapiten, — folën të dy detarët njëzëri.

— Ju ishit mbrëmë rojë shërbimi. A vutë re ndonjë njeri të dyshimtë, ndonjë zhurmë...

— Jo, kapiten, — tha Jani. — Unë u solla më shumë në kuzhinë...

— As unë, — tha Qejfliu. — Po të kisha parë, patjetër do të kisha raportuar, kapiten... — ndërsa ndiente djersët e ftohta t'ia vishnin tërë trupin. Iu duk se e kapërcëu rrezikun.

— Qejfli, po atë italianin e huaj, që të shodëroi në anije dhe në klub, ku e gjete? — pyeti papritmas Gaci, njëri prej detarëve më të vjetër të jahtit.

Qejfliu u bë dyllë i verdhë. Nuk e priste këtë goditje.

— Udhëtar i zakonshëm, Gac, si gjithë të tjerët, — u përgjigj. — Miq rruge siç ke pasur ti edhe të tjerët...

Lec Tërpana e thithi të vërtetën. Intuita nuk e gabonte. veçanërisht tani, kur po vdi-

ste anija e mbase edhe vetë. Duhej të luante zarin e fundit, të provokonte Qejfliun.

— Domethënë ti, Qejfli, i ke ndihmuar,

— Ju hipni në varka... — foli prerë kapiteni. — Unë dhe Qejfliu do të vdesim këtu.

— Pse të vdesim, kapiten... — foli Qejfliu.

— Këtu! Në qoftë se vërtet ti nuk ke gisht në këtë vrasje, se vrasje është, atëherë je aq burrë, sa të vdesësh me mua në këtë jaht të mrekullueshëm.

Asnjë nga detarët nuk po lëvizte. Uji i detit u kishte arritur gjer te gjunjët. Të dukej sikur në çast të gjithë ata burra, dhjetë detarë të zotë, do t'i luteshin kapitenit t'i lejonte të qëndronin pranë tij.

— I poshtër! — shau Gaspri dhe e qëlloi Qejfliun me tërë fuqinë e krahut.

Qejfliu nuk e priste goditjen dhe ra në ujë. U ngrit përsëri, tërë frikë:

— Po ju betohem, për kokën time, për kokën e fëmijëve, për zotin, ju betohem! Nuk kam gisht unë...

— Mirë, atëherë do të vdesim të gjithë këtu. — tha Gaspri.

— Po pse, pse, edhe kapiteni, pse? — thoshte Qejfliu.

— Hinni në varka, ju thashë! Nuk ka më kohë! Unë dhe Qejfliu do të qëndrojmë këtu, Nisuni!

Detarët ngjitën shkallët për të dalë në kuvertë.

Lec Tërpana dhe Qejfliu mbetën përballë njëri-tjetrit, mes ujit, që u arrinte deri rrezë kofshëve. Qejfliu ia plasi të qarit, më pas e zunë ca të dridhura.

— Ti nuk je burrë! — i tha Lec Tërpana. Ku i ke paratë që të dhanë, paratë që të blenë... Çfarë të premtuan? Fol!

Qejfliu nuk mundi ta përmbante më veten, iu duk sikur sinqeriteti do ta shpëtonte nga vdekja, ndaj iu kthye kapitenit dhe sy më sy i tha:

— Më gënjyen, kapiten...

— Kush?...

— Ata të «Llojd Triestinës»... Eja shpëtojmë nga vdekja.

— Qen! — ulëriu Lec Tërpana dhe e goditi me plot forcën njeriun e shitur.

Qejfliu këtë radhë diti të mbrohej, megjithatë këmbët iu morën dhe ra në ujin që sa vinte e rriste nivelin. Mori një kovë aty pranë që notonte gjysmë e mbushur dhe u përpoq t'ia vërviste Lec Tërpanës, po kapiteni u shmang lehtë e pastaj, me një zemërim të pafre, iu vërsul vrasësit të jahtit dhe ia përplasi kokën në qoshen e motorit. Qejfliu ra pa ndjenja dhe dha frymën e fundit në ujin e detit, që po mbushte sallën e makinerisë.

Lec Tërpana me shumë vështirësi çau për nga shkallët. U ngjit në kuvertë. Katër

varka të vogla ishin larguar rreth tridhjetë metra nga jahti që po mbytej. Kapiteni u mbështet në bordin e batuar dhe thirri:

— Vëllezër! Qejfliu pranoi se na ka tradhtuar. I thoni Zef Zadrimës se në këtë mbyteje ishte dora e «Llojd Triestinës»...

Varkat e shpëtimit ngjanin me pika loti në faqen e shkëlqyeshme të detit. Që nga larg detarët panë mbytjen e «Zadrimës», një mbyteje e qetë, pa bujë, si zhytja e diellit në perëndim.

## I burgosuri në gjerdek

Ishte e diela e dasmës së tij, mirëpo ai  
ndodhej në burg, dhe dasma, ose nuk do të  
bëhej, ose do të bëhej pa të. Këtë nuk e dinte;  
dinte vetëm se ai, si dhëndër i kësaj së diele,

ishte në birucë që prej njëzet e shtatë ditësh. I dukej sikur vrasja kish ndodhur para pak orësh. Vazhdimisht i burgosuri Haki Haxhiu e kujtonte atë skenë të zhurmshme në qendër të fshatit. Ishte ditë bajrami. Te xhamia dhe dyqanet rrotull lëvrinin njerëzia fytyrëqeshur. Edhe ai ishte i gëzuar. Kish-te veshur kostum të zi dhe, për të parën herë kish hedhur qafës një shall të bukur me kuadrate. Pikërisht ky shall kishte qenë shkaku i sherrit të madh. (Ndodh që gjërat e vogla bëhen shkaqe për ngjarje të mëdha.)

Zihni Demiraj, një djalë fodull nga natyra, me buzët e shpërvjelura nga një ironi e trashë, sapo e pa Hakiun që po afrohej, bëri duart hinkë dhe thirri nga larg:

— Hajde, hajde, Haki Shalli!...

Shokët kishin qeshur, kish qeshur dhe Hakiu. Mirëpo, pa kaluar pesë minuta, Zihniu e kish përsëritur llagapin «Haki Shalli».

— Kujdes, Zihni! Kështu nuk i kemi mirë punët bashkë!

Mirëpo kjo lojë, tjetrit po i pëlqente shumë, ndaj herë pas here, (dhe tani Hakiu i kish fiksuar në kujtesë të gjitha ato raste kur viktimat e kish tallur, e para te shkallët e xhamisë, pastaj te çezma e madhe, te banaku i ëmbëltores, si dhe herën e fundit te varrezat e vjetra). Zihniu e kish qeshur «Haki Shalli». Mirëpo te varrezat e vjetra Hakiu s'e kish përmbajtur veten, kish rrëmbyer

një gur varri dhe e kish qëlluar Zihniun në kokë. I qëlluari kish rënë top në vend dhe djemtë e tjerë të fshatit kishin ngrirë nga tmerri. Pasi kish hedhur në tokë gurin e varrit, i cili kishte hapur një varr tjetër, Hakiu gjakzënë kishte rendur fushave dhe kodrave si një i marrë. Vetëm gjatë rendjes kish ardhur në vete, kish kujtuar të fejuarën, kish rënë përmbys mbi bar dhe ishte djegur nga lotët. Kështu e diela e dasmës po i kalonte në burg, natyrisht pa saze, pa dolli, pa dehje, pa të qeshura. Një shaka e trashë — një gur varri.

## 2

Teki Haxhiu që atë ditë kur xhandarët i burgosën të birin, kish rënë në heshtje. Halle pas hallesh! Si të mos mjaftonte dasma, na tani, duhej që nusen ta fuste në shtëpi pa dhëndër! E, veç kësaj, kishin hyrë në gjak me Demirajt. Gjakmarrja e ardhshme kish tërhequr edhe familjen e nuses, të cilët me të drejtë ngurronin ta jepnin vajzën. Pastaj Hakiu nuk ishte dënuar pak, po plot trembëdhjetë vjet. Vetë Tekiu kishte trokitur te shtëpia e krushkut dhe ishin ulur ta pleqëronin mirë se ç'do të bëhej me dasmën.

Nusja e ardhshme, ishte mbyllur në dhomën e errët si brenda fatit të saj dhe qante. Trembej se, tani që Hakiu ishte burgosur atje, në qytet, ajo mbase nuk do ta shihte kurrrë më. Kushedi ku do ta martonin prindërit. Mbase tepër larg, në harrim. Të shoqin e donte dhe, të ishte për të, ajo pranonte ta priste. Fundja, a nuk ishin gra ato që kishin nisur burrat në kurbet dhe vazhdonin t'i prisnin prej vitesh? Megjithatë çdo gjë vendosej atje, në dhomën me oxhak. Ajo ato ditë i kish qarë hallet me të ëmën, e cila ishte e bindur se ai, Zihni Demiraj, ia kishte bërë borxh (kështu thoshin disa nga shokët, kështu kish thënë dhe Hakiu në gjyq). «Megjithatë vrasja me gurin e varrit nuk mund të justifikohet, kish thënë prokurori, aq më tepër kur e gjithë kjo erdhi nga një humor banal, për një shall të zakonshëm... Bile, kish ngritur zërin prokurori, kjo e bën shumë fajtor vrasësin Haki Haxhiu». Nusja e ardhshme kish folur gjatë me të ëmën e të dyja kishin qarë me lot. O zot!

— Pse vetëm halle në këtë jetë, moj nënë?

— Kjo jetë kështu është thurur, moj bijë. Hakiu është në burg dhe ti pas disa ditësh duhet të jesh në shtëpinë e tyre.

— Po babai?

— As ai nuk di çfarë të bëjë. Është si para lëmshit të madh e s'po ia gjen dot fillin.



Në dhomën me oxhak ishte ndezur një zjarr fjalësh mes të atit të nuses dhe të atit të Hakiut. Më në fund të dy pleqtë kishin gjetur gjuhën e përbashkët dhe Teki Haxhiu kish nxjerrë një qese e kish numëruar përpara krushkut 20 franga ari. Krushku, me sy të rrëmbushur, kish folur gjysmë i mekur:

— Të na trashëgohen!

Kurse e shoqja, duke fshirë lotët me kindin e shamisë së kokës, u largua nga oda e madhe e nxitoi t'i thoshte së bijës se fati i saj ishte vendosur. Të dielën do të martohej me Hakiun!

— Po Hakiu do të jetë në dasmë?

— Këtë nuk e dimë. Krushku ka mbledhur pará dhe do të vërtitet këto ditë në qytet. Mbase e nxjerrin ca ditë nga burgu, sa për ta bërë dhëndër.

### 3

Dhe ja, ishte e diela e dasmës së tij. Ish-te ende mëngjes, e ai nuk e dinte se çfarë ndodhte jashtë mureve të burgut. Dinte se që e diel, dita e dasmës së tij, por as që i shkonte ndër mend se i ati kish disa ditë që vërtitej në qytet për të blerë ca orë liri për të.

Hakiut të zhytur në hallin që e gjeti i

përplasej vazhdimisht në mendje e në gjoks  
nusja, e hipur mbi një kalë të bardhë.

U dëgjuan çelësat e gardianit dhe atij i  
erdhi keq që ia prishën ëndrrën.

— Eja me mua, — i tha gardiani.

— Pse?

— Si pse? Do të të lirojnë për dy ditë.  
Do të martohesh, qerrata!

Hakiu nuk dinte ç'të thoshte. Buzët nuk  
folën asgjë, po mendja dhe zemra se ç'ndezën  
diçka vetëtitëse, aq sa gardiani, i rrahur me  
vaj e me uthull, e kuptoi tronditjen e djalo-  
shit dhe i tha:

— Mbahu, o burrë!

#### 4

Ajo kish hyrë nuse në shtëpi të dielën që  
pa gdhirë. Kish ardhur vërtet e hipur mbi  
një kalë të bardhë, ashtu siç e kish ëndërruar  
dhëndri i burgosur. Nuk kishin rënë as saze,  
kjo jo vetëm sepse dhëndri do të kthehej për-  
sëri në birucën e ftohtë, por edhe (kjo kishte  
më shumë rëndësi) sepse Demirajt ishin në zi  
(djali i tyre s'i kish mbushur të dyzetat). Në  
një fshat, sado të madh, nuk ishte mirë që  
pranë vdekjes të rrëzëllinte dasma, aq më  
tepër kur familja me vdekje dhe familja me

dasmë ishin në gjak me njëra-tjetrën. Rrasën e varrit me gjakun ende të freskët Demirajt e kishin mbështetur në dritaren e madhe, përballë portës së hyrjes dhe mbi të çdo natë mbanin ndezur një kandil, a thua se gjaku i Zihniut donte të shikonte çdo gjë përreth. Pra hyri nuse pa saze. Bile edhe pa dhëndër, se Hakiu ende s'kishte mbërritur. Megjithatë Florenca ndjeu një mugullim të çuditshëm brenda vetes, kur e vjehrra ia leu gishtërinjtë me mjaltë që të prekte qemerin e derës.

«Të na trashëgohesh!»

## 5

I burgosuri, i shoqëruar nga një xhandar, e pas tyre Teki Haxhiu, u panë në hyrje të fshatit. Dhjetëra sy ndiqnin lëvizjet e tyre të lodhura. Kur po kalonin në qendër, Hakiu çoi shikimin në shkallët e xhamisë, pastaj tek ëmbëltoja e në fund te çezma e madhe, pikërisht te vendet ku ai, Zihni Demiraj, tri herë radhazi e kish vënë në lojë me atë llagapin «Haki Shalli». E katërta herë ishte më tutje, te varrezat e vjetra, po zemërimi i Hakiut pikërisht këtu ishte pjekur, te çezma.

— Pimë pak ujë, — i tha të atit.

— Mirë, — u përgjigj ai.

Kurse xhandari nuk priti, po shkoi me nxitim drejt çezmës (ishte një çezmë e vjetër, për ndërtimin e së cilës ishte bërë një bujë e madhe), hoqi pushkën nga supi dhe u freskua duke bërë «ah, ah!» nga kënaqësia.

Hakui më shumë se ujë pinte mall. I ati i kishte blerë dy ditë liri, vetëm dy. Dhe këtë e kish bërë i shtyrë nga forca e madhe e trashëgimisë. Vetëm dy ditë... Për të blerë jetën e një tjetri, sepse jeta e Haki Haxhiut nuk mund të blihej dot. Pasi piu ujë dhe u freskua, ndjeu bashkëfshatarët, të moshuar e të rinj, të cilët e rrethuan duke e parë me keqardhje.

— Të trashëgohesh! — i tha një plak.

— Po xhandarin ç'ta paskan ngjitur pas? Nuk e dinin se sot je dhëndër, — i tha një tjetër.

— Xhandari do të jetë dasmor, krushku i burgut, — bëri shaka një i tretë dhe të tjetrët qeshën.

Qeshi edhe Hakui. Kurse i ati nxori të dridhte një duhan.

— Ecim, — tha xhandari.

Vazhduan rrugën. Po binte muzgu dhe dielli, që shkonte të shtrihej tutje në kodrat e buta, dukej si i përfshirë në ca ethe ngazëlluese. Hakui dalloj nga larg çatinë e shtë-

pisë së tij, pastaj pragun. Provoi një ndjenjë të çuditshme, thua se nuk po shkonte në dasmën, po në vdekjen e tij.

Krushqit e ftuar s'e bënë qejfin qeder. Ishin ulur rreth tri sofrave të mëdha, pinin raki dhe bisedonin me zë të lartë. Florenca, që ishte mbyllur në dhomë, e pa nga dritarja Hakiun dhe iu duk më i bukur, më i burrëruar. Ndjeu një turbullirë të çastit, kish dëshirë të hapte dritaren e t'i thërriste të shoqit, po këtë s'mund ta bënte kurrë, ndaj u skuq nga turpi.

Teki Haxhiu, pasi u takua me të ftuarit, zuri vend pranë tyre.

— Ti, xhandar, hiqe pushkën dhe eja ulu këtu në sofër, — u dëgjua zëri i kryeplakut të fshatit.

— Ja, erdha, erdha! — ia ktheu xhandari dhe doli për një çast.

— Po dhëndri ku është? — pyeti njëri nga dasmorët.

— Po lahet, — ia ktheu Tekiu.

— Hë, hë, po lahet! Patjetër! Se nuk shkohet te nusja me erë bürgu. Ha, ha, ha!

— qeshi ai e pas tij edhe të tjerët.

Të ftuarit qeshnin, të shtëpisë heshtnin. Nëna e Hakiut kaloi kokulur pranë tyre dhe nxitoi për te dhoma e nuses. Nuk ishte mirë ta linte vetëm.

Pasi u la dhe u rrua, Hakiu u vesh me kostumin e dhëndërisë. U pa në pasqyrë dhe

për të parën herë i buzëqeshi vetes. Po në  
çast papritmas rreth qafës iu duk sikur rrë-  
shqiti një shall, i bukur, me kuadrate. «Mi-  
rëmëngjes, Haki Shalli», «Të lumtë, Haki  
Shalli», «Do të bëhesh dhëndër, Haki Sha-  
lli».... Një shall i bukur, me plloça, si gurë  
varri. Mendoi Zihni Demirajn dhe i erdhi keq.  
I vrari e kish fyer në sedrën e burrit dhe  
këtë, ndonëse padashur, e kish paguar me  
jetën e tij. Në atë çast përballë pasqyrës iu  
duk sikur rreth tij ia behën shokët, të gjithë  
të rëndë sa vdekja e Zihniut. Kish nevojë  
për shokët po aq sa për lirinë e gjatë. Të  
paktën ata ... Mirëpo vdekja e shokut nuk  
falet shpejt. Po fundja, mendonte Hakiu ba-  
llë pasqyrës, duke rregulluar kollaren e hollë  
e të gjatë, unë nuk jam as i pari as i fundit.  
Vrasje të tilla... Për të parën herë në jetën e  
tij mendoi se faji lëvizte jo vetëm brenda tij,  
por edhe diku jashtë, mbase edhe tek ata nje-  
rëz që ishin dasmorë të tij e që në dhomën  
matanë hanin e pinin këmbëkryç mbi një  
vdekje. Ata po e prisnin. Duhej të shkonte.  
Teki Haxhiu u ngrit në këmbë. Pa nga i  
biri. që iu ul në krah, pastaj nga të ftuarit  
dhe me zërin e tij të trashë e të qetë tha:  
— Faleminderit që erdhët në dasmën e  
Hakiut. Mos harroni: sot është e diel, datë 19  
korrik 1936... Këtë datë mos e harroni! Ka  
rëndësi, se babai i ardhshëm do të jetë në  
burg për shumë vjet. Të na trashëgohen!

— Të na trashëgohen!

U tokën gotat. Hakiut i dukej sikur rrinte pezull. Mos vallë çdo gjë që po ndodhte tani në shtëpinë e tij ishte thjesht një ëndërr? Ktheu gotën e rakisë dhe ndjeu stomakun t'i digjte.

— Kujdes. — i pëshpëriti i ati, — nuk është mirë të të zërë rakia. Ha ca mish.

Hakiu nuk foli.

Nëna bënte gati dhomën gjerdek. Nusja heshte në një nusërim të vetmuar. I shoqi ende s'kish ardhur ta takonte. Dukej sikur vinte nga vdekja, sa për t'i thënë lamtumirë jetës. Pa shtratin e madh bashkëshortor, i cili lidhej shumë me dy ditët e lirisë së Hakiut. Për trembëdhjetë vjet ai shtrat do të plakej, duke kujtuar vetëm një natë të ëmbël. S'e përmbajti dot veten dhe qau.

Hakiu hyri në dhomën e nuses me një ceremoni që nuk e duronte, por që detyrohej t'i bindej deri në fund: Krushqit qeshnin me të madhe.

E mbylli dhomën me celës dhe shkoi drejt nuses. Ajo pa lot në sytë e tij, lot që ia përvëluan gjoksin.

— Më fal, nuse. — i tha, — po ja që kështu ndodhi... Nuk desha... E vrava ....

Asaj iu lidh gjuha. Kish menduar që, kur të hynte i shoqi në dhomë, t'i thoshte: «Po pse, Haki, nuk mendove pak për mua në

atë çast të mallkuar, pse?» Mirëpo fjalët e tij, të përziëra me lot, e zbutën, e thyen, e shkërmoqën, aq sa lëshoi vetëm një «ah!» dëshpërimi për fatin e saj të zi.

— M'u ndez gjaku, — foli përsëri Hakiu, — më fyeu, Kënaqej kur shihte që shokët qeshnin me fjalët e tij plot tallje... Kënaqej mbase sepse... sepse ti vetë më ke thënë, ai dikur të ka dashur për vete...

— Mos!... — klithi nusja. — Lëre të vdekurin të qetë...

Heshtën një çast. Nusja e kuptonte mirë si mund të kish ndodhur vrasja.

— Ti nuk më fal? — e pyeti Hakiu.

— Të kam falur sapo e mora lajmin... Po sa vlen kjo.

Folën gjatë.

Vonë, shumë vonë, kur gjithçka kish rënë në qetësi, Hakiu u ngrit nga shtrati dhe iu afrua dritares, e cila shikonte nga shtëpitë e tjera të fshatit. Kërkoj me sy shtëpinë e Demirajve, që ngrihej në një kodrinë, dhe vuri re se në oborr vërtet ish ndezur një kandil. U turbullua. Gjatë bisedës në darkën e dasmës dikush kish treguar për gurin e përgjakur të varrit, ku cdo natë Demirajt ndiznin kandilin. Kandili do të shuhej vetëm atëherë kur të ishte marrë gjaku i Zihniut.

U kthye nga e shoqja, e cila kish filluar të qante heshturazi në një qoshe të shtratit.



— Për këtë fëmijë babai na bleu dy ditë liri. Nëse është djalë, e quani Fitim.

Nusja nuk foli. Dhëndri ktheu përsëri kokën nga dritarja dhe pa qiellin, që iu duk i ftohtë si mur qelie.

Faint, illegible text at the top of the page, possibly bleed-through from the reverse side.

## Vdekja e palaços

Palaja nuk ishte as i ri, as i vjetër.  
Vdiq papritmas, mu në mes të sallës së ma-  
dhe, pak para se të fillonte balloja. U shtri  
sa gjatë gjerë në dyshemenë e mermertë, dhe  
gratë, pasi e kuptuan që kjo nuk ishte lojë e  
tij, ia dhanë ulërimës. Burrat iu afruan gra-  
ve të tyre dhe i qetësuan. Mbreti hijerëndë  
tha vetëm dy fjalë:

— Hiqeni nga salla!

Katër shërbëtorë vrapuan drejt palaços së shtrirë, i cili, vazhdonte të qeshte si një fëmijë.

— Çudi si vdiq kaq shpejt, papandehur, — tha njëri nga shërbëtorët.

— Ai s'ka qenë ndonjëherë i sëmurë, — ia ktheu tjetri.

— Këtë nuk e dimë, — tha i treti.

I katërti nuk e pa të arsyeshme të fliste.

Kufomën e veshur me rrobën ngjyra-ngjyra, me fytyrën të lyer me grim të fortë, me hundën prej llastiku mbi hundën e mishtë, e vendosën mbi shtrat në një dhomë të zakonshme. Nga salla u dëgjuan tingujt e një muzike të njohur. Balloja kishte filluar.

— Ti rri këtu, — i tha shërbëtori i parë shërbëtorit të katërt.

I katërti nuk e pa të arsyeshme të fliste. Mbase ngaqë ishte më i riu. Tre të tierët dolën dhe ai mbeti vetëm me të vdekurin.

— I gjori ti. — i tha me zë. — Ata kërcëjnë, edhe pse ti ke vdekur. Pale, edhe më qesh.

Mirëpo ndonjëherë të vdekurit dëgjojnë, vecanërisht atëherë kur i prek në gjërat thelbësore, kështu që palacoja, ashtu i qeshur, u ngrit nga shtrati, i hodhi shërbëtorit dorën në sup dhe qetë i tha:

— Unë nuk kam vdekur.

Shërbëtori e pa të arsyeshme të mos i kthente përgjigje, sepse në çast iu duk një

lajthitje palaçoje. Mirëpo papritmas u kujtua që ai kishte vdekur dhe ia dha ulërimës.

— Mos bërtit kështu, — i tha palaçoja, — ky është numri im i fundit, e kupton? Për ty unë jam i vdekur.

— Po a jeni vërtet i gjallë? — foli për të parën herë shërbëtori i ri.

— Natyrisht. Palaçot asnjëherë nuk vdesin. Bile as atëherë kur u pushon zemra.

Shërbëtori s'e përballoi shakanë dhe ra pa ndjenja. Atëherë palaçoja i shkathët shpejt e shpejt ndërroi rrobat me shërbëtorin, i bëri një grim të lehtë, hoqi nga hunda e tij maskën e llastikut dhe ia vendosi tjetrit, veshi rrobat e shërbëtorit e pastaj e shtriu në shtratin ku pak më parë qëndronte vetë «i vdekur».

Ngadalë e me kujdes hapi derën e dhomës dhe u drejtua nga banja aty pranë për të larë fytyrën dhe për të veshur një palë rroba të tjera, të modës së fundit, të cilat i kish fshehur para fillimit të lojës.

Zemra i rrihte me një ritëm tjetër. Kishte emocione, megjithëse plani kish nisur të zbatohej për mrekulli. Në vite i qe mbledhur një zemërim i madh, ndaj donte që botën e lustrës ta poshtëronte para se ta braktiste.

Balloja vazhdonte, kur palaçoja, tepër serioz, hyri në sallën plot dritë dhe zuri vend pranë një grupi të ftuarish. Kishte dëshirë të

dëgjonte se çfarë thoshin për të pas vdekjes. Mirëpo, sikur ta dinin që ai s'kishte vdekur, ata as që e përmendnin ndodhinë tragjike e atë vetë. Dhe s'kish veçse pesëmbëdhjetë minuta që ai kishte mbyllur sytë! I shkoi në mendje që të provokonte një bisedë rreth të porsavdekurit, mirëpo kjo do të ishte me rrezik. Përballë, në fronin e lartë, qëndronte lartmadhëria e tij mbreti, disi i trishtuar. «Po afron koha kur unë duhej të dilja dhe me numrat e mi, lartmadhëria bashkë me të tjerët do të shqyheshin së qeshuri. Mirëpo për mua tanimë nuk ka kohë; unë isha, nuk jam», mendoi palaçoja dhe qeshi me zë. Dy-tre të ftuar rrotull e panë me çudi, por ai fare shpejt u bë serioz dhe nuk e tërhoqi më vëmendjen e tyre. Rrëshqiti ngadalë dhe u afrua pranë një grupi tjetër, gjithnjë me dëshirën e zjarhtë të dëgjonte diçka për vdekjen e tij.

Në këto çaste mbreti vërtet e çoi mendjen te vdekja e palaços. Historikisht mbretërit janë argëtuar me palaço, madje më tepër sesa luks ata kanë qenë domosdoshmëri. Edhe Cezari kish pasur miminë, gaztorin e tij. Pallati mbretëror nuk mund të përfytyrohej pa palaço. Kështu që patjetër duhej të gjenin një palaço të ri, madje më të mirë se të parin. Këtë lartmadhëria e tij ia tha pikërisht atë çast sekretarit, i cili ndodhej fare pranë.

Kjo porosi e mbretit i dha mundësi palaços «së vdekur» të dëgjonte këto biseda:

— Më mirë kështu. I vjetri ishte tepër i konsumuar.

— E po u bënë kaq vjet! Edhe yjet në qiell konsumohen.

— Shikojeni mbretin, duket i trishtuar.

— Për palaçon?!

— Mbase dhe për të. Thonë se e donte më shumë se qenin.

Plasi e qeshura. Palaçoja, i mbështetur në një shtyllë, aty pranë, u tkurr; ishte kjo një lëvizje tipike prej palaçoje, gjë që do ta tradhtonte para syve të një vëzhguesi të hollë. Donte t'u thoshte atyre zotërinjve se nuk ishte e vërteta kjo, po nuk donte ta prishte lojën. Ai kish vendosur ta çonte planin deri në fund, falë edhe faktit se fytyrën e vërtetë të palaços, atë seriozen, askush nuk e njihte. Ai kishte njëzet vjet në pallat, gjithnjë me atë veshje, me atë grim shumëngjyrësh, me atë hundëmaskë e me atë zë aspak të natyreshëm.

Po planin e tij padashur e ndihmoi dhe i dha një bukuri të veçantë ringjallja e palaços, pra e shërbëtorit të katërt, i cili, me t'u përmendur, kërceu nga shtrati dhe vrapoi drejt sallonit, gjithnjë duke ulërirë. Salla e pa dhe shtangu e habitur. Shikimet u drejtuan nga mbreti, i cili, i befasuar nga kjo ringjallje, vetëm për disa sekonda, zuri të

duartrokiste lojën e mençur të palaços. «Bukur, bukur!» tha dhe ia plasi të qeshurit si asnjëherë tjetër. E gjithë salla shpërtheu në të qeshura dhe zuri të lavdëronte palaçon, i cili, sipas mendimit të ri, jo vetëm nuk ishte konsumuar, po përkundrazi, ishte rinuar së tepërmi, ishte bërë më me fantazi... Mirëpo palaçoja, ose më saktë, shërbëtori me veshjen e palaços, kishte ngrirë në vend si trung. Vetëm ai e kuptonte pozitën e tij të vështirë. Nuk dinte si të justifikohet para atyre qindra njerëzve të zgjedhur në ajkën e shoqërisë e aq më tepër përpara lartmadhërisë së tij, i cili ishte ngritur nga fronti dhe vazhdonte të qeshte me zë gurgullues. Si t'u thoshte?! Si ta shpjegonte shfaqjen e tij me atë veshje?! Papritmas salla heshti. Prisin që palaçoja i frymëzuar të zbrastë numrat e rinj. Mes asaj heshtjeje u dëgjua zëri i hollë i shërbëtorit-palaço:

— Unë nuk jam palaçoja...

Mirëpo e tha me një zë kaq të sforcuar dhe me gjestikulacione kaq qesharake, saqë shkaktoi të qeshura të tjera, që nga lartmadhëria e deri te shërbëtorët.

Vetëm shërbëtori i parë u kujtua se palaçon e vdekur e kish lënë me një shërbëtor të ri, dhe kish mundësi, ngaqë qe tepër i ri, të kish lajthitur dhe të kish zhveshur kufomën, ose... U çorodit dhe u frikësua aq, sa ndjeu të dridhura. Nxitoi hapat drejt dhomës



ku kish lënë palaçon e vdekur me shërbëtorin e ri dhe, kur nuk gjeti as kufomën e as shërbëtorin, vrapoi përsëri në sallë dhe u bind se ai, palaçoja, që po rrinte si guhak në mes të gjithë të ftuarve, ishte shërbëtori i ri.

— Lartmadhëri! — u dëgjua zëri i shërbëtorit të parë, — ai nuk është palaçoja i vërtetë!

— Ashtu!! — u habit mbreti dhe pas tij të gjithë të pranishmit në sallë prenë të qeshurën.

— Domethënë paska vdekur vërtet.

— Po, po, s'është as kufoma!

— Paskan vjedhur palaçon!

Në këtë kohë sekretari i mbretit dhe dy agjentë iu afruan palaços së ri dhe, pasi i bënë disa pyetje, sqaruan gjithçka. Njëri nga agjentët iu afrua shërbëtorit-palaço, duke i ulërirë:

— Shko zhvishu, idiot!

Salla zhurmonte si asnjëherë tjetër; disa qeshnin, ca prisnin sqarime, të tjerë habiteshin, ndonjëri priste që nga çasti në çast të shfaqej palaçoja i vërtetë. Sekretari vazhdonte të fliste me lartmadhërinë e tij, i cili tashmë ishte ngrysur keqas.

— Zonja dhe zotërinj, — nisi t'i sqaronte pas pak sekretari i mbretit, — ka ndodhur diçka e papëlqyeshme. Palaçoja i pallatit nuk gjendet.

— Duhet të jetë fshehur.

— Mbase është zhdukur.

— Ta kërkojmë!

— Zonja dhe zotërinj, askush nuk ka dalë nga pallati. Rojat nuk kanë vënë re asnjë lëvizje të dyshimtë. Palaçoja i vërtetë fshihet këtu, mes nesh, — mbaroi sqarimin sekretari i mbretit.

— Po gjejeni atëherë, pse nuk e kapni, — u hodh një zonjë e kolme, e cila qëndronte diku pranë fronit mbretëror.

— Jam i detyruar t'ju sqaroj se asnjëri nga ne, as shërbëtorët vetë, nuk e njohin fytyrën e tij të vërtetë. Ai gjithë jetën ka qenë veshur dhe maskuar si palaço.

Ky sqarim ndezi diskutime të tjera.

— Kjo qenka me të vërtetë e bukur!

— Ua ka punuar paq!

— Mos ka qenë ndonjë agjent i huaj.

— Shshsht, mbylle gojën!

— Dhe qenka fshehur këtu mes nesh.

Papritmas filloi një lojë e re argëtuese: secili kthente kokën sa majtas-djathtas dhe pyeste:

— Më falni, mos jeni ju palaçoja?

Gratë gajaseshin së qeshuri nga kjo lojë e re e paparashikuar, që e shpik veç një rast i rrallë si ky. Hyri në lojë edhe palaçoja i vërtetë, që duke qeshur i tha një ushtaraku përkrah tij: «Mos jeni ju palaçoja, zotëri?»

Vetëm lartmadhëria e tij rrinte i menduar, mbase duke zhbiruar domethënien e

lojës së palaços. Kish mbetur vetëm që sekretari, apo ministri i Brendshëm, apo ndonjë ministër tjetër t'i afrohej atij, mbretit, e t'i pëshpëriste në vesh, me intimitet: «Mos jeni ju palaçoja, madhëri?»

Mirëpo loja u mbyll shpejt, sapo agjentët u kthyen nga kontrolli i imët në pallat dhe i raportuan ministrit të Brendshëm si dhe sekretarit të mbretit se në banjën e katit të parë ishin gjetur sapuni dhe peshqiri me të cilët kishte pastruar fytyrën palaçoja, si edhe rrobat e shërbëtorit. Dritarja e banjës ishte e hapur dhe që andej duhej të ish hedhur palaçoja i vërtetë. Sekretari i mbretit përsëri i sqaroi të ftuarit në ballo, të cilët, të përfshirë në ethet e lojës së re, vazhdonin të pyesnin njëri-tjetrin.

— Më falni zotëri, mos jeni ju?

Mbreti, i zemëruar, doli nga salla. Kish nuhatur jo vetëm rebelimin e palaços, por edhe qëllimin e tij. Do të jepte urdhër që ish-palaçoja të gjendej patjetër dhe të ekzekutohej me varje në mes të sheshit të madh.

Edhe balloja u mbyll. Bashkë me të ftuarit doli nga salla edhe palaçoja i vërtetë, gjithnjë duke qeshur e duke pyetur njërëzit në krah:

— Më falni, zotëri, mos jeni ju palaçoja?



## Mos bëni shaka të tilla

Kur përpiqem të sjell ndër mend skena nga ajo moshë e njomë dhe e papërsëritshme, harrohem mes ngjarjeve të shumta, që më ngatërrohen me njëra-tjetrën e më shfaqen të veshura me rroba mjegullore. Po një-rën prej tyre e shoh si tani. Është një ngjarje e thjeshtë, ose më mirë një jetë e zakonshme,

mes një pylli me pisha, me zogj cicëritës, buzë një deti të kthjellët si ëndërr fëmije. Atëherë ishim dymbëdhjetëvjeçarë. Them ishëm, sepse ngjitur me ne banonte dhe familja e rojtarit të pyllit, e cila kishte një vajzë vërsnike me mua. E quanin Hëna. Në fillim u çudita me emrin e saj, pastaj u mësova. Kishte emër të bukur dhe unë e përmendja shpesh.

Çdo verë familjet tona largoheshin nga qyteti i Durrësit dhe vendoseshin për pushime në mes të pyllit të Golemit, në një barakë të madhe, të bukur, të thurur me mjeshtëri me degë peme. Kur shpërngulehim në barakën romantike, mbaj mend se nuk përmbahesha nga gëzimi. Dita kalonte sa s'bëhet më bukur. Hipja në pemë e mblidhja boça pishash, luaja me top, mësoja not e bëja banja dielli, kaloja gardhin rrethues të shtëpisë së pushimit të pionierëve, që ngrihej disa metra më tutje shtëpisë sonë verore dhe atje bëhesha shok me të tjerë, nga qyteti im e nga qytete të ndryshme. Mirëpo shokët e rinj pas çdo pesëmbëdhjetëditëshi më linin shëndenë, kështu që më duhej të lidhja sërish miqësi. Atëherë mësova t'i bija borisë dhe, meqë asnjë pionier i shtëpisë së pushimit nuk ishte borizan më i mirë, fitova privilegjin për të qenë atje borizan i përhershëm. Më pas e lashë edhe këtë detyrë dhe vendosa të bëhesha shok me

Hënën. Vija re se asaj i pëlqente të më dëgjonte kur i flisja për Tom Sojerin, kur i rritgoja përrallat e mësuara nga gjyshja, i pëlqente kur mbrëmjeve, si burrë i rritur, merrja tojën time dhe bashkë me babanë dilja të peshkoja në breg të detit. Një mbrëmje erdhi të peshkonte me ne edhe rojtari i pyllit. Me vete mori Hënën dhe unë u gëzova.

— Kur ka hënë, ka edhe peshq shumë, — i pëshpërita.

— Unë nuk di të peshkoj, — më tha dhe puliti sytë.

Aliu, rojtari i pyllit, ktheu kokën dhe më buzëqeshi. Unë e doja xha Aliun, sepse dhe Hënën e kisha shogë të mirë. Ecnim buzë detit. Guaska të shumta shtyheshin nga valët dhe shkëlqenin para nesh si hënëza të vogla. Unë ulesha dhe zgjidhja guaskat më të bukura. Hëna i pëlqente shumë guaskat dhe, sa herë që ia zgjatja duart e lagura, ajo më pëshpëriste:

— Erion, faleminderit!

S'di pse më dukej vetja më i rritur.

— Si thua, kapedan Roni, a do të zëmë peshq sot, apo jo? — më pyeste babai pa kthyer kokën.

— Besoj se po. Sonte nata është e bukur, me hënë.

Dy të rriturit buzëqeshën, kurse Hëna e tokës ecte me kokën ngritur nga hëna e qiellit, që atë buzëmbrëmje kishte formën e

një gjysmërrethi. Unë vrapoja buzë detit dhe kthehesha me duart plot guaska, shumica të bardha.

— More, ç'i doni gjithë këto? Trastat do t'i mbushim me peshk e jo me guaska. — tha babai i Hënës.

Po vajza e tij nuk foli. As unë. Vecse tani nuk vrapoja më në ranishten e lagur.

Arritëm në vendin ku do të gjuanim, një sop i vogël prej rëre. Nxorëm tojat nga çantat, ngulëm ca kallama në rërë, vumë karremat në grepa dhe i hodhëm fildispanjat tutje, në thellësi. E bija e rojtarit të pyllit na shikonte me kureshtje, si të ishte para një riti indianësh. Vura re se më shumë shikonte nga fildispanja ime e bardhë.

— I bie, — tha babai me gjuhën e peshkatarit, — sot do të qëllojmë.

Atë çast m'u drodh dora. Kush është marrë me peshkim, e kupton se ç'është një dridhje dore në gishtin tregues, ku mbahet fildispanja. U tremba pak. Doja të thërritja babanë që të më ndihmonte, por s'e bëra veten dhe vendosa ta kapja peshkun që po më ngacmonte grepin. Lëshova gati një metër fildispanjë. pak e nga pak. Një e tronditur e dytë. shumë më e fortë se e para, ma hoqi tapën e tojës nga dora. Hëna, që po më ndiqte me vëmendje, lëshoi një klithje të lehtë, diçka mes thirrjes e qeshjes. U tregova i shkathtët dhe me këmbën e djathtë shkela tapën.



Peshku vazhdonte të përpiqej. Dukej që kish ngecur keqas në grep.

— Hëna, eja ta tërheqim bashkë, — i thashë, — se duket qenka peshk i madh.

— Kam frikë, — tha ajo.

Xha Aliu e lidhi fildispanjën në kallamin e ngulur aty pranë dhe na u afrua. Vuri dorën në fildispanjën time dhe i tha babait:

— Më duket se paska ngecur në ndonjë mbeturinë deti.

— Jo, xha Ali, unë e ndjeva kur peshku tërhiqte karremin.

— Atëherë, pa ta tërheqim bashkë ngadalë, — ma bëri qejfin ai.

Një e dridhur e fortë, sikur fildispanja të ishte një përçues i mirë i rrymës elektrike, kaloi nga thellësia e detit në duart tona.

— Ohoo. e paske kapur një pesëkilësh më duket! — tha xha Aliu.

Atëherë edhe im atë e lidhi fildispanjën e tij te kallami dhe erdhi te ne. Hëna qëndronte si e ngrirë, duke shikuar herë duart tona, herë në breg, ku pritej të dilte peshku. Pas pak. dy-tre metra para nesh, shkëlqeu një ngjalë e giatë dhe e trashë.

— Gjarpër! — u tremb Hëna.

— Mos u tremb, — i thashë, — se është ngjalë.

— Cudi. si nuk e ka këputur fildispanjën. — tha babai duke u përpoqur ta kapte ngjalën e rrëshqitshme me dorë.

Unë i njihja disa rite të peshkatarëve dhe vrapova të hapja një gropë lart, në rërën e thatë. Aty e vendosëm ngjalën, që kundërshtonte shumë, megjithëse tani ia kishim prerë kokën. Isha i gëzuar për ngjalën e kapur. Në sytë e shoqes sime më dukej se isha bërë më i madh.

— Dëgjo, — i thashë, — tani do të peshkos ti. Mos ki frikë fare. Unë do ta hedh grepin në det, kurse ti do ta mbash fildispanjën, ja kështu, me gishtin tregues.

— Mirë, — pranoi Hëna.

Hodha fildispanjën në det dhe fundin e saj ia zgjata Hënës. Filli i bardhë shkëlqente.

— E kapa! — thirri fort Hëna, dhe e tërhoqi dorën mbrapa me shpejtësi. E mora për pak çaste fildispanjën në dorën time, por asgjë. Një boshllëk dhe një shtendosje.

— Peshku e ka këputur fildispanjën, — i thashë.

— Unë e kam fajin, — foli ajo gati në të qarë.

— Jo, — e qetësova unë, — fajin e ka peshku.

Ajo qeshi. Baballarët, gjithashtu. Meqë e kisha kapur gjahun tim, nuk doja të peshkoja më dhe i thashë Hënës të shikonim peshkatarët e rritur. Babai kapi një levrek jo shumë të madh dhe me gëzim, duke fërshëllyer, e futi në trastë. Xha Aliu nuk fliste. Peshkatarët kanë një inat të fshehtë për një-

ri-tjetrin, ashtu si sportistët në garë. Kur ai kapi një levrek më të madh, vura re se rojtari i pyllit u fry dhe nisi të fliste ca si shumë. Edhe kjo është në natyrën e peshkatarëve.

— Erion, më trego ndonjë gjë të bukur,  
— m'u lut Hëna.

— Po t'i kam treguar të gjitha. — ia ktheva.

Heshtëm një çast. Atëherë vendosa t'i flisja për të fshehtën time në kohët e fundit.

— E di, Hëna, — i thashë, — unë kam bërë shok një ketër.

— Një ketër?!

— Po, një ketër të bukur. E ka strof-kën këtu, në pyllin e pishave të buta, ku unë hyj fshehurazi xha Aliut.

— Po si e ke bërë shok? — pyeti ajo dhe puliti sytë e bukur si yjet në verë.

— Si të të them.... Unë kisha hipur në një pishë për të marrë ca boça, kur shoh se nga pisha tjetër më ndiqte një ketër i vogël, me gëzofin e kadifenjtë ngjyrë mjalti. Fillova të luaja në pemë, të kërceja, të qeshja. Ketri sikur kishte ngrirë nga habia. Më shikonte me sytë e tij të bukur dhe nuk ikte. Atëherë fillova të fishkëlleja si bilbil. Ketri zuri të kërcente degë më degë, merrte frutat nga boçat e hapura, përtypte dhe lozte si unë. Edhe kur zbrita, ketri s'm'i ndau sytë. Do të kisha qëndruar gjatë me të, por u bë vonë.

dhe një herë m'u duk se dëgjova të kolliturën e babait tënd, ndaj u përshëndeta me mikun tim të ri dhe u largova.

— Ty, Erion, gjithnjë të ndodhin gjëra të çuditshme, — tha Hëna. — Po pastaj, e takove më ketrin?

— Ditën tjetër shkova përsëri po tek ajo pemë. Mbase ketri i bukur më kish pritur. sepse pa kaluar dy-tri minuta, ai doli dhe prapë dhamë koncert për njëri-tjetrin.

— Sa bukur! Po mua a do më njohësh me ketrin?

— Patjetër, — i thashë, — veçse mos i thuaj gjë babait tënd.

— Po sikur t'i themi? Ai na do shumë dhe nuk ka pse të kundërshtojë.

Hëna ishte e zgjuar.

— Mirë, i themi, — pranova unë. — Dhe, po deshe ti, që nesër të njoh me shokun tim që e ka shtëpinë te pishat.

Moti nisi të ftohej dhe prindërit tanë vendosën të ngriheshin. Mblodhëm fildispanjat, fshehëm kallamat në ca gëmusha, unë nxora ngjalën time nga gropa dhe e futa në trastën e babait e pastaj morëm rrugën e kthimit. Tani me mua vraponte dhe Hëna. Duke vrapuar, ajo ulej dhe mblidhte guaska. Pastaj, papritmas, u kthye dhe i tha të atit:

— Babi, nesër do të vij me Ronin në pyllin e pishave të buta. Roni do të më tregojë një ketër.

— Mirë, nesër në mëngjes ejani me mua,  
— tha shkurt xha Aliu.

Hëna, e gëzuar, më kapi dorën dhe të dy vrapuan buzë detit duke u ruajtur të mos na lageshin këmbët.

— Shiko, shejtani, — dëgjova rojtarin e pyllit, — ia ka marrë mendjen vajzës, siç duket ia ka vënë syrin që tani. . .

Babai im qeshi i kënaqur. Mua sesi më erdhi, u skuqa gjer në rrëzë të veshëve. Nuk e dija a i kishte dëgjuar Hëna fjalët e babait të vet. Më dukej se jo. Ajo ishte ca më larg, e përkulur mbi valët shkumëbardha dhe dukej sikur po punonte një dantellë gjigante. Më vinte inat me xha Aliun. Tani nuk po më pëlqente që nesër do të shkoja në pyllin me pisha për të parë ketrin, sepse patjetër që rojtari i pyllit, po në atë mbrëmje, do të thoshte dicka për një dhëndër dhe një nuse në një pyll dhe patjetër që im atë do të kukurisej së qeshuri.

— Po eja, moj vajzë, pse mbete prapa,  
— i foli xha Aliu Hënës, e cila vazhdonte të qëndronte e përkulur mbi dantellën e bukur të valëve, ku mblidhte guaska.

Unë iu afrova Hënës dhe vura re se ajo po dëneste. Pra e kishte dëgjuar xha Aliun, e kishte dëgjuar të qeshurën e babait tim dhe qe prekur shumë, më thellë se unë.

— Mos qaj, Hëna, — i thashë. — Fshiji lotët dhe eja.

Ajo u ngrit pa folur. Tani i hidhte hapat ngadalë. Edhe baballarët u detyruan ta ulnin ritmin e ecjes. Hëna përmbahej e s'donte ta jepte veten para të rriturve. Kurse unë bluaja e bluaja me vete dhe, kur arrifëm pranë baballarëve, thashë me zë të dridhur:

— S'është mirë kështu.. Mos bëni shaka të tilla...

Vetëm kaq thashë. Im atë u përtyp. Xha Aliu uli kokën, pastaj pa nga im atë dhe vuri lehtë buzën në gaz. E afroi Hënë dhe e shtrëngoi në gjoks, si për t'i kërkuar të falur. Kurse unë nisa të vrapoja prapë buzëdetit, duke kërcyer për t'i shpëtuar dantellës së bukur të valëve.

Ishte një natë e butë, me një hënë të bardhë mbi krye. Kishte filluar batica.

# Kitara mbi veladon

Isha vetëm tetëmbëdhjetë vjeç. Shkrueja vjersha si një i fantaksur. Lodhesha, po më shumë kënaqesha. Kjo mbase edhe pse isha i dashuruar. Adhuroja vajzën e një prifti. Elsa, natyrisht, ende nuk dinte gjë. I binte bukur kitarës. Ishim në një klasë. Një ditë ajo kompozoi një këngë dhe m'u lut t'i bëja tekstin. Kuptohet që pranova. Natën lindën vargjet:

*Sot po të lutem ty, kitarë,  
bukuroshe e drunjtë me zë njeriu,  
të gjashtë telat m'i lejo t'i marr  
t'i vendos në zemrën e lirikut.*

E këndonim ne maturantët. madje të gjithë nxënësit e shkollës. Isha si i ndezur... Po ne jse, nuk u bëra shkrimtar i njohur. Ai, i njohuri për të cilin do të flas, ishte një tjetër, thujse njëzet vjet më i madh nga unë. Ishte mik i familjes së priftit. Elsa e kishte lutur shkrimtarin me emër që të na zhvillonte një bisedë. Ai pranoi dhe një pasdite na erdhi në shkollë.

— Do të na kënaqë. — i thashë Elsës.

— Patjetër, — tha ajo e entuziazmuar.  
— Tani ai flet nga maja e Olimpfit.

— Nuk është dhe kaq lart, — ia ktheva, — ka edhe të tjerë më të mirë.

— Natyrisht, po sot ai gëzon një emër të vecantë.

Biseda ishte tepër e vakët. Kishte nota mburrjeje. Këtë ia thashë Elsës.

— Mua s'më duket kështu. — më qortoi ajo. — Fundja ne e kemi ftuar që të na flasë për vete.

Mbase kishte të drejtë. Kisha një lloj egoizmi të fshehur për shkrimtarin e njohur. Pas bisedës recitova një nga poezitë e mia. Shkrimtari, që nga presidiumi, më ndiqte me vëmendje. Shokët, që m'i dinin vjershat për-



mendsh, duartrokitën të parët. Pastaj edhe shkrimtari përplasi pëllëmbët e tij, lehtë, me elegancë. Vetëm duartrokitjet e tij dëgjoja atë çast. Pastaj, në kor, vetvetiu, kënduam këngën e kitarës. Shkrimtari qeshte i kënaqur. E dinte se këngën e kish kompozuar Elsa. Me kaq mbrëmja letrare u mbyll. Ne, dy-tre letrarë të rinj dhe Elsa, e vumë në mes shkrimtarin e njohur dhe dolëm të shëtitnim buzë detit. Ishte një muzg i bukur, me disa re të ndezura si në një qiell përralle. Shkrimtari fliste, na këshillonte. Shikoja qiellin e mahnitshëm dhe detin fjalëpak. Në dorën e djathtë mbaja kitarën e Elsës. E kujtoj shpesh atë mbrëmje, edhe pse Elsa tre muaj pas saj u fejuua me shkrimtarin e njohur.

Elsa na ftoi për fejesën me shkrimtarin nga Tirana. Përsëri kënduam këngën e kitarës. Shkrimtari gjithnjë shkëlqente nga gëzimi. Priftin nuk e pamë gjekundi. Na thanë se ishte në një varrim.

Kur do të iknim, Elsa m'u lut të qëndroja edhe ca, se do t'i thoshte të fejuarit që të më ndihmonte për të çarë në udhën e botimit. U detyrova të rrija. Shkrimtari foli disi më hapur me mua. Më pyeti se sa gjuhë të huaja dija, çfarë letërsie lexoja, cilin autor pëlqeja më shumë dhe a kisha bërë ndonjë përpjekje për botim e të tjera pyetje si këto. I përgjigjesha shkurt. Druhesha se, sikurse

thoshte, ishte i madh sa shuma e moshës  
sime dhe Elsës së bashku.

Prifti erdhi pas një ore. Ishte i qeshur.  
Sikur nuk vinte nga një varrim. U ul në koll-  
tukun përballë meje, tashmë pa veladonin e  
zi, pa kamillafin e zi, pa këpucët e zeza. Ve-  
çse kryqin e artë nuk e kish hequr nga qafa.  
M'u duk si i shpërfytyruar. E para herë që e  
shihja civil, me rroba shtëpie, me pantofla.  
M'u kujtua babai, oficer, të cilit gjithashtu  
nuk i shkonin rrobat civile. Mbase kështu më  
dukej mua.

— Nesër më sill disa vjersha. Do të in-  
teresohem që të t'i botoj në ndonjë organ.  
Mbase në «Drita», — më tha i fejuari i Elsës.

— Faleminderit! — i thashë.

Prifti qeshte dhe ndihej i kënaqur.

Vjershat nuk m'u botuan asnjëherë. Nuk  
e di fatin e tyre. Mirë që ruajta kopjet. Me-  
gjithatë shkrimtarin e njohur e takova për-  
sëri.

Nxënësit e shkollës sonë ishin ndër të  
parët që nisën luftën kundër fesë. Kishat dhe  
xhamitë u paralizuan. Priftërinjtë dhe ho-  
xhallarët u zhveshën. Elsa mungoi disa ditë  
në shkollë. Me sa dukej, i vinte turp. E ndje-  
va se duhej t'i shkoja në shtëpi dhe të inte-  
resohesha. Ishim në prag të provimeve të  
maturës dhe mungesat nuk do ta ndihmonin.  
Elsën; përkundrazi.

Derën ma hapi shkrimtari. Dukej i mërzhitur. Më ftoi brenda dhe u gjenda përballë me babanë e Elsës. Ishte i veshur me rrobën e priftit. U çudita, sepse ai kishte ditë të tëra pa u parë në rrugë, ndaj dhe s'kishte nga vinte. Po pastaj instinktivisht mendova se mos vallë ajo veshje ishte një lloj proteste e atij njeriu. M'u duk sikur të dy, vjehërr dhe dhëndër, ishin në kulmin e ndonjë diskutimi.

— Ku është Elsa? — pyeta.

— Në dhomën e saj. Më duket po lexon. Po të duash shko, — më tha prifti ftohtë, si të ishte një genie prej qiriri.

U ndjeva ngushtë, megjithatë shkova te dhoma e Elsës dhe trokita.

U çudit kur më pa. Edhe unë u çudita kur e pashë të përkulur mbi kitarën e saj, që nuk nxirrte tinguj.

— Pse erdhe?

— Për të të pyetur. Ke katër ditë që mungon. Nuk është mirë kështu. Po na afrojnë provimet...

— Nuk më lë babai...

— Ashtu?! Do t'i vëmë ndonjë fletërrufe që t'i luajë koka vendit. — u zemërova unë.

— Mos, të lutem, mos fol kështu! Nuk është aq i keq...

— Kush tha se është i keq. Në fund të fundit ai ka bërë një punë, tani do të bëjë një punë tjetër... Ky është një revolucion dhe ti,

Elsa, duhet ta bindësh babanë. Mbase jo vetëm ti, por edhe i fejuari yt.

Papritur ajo shpërtheu në dënesë dhe lotët e mëdhenj ranë në guvën e kitarës.

— Mos qaj, — i thashë, — ti je e madhe.

— Unë nuk e dua atë!

— Kë, të fejuarin?

— Nuk e dua, nuk...

Dera u hap me forcë. Ktheva kokën menjëherë dhe pashë të atin e Elsës. Pas tij qëndronte shkrimtari, i zverdhur e tepër nervoz.

— Elsa, çohu dhe shko në shkollë! — foli prifti.

Ajo shtangu.

— Tani?!

— Po, tani.

— Është e sëmurë, më mirë nesër, — tha shkrimtari me ton të prerë.

— Këtë e di unë, — tha prifti.

Elsa nuk dinte si të vepronte. Unë edhe më keq. S'po kuptoja asgjë. Sikur kisha hyrë në mes të një drame të panjohur, ku nuk i dija rolet që luanin personazhet. Edhe aty nuk mund të sqarohesha. Elsa u bë gati shpejt, mori çantën dhe dolëm.

— Ah, — ia bëri, — më dukej sikur isha mbyllur në një kishë. Nuk e dua. më kupton, nuk e dua! S'është problemi thiesht për mo-shën, por ai se ç'ka diçka të keqe në shpirt.

Nëse babai ka qenë një prift i mirë, ai është një prift shpirtlig.

Isha i çarmatosur. Tani po i kuptoja disi situatat dramatike dhe ngjarjen në dhomën e Elsës.

— Si ka mundësi? — e pyeta.

— Ja që ka, — u hodh ajo me një tjetër timbër zëri. — Është më lehtë t'i heqësh rrasën tim eti dhe shumë më vështirë t'i heqësh veladonin atij.

Heshti.

— Nuk di si t'ia bëj... — më tha pas pak. — Vetëm ty po ta them: nuk e dua! Ai ngul-te këmbë që të mungoja e jo im atë.

— Po pse?

— Sepse në thelb ai është besimtar, kupton? Dhe prindërit të tillë i ka. Bile ndaj ka ngulur këmbë për t'u fejuar me mua.

— Ngaqë ishe vajzë prifti?

— Pikërisht ... Pastaj, pastaj ti nuk e merr me mend se sa libra fetarë ka ai në bibliotekën e tij.

— Edhe mund t'i ketë ... Librat janë kulturë, aq më tepër për një shkrimtar...

— Po ai i lexon ata si një i dehur. Shpesh... — Elsa ecte dhe fliste me zë të ngashëryer.

— Mos qaj, — i thashë. — Çfarë shpesh?

— Shpesh më komentonte Biblën, Ungjillin e libra të tjerë;

— Po ti çfarë thoshe?

— Unë qeshja. Bile ai ka shkruar një poemë ku më ka krahasuar me madonën... Ti e kupton, nuk ishin situatat si tani...

— Kuptoj, kuptoj, — i thashë unë. — Po babai yt pse ishte veshur me rasë?

— Sepse, turp ta them, po ai vetëm një palë rroba të vjetra civile ka. Dhe ato ia lava para se të vije ti. Babai, megjithëse është tronditur shumë, në disa gjëra e kundërshton atë, të fejuarin...

— Për çfarë?

— Po ja, për mungesën time në shkollë, për shembull.

— Po të duash ti. Elsa, këto i diskutojmë në organizatën e rinisë, — i thashë.

— Nuk e di, nuk e di, — m'u përgjigji dhe nga sytë e bukur përsëri i vesuan lot të pastër.

**Qershor, 1988**

## Pjeshka

Kur ai u kthye në zyrë, Irena mungonte. Mbi tryezë kishte lënë një shënim: *Pirro, unë nisja urgjent me shërbim për në Korçë. Më vjen keq që nuk e vazhduam bisedën tonë interesante.* Vetëm i kaq. Ai qeshi. Në duar mbante dy pjeshkë të mëdha, që sapo i kishin bërë për të, i ngrënë me Irenën. Kur mendonte për të, i mjegullohej koka dhe një dritë ia përshkonte tërë trupin. Bashkë bisedonin për çdo gjë, për jetën, punën, filmat, shërbimet, tregonin anekdota e barcelleta dhe natyrisht vazhdimisht qeshnin. Të

Kur hyri të nesërmen në mëngjes, zyra kundërmonte erë pjeshkë. Me Tilin kishin folur gjatë, se tani i hapeshin njëri-tjetrit. Pirroja kishte vendosur ta kërkonte Irenën për grua. Kjo ishte diçka e natyrshme, po sepse, sa herë e mendonte këtë, ndihej tepër i turbulluar. Fjala «shok» i dilte përpara, i kumbonte në vesh. Ja që kjo fjalë ndodhka që t'u bëka pengesë, mendoi ai. Pjeshka që gjithnjë e freskët, e verdhë, me faqe si në të kuqe. Ai kujtoi kur bashkë me Irenën, gjatë një shërbimi për në Elbasan, rrugës, kishte ngrënë pjeshkë. Atëherë ishin stazhierë. Faktorinoja u kishte tërhequr vërejtje dhe Irena që skuqur nga turpi.

Ishte dita e dytë e shërbimit të Irenës dhe atij nuk i bëhej asnjë punë. Në zyrë hyri Drita, një vajzë simpatike, disenjatore.

— E, Pirro, vetëm, ëë?

— Jo, me ty, — ndërhyri ai menjëherë. Ajo qeshi.

— Je bërë i shkathët. Sa herë që ikën Irena, ti shkathtësohesh, — tha Drita duke mbyllur derën pas vetes.

Ja dhe një thumb, mendoi Pirroja. Kaq i ri e kaq thumba, vaj hallit, sikur të isha beqar tridhjetë a tridhjetepesëvjeçar. U përkul mbi projekt dhe nisi të punonte. Kurse pjeshka rrinte mbyllur atje, në sirtar.

Në ditën e tretë të shërbimit Irena u kthye. Hyri në zyrë gjithë gjallëri. Pirroja



e dinte se ajo, do të fliste pa pushim. Ishte një natyrë që gjithnjë donte të kujtonte e të tregonte.

— Në Korçë, tek agjencia takoj, disa shokë të gazetës «Bashkimi». Me njërin jemi komshinj. Po ti, Irenë, më pyeti. Për në Tiranë, i them. Eja me ne, më thotë Meti, kështu e quajnë komshiun. Pa bërë fjalë, hipa. Udhëtim i bukur! Njerëz të zgjuar. Shkuam në Drilon. Atje hëngrëm edhe drekën. Meti ishte gjithë humor. Madje nisi të më ngacmonte për punë fejese. Por unë hiç. Se këta gazetarët ta marrin erzin menjëherë. Në Drilon shëtitem me varkë. Bëmë edhe fotografi. Më e madhja është se kam bërë një pozë me një mjellmë që notonte pranë nesh. Ti e di që në Drilon ka shumë mjellma. Vura re se mjellmat kanë një krenari të çuditshme... Të them të drejtën, këtë e vuri re Meti, bile ai u shpreh me këtë figurë...

Ajo vazhdonte të fliste. Ai e dëgjonte, po si nëpër mjegull e pa kujdes. Hapi ngadalë sirtarin. Pjeshka që ishte aty që prej tre ditësh, e kishte humbur freskinë. Edhe aromën gjithashtu. Ai ndjeu diçka ta sëmbonte. E kuptoi se ishte xhelozia, një pjeshkë e verdhë. Irena fliste me kaq entuziazëm për atë shërbim, për udhëtimin e bukur, për atë... Met gazetarin. Pjeshka vazhdonte të pozonte, por tashmë e lodhur. Ai e mbylli sirtarin.

— Ç'është kjo aromë pjeshke? — pyeti Irena.

— Si? Pjeshke? — e pyeti Pirroja. — Të duket ty...

— Dhe pastaj nga Pogradeci erdhëm drejt e në Tiranë. Gjatë gjithë rrugës kënduam. Dhe çuditërisht ai Meti këndonte shumë bukur, sidomos këngët e Veriut i qante.

Pirros nuk iu durua dhe fare pa takt tha:

— Ky Meti yt është rapsod, apo gazetar?...

Irena heshti një çast, pastaj u afrua dhe e shkundi:

— Ej, Pirro, mos më ofendo, të kam shok, por...

— Shok, — përsëriti ai nëpër dhëmbë. Vetëm kaq tha.

— Sa i çuditshëm që je, — tha ajo dhe u ul në karrigen e saj.

Ai vendosi të mos i thoshte gjë për pjeshkën, që e kishte dhënë të gjithë aromën gjatë tri ditëve të pritjes.

## Daullet e çuditshme

Kisha vetëm një javë punë si instruktor partie, kur në zyrë u paraqit një djalosh, mo-shatar me mua, pra rreth njëzet e pesë vjeç. Dukej i druajtur dhe nga nervozizmi pleks-te herë pas here gishtërinjtë e trashë. E fto-va të ulëj në karrigen përballë.

— Nga të kemi? — e pyeta.

— Nga fshatrat këtu pranë, — m'u për-gjigj.

— Si e ke hallin?

Një çast nuk foli. Pastaj, i çliruar nga emocionet, nisi të fliste me zjarr. Ai tregonte

e mua më dukej sikur dëgjoja nga ato tregimet për Sherlock Holmsin, që në atë kohë, pra në fillim të viteve pesëdhjetë, botoheshin në revistat tona. «Ngjarje të tilla, gati anekdotike, ndodhin shpesh, të nxitura nga injoranca», po mendoja.

E quanin Veli Gjatori. Ishte martuar para dy javësh dhe, siç më tregoi, asnjë natë nuk kish bërë rehat në shtratin bashkëshortor. Sapo binte qetësia dhe shuheshin fenerët, nën dyshemenë e dhomës së çiftit dëgjoeshin disa daulle të çuditshme dhe një zhurmë e ngjashme me hapat në një valle të dehurish. E shoqja, Sadushi, zverdhej si lulla e kungullit nga frika.

«Kjo është vallja e shtrigave, vallja e shtrigave», — kish thirrur ajo natën e dytë.

«Çfarë thua kështu, o Dush? — i ish kthyer Veliu. — Ku ka shtriga te ne, në shtëpinë tonë»...

«Ka, o burrë, ka», dhe ajo i ish tulatur në gjoks duke u dridhur.

Daullet e çuditshme vazhdonin të binin në mënyrë të shurdhët në të gjithë dyshemenë, veçanërisht diku poshtë krevatit. Veliu i kish vënë veshin dyshemesë, po nuk e kish identifikuar dot zhurmën. Ishin tinguj të çuditshëm. S'mbyllnin sy tërë natën, vetëm përgjonin. Veliu s'dinte çfarë të bënte. I vinte keq për të shoqen.

«Duhet të jetë valle shtrigash, — i tho-

shte ajo. — Mbase kam shkelur ndonjë hije, ose më ka marrë mësysh ndonjë plakë. E mban mend atë plakën, nënën e Sabriut, si më tha? «Ka dalë nuse e bukur, e bukur si Duda...»

«Po ti i pëlqeve fjalët e saj», i ish kthyer Veliu.

«I pëlqeva, i pëlqeva, po tani vras mendjen e them: Duda është e vdekur. Për të ka edhe këngë. Përse nëna e Sabriut më krahasoi me një të vdekur?!»

«Mos u prish mendsh tani», i kish thënë Veliu.

Po e shoqja kërkonte të çlirohej nga frika nëpërmjet hamendjeve absurde.

*Duda ish prej Elbasani,  
Duda ish e shkoi e vate,  
iu mbush varri me manushaqe.*

Po ç'lidhje kishte Duda e këngës, nëna e Sabriut dhe ajo valle e çuditshme atje poshtë shtratit bashkëshortor?

Kaluan edhe tri net të tjera. Të njëjtat daulle, i njëjti ritual. Dhe natyrisht, Dushi me frikën e ndonjë magjie. Veliut i duhej të qetësonte të shoqen, po s'dinte sesi, ndaj përsëriste vetëm:

«Po jo, moj Dush, nuk ka as lugetër, as diai, as hije e as magji.»

Mirëpo ajo ia mbyllte gojën me një pyetje të shkurtër:

«Po atëherë, çfarë janë?»

Pa ç'pa, Veliu vendosi të fliste me nënën. Babai, i kish vdekur para katër vjetësh dhe nëna pyetej për çdo gjë në shtëpi. Edhe nëna i kish thënë se mos ishin hije të vdekurish, se mundej që nusen ta kishin përfolur, se nusja mund të kish shkelur ndonjë hije, se ajo, nusja, mund të kish truar natën... Atëherë Veliu i qe kthyer i inatosur:

«Pse nusja e jo dhëndri?!»

Nëna kishte heshtur. Pastaj edhe atë e kish pllakosur frika, madje çuditej se si nuk e kish dëgjuar atë zhurmë të misterhme, që ajo e quante «zhurmë djajsh». Veliu i kish treguar për nënën e Sabriut dhe për Dudën e vdekur. Nëna e shkretë qe ngatërruar fare e kish mbledhur supet.

«Eja hyjmë njëherë në dhomën poshtë, nga vjen zhurma», kish thënë ajo.

«Kam hyrë çdo mëngjes atje», i kish thënë Veliu.

«Dhe çfarë?»

«Si çfarë?... Asgjë. Veç misrit asgjë tjetër. Po zhurma dëgjohej natën, vetëm natën vonë, kur të gjithë biem të flemë.»

«Po, po, vetëm natën, e kuptoj...» kish përsëritur si e menduar nëna.

Vendosën që atë natë bashkë me çiftin të përgjonte edhe ajo. Të tre u mblodhën te dhoma e çiftit. S'kaloi shumë dhe atje

poshtë, në depon e misrit, nisën daullet e çuditshme.

«E dëgjon, moj nënë? — tha tërë frikë Sadushi. — Unë them se këto janë shtriga, djaj, hije, lugetër, kështu janë... Të shkretët ne!»

«Shshsht! Pusho, nuse, se të dëgjojnë e s'është mirë...»

«Kush më dëgjon?!»

«Ato, pra, ato që kërcejnë atje poshtë.»

Edhe plakën e kish pushtuar një ankth i akullt.

Ranë të flinin, me atë zhurmë të ngjashme me zhurmën e shiut në pullaze të llamarinta, po jo nanuritëse. Përkundrazi, Vallja e hijeve, apo e shtrigave, shuhej në të gdhirë. Veliu kish dëgjuar se fantazmat largoheshin pa zbardhur dita. Në ushtri kish lexuar një tragjedi të Shekspirit, ku fantazma e një mbreti largohej sapo këndonte gjeli i parë. Edhe fantazmat atje, nën dyshemenë e tij, kishin po këtë rregull. Kështu vazhduan të shqetësohen dymbëdhjetë net rresht. Nëna e Veliut ishte bërë shumë merak, kish-te folur me dy-tri gra të tjera të fshatit dhe ato ishin po në një mendje me të. Për krahasimin e plakës së Sabriut, se nusja ishte më e bukur edhe se Duda e këngës, ajo kish folur pak e larg e larg, sepse kish frikë mos këto fjalë shkonin në veshin e asaj plake të ser-të e kush e dëgjonte pastaj.

— Tani, — përfundoi së treguari Veliu, — nëna me nusen kanë dalë në pazar për të blerë diçka, kurse unë vendosa të vija këtu. Mbase u nxitova që erdha, po s'di sesi. Vitet e ushtrisë më mësuan shumë gjëra. Them se ato s'janë as hije, as shtriga e as lugetër.

— Po mirë, ndonjë natë a nuk ke hyrë në atë depon e misrit, ëë? — e pyeta dhëndrin e shqetësuar. Ai heshti një çast.

— Jo, shoku Ismet, s'kam hyrë. Si të them, frika, gruaja, nëna... Kam hyrë ditën, po në mes të valles së... (u kuptua që nuk desh të thoshte «valles së hijeve») nuk kam hyrë.

— Atëherë eja shkojmë e hyjmë së bashku, — i thashë. — Ne jemi të rinj e duhet të tregohemi më të guximshëm.

Të dy vendosëm që gjatë rrugës për në fshat të mos e zinin në gojë atë histori të çuditshme, sepse edhe nënës, edhe Sadushit nuk do t'u vinte mirë që Veliu erdhi në Komitetin e Partisë. Gjatë rrugës i hyra në zemër nënës së Veliut. Si rastësisht Veliu më ftoi për darkë dhe unë pranova me gjithë qejf. Hymë në shtëpi dhe aty pranë oxhakut, në dhomën e katit të parë, ndezëm, shuam e rindezëm biseda nga më të ndryshmet, veç te misteri i atyre netve të çuditshme ende nuk kishim ndalur.

Duhej të ishte ora tetë e mbrëmjes, kur në dhomë hyri edhe një mysafire. Ishte plakka e Sabriut, ajo që e kishte krahasuar nu-



sen me Dudën e këngës popullore. Vura re se nëna e Veliut dhe nusja u tronditën së tepërmi nga ardhja e plakës. Veliu nuk e bëri veten, kurse mua, që e dija ku rrihte çekani i tyre, ardhja e mysafires jo vetëm që më ngrohu, po m'u duk si e porositur. I shkela syrin Veliut. Ai më buzëqeshi.

— Erdha vetë, — foli plaka. Dëgjova për shqetësimin tuaj dhe erdha...

Heshti një çast, pa nga unë dhe vazhdoi:

— Nuk bëtë mirë që s'më treguat mua plakës. Jam tetëdhjetë e kusur dhe di më shumë se ju... Po ti, more bir, kush je, apo mos je ndonjë çudibërës?

Unë s'u përmbajta dhe qesha. Veliu gjithashtu.

— Është një shok i kulturës, — sqaroi nëna e Veliut. — E bëmë rrugën bashkë dhe sot do të bujë këtu te ne.

— Shumë mirë, — tha plaka, — dhe aq më mirë që u marrka me kulturë!

Ishte aq e gjallë, sa më dukej sikur në damarë i vraponte prush i shkrirë.

— Po shqetësimin e Gjatorëve a e more vesh, mor bir? — më pyeti.

Ishte një pyetje e drejtpërdrejtë dhe e çiltër, saqë më çarmatosi dhe s'dija si t'i përgjigjesha. Po t'i thosha «po», nëna dhe nusja e Veliut do ta kuptonin, lojën tonë e s'do t'u vinte mirë; po t'i thosha «jo», kjo, mbase do ta bënte të druajtur e fjalëpaktë mysafiren e zjarhtë.

— Diçka dëgjova larg e larg nga goja e Veliut, — iu përgjigjja mysafires së mençur.

— Nuk t'i tregoi të gjitha Veliu, ëë? Gabim e kanë. Lëri të tjerat, po më kanë futur edhe mua në valle, e pse, për një llaf të mirë që nxora nga zemra për nusen.

Nëna e Veliut kafshoi buzën e poshtme. Ja, pra, megjithëse ajo ishte munduar të mos ndalej tek ai krahasimi mes nuses dhe Dudës së këngës, përsëri plaka e Sabriut e kish marrë që e kish marrë vesh.

Plaka e shtëpisë u zu ngushtë.

— S'ka gjë, — i foli plaka e Sabriut. — Nuk kam ardhur as të ankohem, as t'ju hakërrehem e as të betohem. Kam ardhur t'ju ndihmoj.

Të gjithë heshtëm. Mendova se ishte koha të ndërhyja.

— Si mund t'i ndihmosh, moj nënë? — e pyeta.

— Shumë thjesht, or djalë. Do të hyj në atë dhomë ku thonë se hidhkan valle djajtë e do t'i përzë. Ja, këtë do të bëj.

— Jo, t'u bëfsha, jo, — ia ktheu nëna e Veliut. — Nuk lozim këtu.

— E po s'do të të pyes ty. Të shohim djajtë njëherë.

Unë s'u përmbajta e qesha me zë. Plaka e Sabriut më pa pjerrtas.

— Mirë e ke, — i thashë.

— Si, edhe «mirë e ke», edhe më qesh...

Dëgjo këtu ti, djalë, kjo familje ka hall të madh. Ti je i ardhur këtu. Edhe unë nuk jam e huaj. Po hallin e këtyre s'e kam. Ndaj bëhu gati të zbresim poshtë!

Këto fjalë ajo i tha prerë, si të lexonte një vendim gjykatësi. Nuk shkante ta sqaroja atë plakë të zjarrtë e t'i thosha se pikërisht për këtë gjë isha shkukur edhe unë nga zyra ime atje në qytet.

— Në fillim ngjitemi sipër në dhomën tonë, — tha Veliu, — Ora e... (prapë u duk se deshi të shtonte «e djajve») po afron.

Heshturazi u ngjitëm në dhomën e çiftit. Nusja ishte kyçur brenda vetes, kurse nëna e Veliut s'dinte çfarë të bënte. Pas pak, si pa e harruar orën e caktuar, dëgjuam ritmin e daulleve të çuditshme, që për mua dhe plakën e Sabriut ishte një rit i panjohur. Por vura re se plaka e sertë mblodhi menjëherë buzët e saj të holla, picërroi sytë e vegjël e të hirtë, anoi pak djathtas kokën e mbledhur me shami të zezë, si të donte të përgjonte më mirë atë ritëm, atë valle të çuditshme që hidhej diku poshtë dyshemesë. Dhe papritmas qeshi.

— He, he! — ia bëri.

— Ç'ke?! — e pyeti nëna e Veliut.

— Më duket se e gjeta. Eja të zbresim!  
Mos kini frikë!

Veliu mori fenerin dhe më pa në sy.

51 II — Zbresim! — thashë unë. — Ti, nënë e Veliut, qëndro pranë nuses.

Porta e hyrjes në dhomën-bodrum ishte poshtë shkallëve të drunjta. Këtej daullet e çuditshme nuk dëgjoheshin aq sa atje lart, në dhomën e çiftit, sepse edhe muri ishte prej guri.

— Ma jep mua fenerin, — tha plaka dhe ndali para portës. — Ju, djem, mbuloni fytyrën me krah kur të hyni. Ja, kështu, — dhe plaka e shkathët vuri parakrahun e majtë para fytyrës, pastaj shtyu portën e bodrumit.

Hymë të tre.

Ajo që pamë, që diçka vërtet e çuditshme dhe tepër e papritur. As djaj, as fantazma, as lugetër, natyrisht, po disa qindra baldosa të zakonshme, që kërcenin si të çoroditura e përplaseshin në tavanin e bodrumit, pra në dyshemenë e dhomës së çiftit.

— Heeeee! — ia bëri plaka përsëri. — Shikoni, shikoni djajtë!

— Çudi! Shiko! Shiko! — habitej dhe Veliu.

— Baldosat janë dehur, — sqaroi plaka. — Misri që kanë ngrënë, i ka dehur përnatë. O Veli! Ngjitu, ngjitu e thuaju nënës e nuses të vijnë e të shohin djajtë, — bëri shaka ajo.

Veliu doli gati me vrap. Unë me plakën e mençur qëndruam në bodrum, mes orgjisë

së baldosave. Më dukej një histori sa e çuditshme, aq dhe qesharake e banale për fundin e saj.

— Kjo nëna e Veliut është grua e mirë, po jo e zgjuar, — më tha plaka. — Gjithë ky shqetësim e për çfarë? Për hiçgjë!

Nuk fola.

— Pale, — vazhdoi plaka, — bënë gjithë atë zhurmë. Jo po ka shkelur hije, jo po plaka e Sabriut ka thënë për nusen se...

Hynë tre pjesëtarët e asaj shtëpie dhe plaka e ndërpreu fjalën për një çast.

— E, moj Naile, — iu drejtua ajo nënës së Veliut, — e shikoni se ç'janë?! Baldosa janë! Po ju hanë misrin e po dehen më keq se pijanecët në dasma. E, sa për atë fjalën që kam thënë njëherë, e them prapë: «Nusja ishte dhe është e bukur, e pse jo, edhe më e bukur se Duda e këngës. Në fund të fundit këngët vetë i kemi bërë, apo jo, mor djalë?»

— Ashtu është, nënë, — iu përgjigja unë dhe e kapa prej supesh atë plakëz të vogël e aq të mençur.

— Tani shikoni, shikoni rrugën nga hyjnë e nga dalin këto baldosa, — plaka afroi fenerin në dyshemenë prej dheu, ku poshtë murit ishin formuar disa si ullukë horizontale, nga hynin e dilnin ato qindra kafshë të pështira.

— Qyqja. Qyqja! — ia bënte nëna e Veliut.

Sadushi ishte shtangur sikur nuk u besonte syve. Pastaj nisi të qante. Ndjenja e gëzimit, çlirimi nga ai ankth i gjatë dyjavor, gjithçka përzihej në atë botën e saj të pastër.

— Mos qaj, nuse, mos qaj, — i tha plaka. — Merre, Veli, ngjituni sipër e flini rehat sot e motmot. Kurse nesër mbylluani udhën baldosave qejflesha, — bëri humor ajo dhe ne qeshëm me gjithë shpirt.

Pastaj, kur u ngjitëm lart, i tregova plakës e natyrisht edhe nënës e nuses së Veliut se edhe unë për të zgjidhur hallin e tyre kisha vajtur. Plaka qeshi e më rroku për qafe. Pastaj picërroi sytë e vegjël e më tha:

— Domethënë, edhe po të mos kisha ardhur unë, ti do të hyje në depo e do t'i zbuloje djajtë e misrit, apo jo? Të lumtë!

— Jo, nënë, — i thashë, — ky ishte zbulimi yt. Përvoja jote na ndihmoi shumë.

— Mirë, mirë, — tha plaka duke u ngritur buzagaz.

E përcollëm deri te porta e jashtme. Daullet e çuditshme dëgjoheshin mbyturazi.

— Kërcejnë vallen e fundit, — foli unë. — Sapo të gdhijë dhe...

— Nesër në mëngjes do të vij përsëri, — tha plaka e Sabriut.

— Të presim! — thamë të katër njëzëri.

## U lërima mes akujve

Anija nuk mund të thuhej se po lundronte. Ajo po rrëshqiste në akull. Një si ministri e padukshme kish sheshuar valëzimin dhe kish formuar një shtresë të trashë akulli. Nasit, si detar i vjetër, i kish ndodhur edhe

herë tjetër ta shihte detin kështu. Madje njëherë kishte parë një skenë të çuditshme: qytetarë duke rrëshqitur me patina mes për mes detit. Ata vinin nga porti T., të gjallë e gazmorë, me një ftohtësirë të shkrirë në sytë e hirtë. Bënin patinazh dhe shpesh vallëzonin vals.

— Akulli është shumë i keq në lundrim, — tha Nasi me zë. — Ja, ata të «Tiranës» janë bllokuar në Kil Kanal. Duhet kujdes. Ky akull sot është me rrezik. Ndonjëherë edhe ka ndodhur që anijet të bien në grackën e akujve gjigantë dhe të thërrmohen si kokërra e grurit në mokër... Raste të rralla, natyrisht. Petrit, preje timonin djathtas! Ashtu! Vazhdo të ecësh! Bukur!

Kapiteni fliste me timonierin, me shikim të hedhur tej, në pafundësinë e detit të akulluar. Kishin plot tetëmbëdhjetë orë mes akullit. Mirë që ishin furnizuar me karburant të bollshëm dhe po e përballonin këtë rrugë që po zgjatej ca si shumë.

— Sa larg bregut jemi? — pyeti Petriti.

— Rreth shtatë-tetë milje, — sqaroi kapiteni duke vënë dylbitë në sy. — Ja, duket dhe qyteti.

Atje, disa centimetra përpara, te xhamat optikë të dylbive, parakalonin qyteti dhe porti i huaj, të zhytur në një mjegull të lehtë, vozitëse. Nga distanca e madhe lëvizjet ishin sfumuar dhe qyteti verior dukej si i ngrirë.



— Si një ulok, — pëshpëriti Nasi Gorana.

— Si? — pyeti Petriti, i përqendruar, me shikimin ngulur përpara bashit, drejt së cilit, si një rebel i pabindur, po vinte, duke u lëkundur majtas e djathtas, një copë e madhe akulli, siç duket e shkëputur nga trupi i ndonjë ajsbergu të largët.

— Qyteti ngjan si i shkretë, — thashë... — I dëgjove lajmet? Janë në gjendje shtet-rrethimi. Ku fut hundët sovjetiku apo amerikani, gjëmën ke. Qytete tërë ankth, tërë akull, ja ç'qytete janë...

Timonieri vuri lehtë buzën në gaz. Ia njihte mirë tipin kapitenit të tij, i cili s'përmbahej, veçanërisht kur ishte fjala për vendet revizioniste. Copa rebele e akullit sikur u tremb nga bashi i hekurt dhe u shmang pak majtas, si pa rënë në sy, duke u lëkundur përsëri sa në një rënë anë, në tjetrën. Në timonieri hyri radisti dhe raportoi:

— Kapiten, radiogramin e transmetova. Nga kapiteneria e portit lajmërojnë se mund të hyjmë.

— Shumë mirë, atëherë!  
Radisti u largua. Nasi vazhdoi të sodiste me dylbi. Vetëm në qendër dalloheshin objektet e qytetit; disa qiellgërvishtëse, oxhakët e uzinave dhe fabrikave, kurse më tej, majtas dhe djathtas, mjegulla e dendur të pengonte shikimin.

Kapiteni i drejtoi dylbitë mbi det. Po kjo? Nasi e ndali shikimin në një pikë të zezë, thua jse dy milje larg. Po kjo, pyeti përsëri veten. Mbase është ndonjë fokë, mendoi. Apo ndonjë kafshë tjetër deti. Vetëm një pikë e zezë dallohej. Asgjë tjetër. I largoi përsëri dylbitë nga ajo pikë. Përsëri fushë e bardhë. Rrezet e pjerrëta të diellit që po perëndonte zunë t'i jepnin pistës së detit reflekse ngjyrë gjaku. Kalonin sekonda dhe bashkë me reflekset e muzgut shtohesh edhe bukuria. Po ajo pika e zezë? Ktheu pak kokën dhe fiksoi dylbitë. Thua të jetë kafshë deti? Pika e zezë u shfaq përsëri, po këtë radhë më e madhe.

— Dalloj një pikë të zezë atje përpara, — i tha njërit prej oficerëve të shërbimit që i ndodhej pranë.

— Ku, kapedan?

— Është ca larg. Na, merri dylbitë.

I zgjati tjetrit dylbitë dhe shtrëngoi sytë me gishtërinj për t'i çlodhur.

— Shiko andej, ja, dallon një pikë të zezë?

— Po, po... Kushedi ndonjë fokë... Ose ndonjë trug. ndonjë anije e mbytur, direk...

— Jo... Shikoje me kujdes. Pika e zezë sikur lëviz.

— Mirë e ke, kapiten. Po çfarë është, se?

Nasi vuri buzën në gaz.

— Patjetër që kafshë nga stereja.

— Është ujk, po, kapiten, ujk është...

— Ujk?! — pyeti Petriti gjithnjë i përqendruar te timoni.

— Kujdes timonin ti! — i tha Nasi. — Apo ke dëshirë të shohësh njëherë vetë me dylbi? Ma jep timonin mua!

Petriti, nga kërsheia, thuajse i nguli dylbitë në sy. Si ka mundësi, ujk në mes të detit! Kish dëgjuar për arinjtë e bardhë polarë, kish lexuar e parë në filma edhe për ujq e qen në shkretëtirat e bardha të Alaskës, po këtu, në afërsi të tokës, mbi det, nuk mund të përfytyronte kurrë një ujk. Ujku polar. Xhami i dylbive afronte çdo çast një ujk të madh që vraponte e vraponte mbi akuj.

— Vrapon dhe ulërin... Po ku shkon?! — foli Petriti me një notë habie.

— Asgjëkundi. Kushedi se çfarë i ka ndodhur atje në qytetin në shtetrrëhim.

— Mbase është i uritur, — foli oficeri. — Ky dimër ka qenë shumë i egër.

Ujku ishte afruar shumë dhe Nasi tani e shquante me sy. Edhe marinarët e tjerë e kishin vënë re egërsirën që nga obllat. Ujku vraponte dhe ulërinte. Ekuipazhi u gjallërua. Në timoneri hyri dhe nostromi i kuvertës.

— Shikoni, një goxha ujk! Ja ku e keni, atje! — briti ai i ngazëllyer si një fëmijë.

Me nostromin gjithnjë kështu ndodhte. Madje në një bllok të vogël xhepi i shënonte

të gjitha mbresat e sidomos sensacionet anekdotike. Nga dera e hapur e sallës së komandimit hynin zërat e shokëve që qeshnin e bënin shaka me egërsirën.

— Ua!... Uaa! — thërriste Prenga, i cili në rrëfimet nga fëmijëria ujkun e kishte gjithnjë personazh.

Një çast ujku u duk përsëri para bashit.

— S'qenka lodhur fare, — tha Nasi.

— Si duket, mezi e ka pritur këtë ditë, — qeshi Petriti.

Nga reflekset e muzgut, ujku kish marrë ngjyrë të kuqërremtë. Dhe deti i akullt dukej si një arenë e përgjakur. Megjithatë ujku nuk ishte i plagosur. Ulërinte gjithnjë me turinj nga anija. Petriti ktheu timonin pak majtas, për t'iu shmangur një cope të madhe akulli. Në këtë çast, disa metra më tutje, ujku rrëshqiti dhe ra në ujë.

— U mbyt! — u dëgjuan dy-tre zëra.

Po kafsha e zhytur e nxori kokën mbi ujë dhe notoi drejt një cope akulli. Me vështirësi kërkonte të ngulte thonjtë, por ishte e pamundur. Megjithatë gjeti një vend tjetër, si të shkallëzuar nga thyerja dhe u ngjit. Shkundi trupin për të kulluar ujin e për t'u ngrohur dhe ia krisi vrapit gati paralel me anijen. Kuzhinieri, Jani, doli në bord me një urë zjarri në dorë.

— Hiqe zjarrin, se do të na djegësh, — iu hakërrua një detar.

— Lërmë, më qafsh, se dua të bëj ca qyfyre, — tha tërë qejf kuzhinieri dhe u mbështet te bordi i djathtë.

Ujku e pikasi njeriun që mbante urën e zjarrit, por nuk donte t'ia dinte. Kuzhinieri tundte urën e zjarrit dhe vizatonte në ajër figura të ndryshme. Ujku vazhdonte vrapin pa e përfillur marinarin hokatar. Më në fund kafsha mbeti mbrapa dhe u mbulua nga errësira e natës.

## 2

Në mbrëmje anija u ancorua në port. Nga Veriu nisi të frynte erë e fortë. Temperatura kishte arritur 15 gradë nën zero. Jashtë nuk mund të dilej. Në sallën e çlodhjes, përballë ekranit të televizorit, detarët ndiqnin lajmet. Mes tyre ishte dhe Nasi Gorana, që herë pas here përkthente ato që i dukeshin me interes. Në ekran u shfaqën disa policë të veshur trashë për të përballuar të ftohtët e hidhur. Ata silleshin nëpër rrugë, ndalnin automjetet dhe qytetarët, kontrollonin dokumente. Mes tyre ishin edhe disa gen-ujq me rrjeta teli në gojë.

— Shko dhe merr një dru të ndezur,

Jani, — bëri shaka nostromi.

Plasi e qeshura.

Në këtë kohë te dera e sallës u duk oficeri i shërbimit.

— Kapiten, kanë ardhur dy nga autoritetet e portit.

— Ashtu? Ngjiti në dhomën time! I thoni dhe komisarit të vijë!

Nasi Gorana u ngrit. Çfarë duan, mendoj vetëtimthi, ndaj, sapo hyri komisari, Samiu, një djalë i ri, biond, të cilin shokët e ekuipazhit e thërritnin «detar i vonuar», ngaqë vite më parë kish punuar në stere, e pyeti:

— Ç'kërkojnë ata, Sami, ëë?

— Ma merr mendja se do të jetë diçka serioze, përderisa kanë marrë mundimin të dalin nga zyrat e ngrohta, — ia ktheu Samiu.

Dy të huajt hynë duke qeshur. Nasi dhe Samiu njuheshin me të saboardhurit.

— Uluni, — tha kapiteni duke bërë me dorë nga karriget.

Të huajt, pasi hoqën palltot dhe kokoret, zunë vend me kënaqësi. Samiu i shkeli syrin Nasit. Kapiteni qetë-qetë mori shishen e konjakut dhe mbushi katër gota. Dy të huajt i kthyen me fund.

— Kemi ardhur për t'ju propozuar diçka, — u hodh njëri prej tyre, një mesoburrë flokëkuq, me fytyrë rrumbullake.

— Çfarë pikërisht? — pyeti kapiteni.  
— Në këto kushte është tepër me interes për ju, — u hodh tjetri, gjithashtu rumbullak, por jo qimekuq.

— Në kushtet e grevës së dokerëve? — pyeti Samiu.

— Kuptohet, — tha qimekuqi. — Disa anije në kalatat e tjera kanë nisur të punojnë. Po të doni, edhe ju mund ta shpejtoni shkarkimin dhe ngarkimin e mallrave.

— Në ç'mënyrë? — pyeti kapiteni, që natyrisht e dinte si do t'i vente filli këtij prozimi.

Edhe Samiu kafshoi buzën e poshtme.

— Po ja, ne ju japim të gjitha mjetet, po njerëz nuk kemi, prandaj marinarët tuaj... Ata mund të punojnë.

— Të vihen në rolin e dokerëve tuaj?! — kërcëu Samiu.

Të dy vizitorët njëherësh tundën kokën në shenjë pohimi.

— Kështu do të fitoni shumë në kohë e natyrisht do të kurseni mijëra dollarë, — vazhdoi qimekuqi.

Samiu s'e përmbajti veten dhe u ngrit në këmbë.

— Kjo është gjë që s'bëhet, — tha Nasi Gorana, prerë, por me zë të ulët.

— Si të dëshironi, — foli qimekuqi. — Dokerët tanë mund ta zgjatin grevën. Edhe anijet e tjera...

— Nuk na interesojnë të tjerët, — u hodh komisari. — Ju e kuptoni fare mirë se kështu ne do të viheshim në rolin e grevë-thyesit.

— Mos e merrni kaq thellë, zotëri... Varet se çfarë natyre kanë këto greva...

— Kaq thellë?! — tha Nasi Gorana. — Aq thellë, sa s'ka ku të vejë. Dokerët janë dokerë dhe kuptohet natyra e grevës së tyre. Bile ju po na fyeni.

— Na vjen keq, kapiten! Një propozim miqësor qe. Asgjë më tepër.

— Kjo nuk bëhet, — tha Samiu, — do të presim sa të mbarojnë grevën dokerët tuaj.

Kapiteni, i inatosur, nuk i mbushi më gotat. Të dy autoritetet e portit u zunë ngushtë.

— Atëherë po largohemi, — tha qimekuqi duke u ngritur.

Nasi dhe Samiu heshtën.

Ata të dy veshën palltot e kokoret dhe bënë për nga dera.

— Ishte thjesht një propozim, u nisëm nga e mira.

— Kuptojmë, kuptojmë. — pohoi Samiu.

— Natën e mirë, atëherë!

— Natën e mirë!

Oficeri i shërbimit i shoqëroi dy të huajt deri te shkallët e anijes. Jashtë bënte ngricë e madhe. Uturima e erës që frynte nga veriu, i ngjante ulërimës së një lukunie ujqish!



Anija e ancoruar në kalatë priti shtatë ditë. Në të tetën shumica e dokerëve u kthyen. Sytë i kishin të enjtur. Thuajse nuk flinin fare. Herë pas here nxirrnin shishet me vodkë dhe pinin.

Anija mori rrugën e kthimit. Ky udhëtim qe një nga rejset e saj më të vështira. Përsëri do të çanin ujërat, megjithëse akujt kishin shkrirë në një pjesë të mirë të sipërfaqes së detit.

Ishin larguar disa milje nga porti, kur nostromi lajmëroi me zë të lartë:

— Djema, shikoni ujkun! Paska ngordhur!

Fytyrat u mbështetën në xhamat e obllave dhe panë se si mbi një copë akull, si në një ishull të vogël në formën e një pjate të përmbysur, qëndronte i shtrirë ujku. Kishte ngordhur. Mbase nga uria. Mbase nga lodhja. Mbase nga izolimi. Nga të tria bashkë.

3  
Ania e ankoran në kalatë priti shtatë  
ditë. Në të tjetër shumica e doketëve u këty-  
en. Ehtë i kalim i sajtur. Të çajës nuk li-  
niti fare. Hënë pas here nxjerrim shishtë me  
vockë dhe pinim.

Ania priti turmën e këtinatit Ky rube-  
titi për një nga një e kaq më të vështira.  
Përderi do të konin njëfarë megjithatë akujt  
këtu duket që në pjesë të mirë të sipër-  
tës së bërit.

Jabotëgjatëz dhe mijë nga pouti kur  
në të tjetër i shpërroi me të lartë.  
— Të çajës shikoni shkur! Paska ngor-

çunt  
Fytet u mbeshtetën në krahët e obla-  
ve dhe për të se si mbi qepetë e këtu si në një  
këmbë të vogël të formën e një piate të për-  
nivezuar qëndronin. I shpërroj njëkohë këto  
ngorçat. Mbase nga njëra Mbase nga lloji  
Mbase nga vonesa. Nga të çajës.

## Jetë deti

### Në vend të një kronike

Nuk e vura re që guriçkat me ngjyra të oborrit të asaj shtëpie të vjetër shkodrane ishin mozaikū i anijes për të cilën kisha ardhur të pyesja. Këtë ma thanë pak më vonë të zotët e shtëpisë. Atëherë dola përsëri në oborr, me ndihmën e një shkalle u ngjita në

manin e madh për ta fotografuar anijen nga lart. Sapo e futa në fokus, motovelorja lëvizti, ngriti dy spiranca si rrënjë të rënda dhe u shkul prej dheut të oborrit. Drejt detit, më tha. Drejt detit! Unë zbrita nga mani pasi e kisha fotografuar disa herë, po mozaiku i anijes me të vërtetë po më kërkonte detin. Ishte kthyer në origjinalin e vet, prej lisi e pishë, me karmën e veshur me bakër deri në vijën e gallxhimit. Dhe unë nuk isha më në oborr, po në mes hapësirës detare, në anijen e vjetër, si në fëmijëri. Hyra në dhomën e kapitenit. Dhoma, si dikur. Madje një llullë e madhe vazhdonte të tymoste.

«Si je? — më pyeti kapiteni me zërin e tij të trashë e të ngrohtë. — Qenke rritur. Kur ishe fëmijë me pantallona të shkurtra vije shpesh. Bocmani të donte shumë.»

«Po, — i thashë, — edhe ju qenkeni thijnur shumë, kapiten.»

Nuk guxova t'i thosha që kishte vdekur. Llulla, që më dukej magjike, vazhdonte të nxirrte tym, nga ku prisja të shfaqej papritmas ndonjë xhind i bukur. Hapa ditarin dhe nën dritën e një feneri zura të lexoja faqet e para. Përshkruhej një stuhi në afërsi të grykës së Vjosës, ku anija e ngarkuar me kripë u dëmtua në sistemin e velave. Pas riparimit, pronari ia shiti anijen tregtarit Asllan Velja. Atë mbrëmje të vitit 1927 tregtari, që e kish ngritur velën edhe në mbiemër, bëri një dar-

kë dhe anija u zbukurua si për festë. Kapiten ishte ulqinaku Met Ceka. Llulla e tij vazhdon-te të tymoste kujtime. Anija do të transportonte lëndë druri nga Kepi i Rodonit në portet e Mesdheut. Ditari ishte shumë i ngjeshur dhe, kur e shfletoja shpejt, dukej si një det në miniaturë. Shënimet u ngjanin valëve. Dhe firma e kapitenit në fund të çdo shënimi të kujtonte spiralet e tymit të llullës. Ai filloi të qeshte me zërin buçimtar.

«Përse qesh, kapiten?» — e pyeta.

«Sepse në ditar ti s'mund të lexosh të gjitha ndodhitë e kësaj anijeje. Aty ka vetëm fakte të vdekura, kurse ty të duhen fakte të gjalla, apo jo?»

«Natyrisht...»

«Dhe shkaku i qeshjes sime është pikërisht një fakt i tillë, tepër i çuditshëm dhe i pabesueshëm...»

«Kur ka ndodhur?» — e pyeta me padurim.

«Mos u ngut, mos u ngut, djalosh, — më tha kapiteni duke thithur si gjithnjë llullën e tij të madhe. — Atëherë, në vitet tri-dhjetë, në një mbrëmje vjeshte, kur ne ishim ancoruar në port, një detar vuri re se në anije kishte hyrë pa u ndier një njeri i çuditshëm, me një veshje të hekurt: pancir, helmë, këmbëza metalike, përkrenare dhe shpatë. Në fillim thamë se mos i kishin bërë sytë nga lodhja, po detari bënte be kokën e

nënës se që ndeshur përballë me atë njeri, madje ai, i hekurti, e kishte shtyrë me një rëndësi dhe heshturazi e tërë solemnitet kishte hyrë në timoneri. Ne vrapuam për të parë në timoneri, por edhe andej kishte ikur. Mbase do të jetë kthyer në breg, thamë njëzëri, po pa kaluar dy minuta erdhi një marinar i alarmuar dhe tha se në kuzhinën e anijes kishte parë një njeri të hekurt, që kish nxjerrë shpatën dhe luftonte me avullin që dilte nga kusia e madhe me supë. Atëherë unë thashë:

«Duhet të jetë njeriu që hiqet si don Kishot.»

«Ç'ishte ky njeri, kapiten?»

«Në ato vite, pas botimit në shqip të «Don Kishotit të Mançës», te ne, në Shqipëri, u shfaq një njeri që hiqej si don Kishot. Seku kish gjetur një veshje të hekurt, kish ngjeshur një shpatë të ndryshkur dhe, hipur mbi një kalë ngordhalaq, vërtitej nëpër fshatrat e qytetet tona. Për këtë aventurier hokatar flisnin edhe gazetatat. Kishte shumë anekdota e barceleta për njeriun që hiqej don Kishot. Thoshin se i kish bërë një letër ministrit të Ekonomisë dhe i kërkonte që në Shqipëri të mbilleshin banane me shumicë. Kështu, pas njëcind vjetësh, sipas tij, ne do të zinin një vend të rëndësishëm si eksportues të bananes. Nuk e kishte keq, derëzi! Po ne jse. Kishim hallin e velores sonë. Ai

kish hyrë brenda në anije e në s'po e gjenim. Ishim në prag të nisjes për në brigjet e Italisë. Kontrolluam edhe një herë me imtësi, por të vetëquajturin Don Kishot nuk e pamë gjëkund. Atëherë urdhërova të ngriheshin spirancat dhe u nisëm.

«Po Don Kishoti?»

«Prit tani... Do ti, nuk kishim lundruar as pesë milje, kur ai, i gjori Kishot, u duk në bandën e anijes. E kish zënë deti dhe po vllite. Përkrenaren dhe pancirin i kish hequr dhe i kish lënë diku mbi kuvertë. «Kush je ti?» — e pyeta. «Jam Don Kishoti. Dua të shkoj në Francë!» «Në Francë apo në Spanjë?» «Në Francë». — tha. «Po përse?» «Sepse këtu më duket sikur nuk po e kuptojnë qëllimin tim.» «Cilin qëllim?» — e pyeta. «Si, as ju nuk e dini, admiral?! — u habit Kishoti i gjorë që më gradoi më shumë nga ç'duhej. Ai lundroi me ne për ditë të tëra dhe gjatë gjithë kohës grupe detarësh mbledheshin rreth tij e bënë hoka. Qeshnim apo qanim, këtë nuk e dinim mirë, por që lotonim si asnjëherë tjetër, kjo ishte e vërteta. Në ditarin e anijes nuk shënova asgjë për udhëtarin e çuditshëm, sepse në fund të fundit nuk ishte mirë që pronari i anijes të merrte vesh një aventurë të tillë. Sapo arritëm në Itali, Kishoti u zhduk pa lënë gjurmë. Lexuam gazetë italiane të ditës, po nuk na zunë sytë asnjë lajm për njeriun me pancir dhe shpatë.

Duhet të jetë nisur për në Francë, menduam. Pasi shkarkuam lëndën e drurit dhe ngarkuam makarona e marmelatë, morëm një urdhër të papritur: me anijen tonë do të udhëtonin drejt brigjeve të Shqipërisë edhe dhjetë priftërinj. Kështu më urdhëroi një mesoburrë me syze miopi, që i ngjante një kukuvajke. Më paraqiti shkresën me vulën e pronarit dhe, doja a nuk doja unë, në mbrëmje të dhjetë priftërinjtë, si dhjetë pinguinë, zunë vend në anije, në kabinat e marinarëve. Detarët do të flinin ku të mundnin.»

«Po don Kishoti?» — pyeta me padurim kapitenin e fshehur pas tymit të llullës.

«Mos pyet atëherë kur s'duhet! — ma preu shkurt ai. Sapo u ngritën spirancat, nuk e di se si e për këtë as nuk e pyetëm, po don Kishotin e pamë në majë të direktut kryesor. Tundte shpatën në ajër dhe diçka i thoshte erës detare. I bëra shenjë të zbriste, sepse kisha frikë mos më dëmtonte direkt apo litarët e velave. Dhe ai, i përmalluar, zbriti dhe më përqafoi si vëlla. «Jam i lodhur shumë, — më tha. — Kam luftuar, kam shkruar dhjetëra letra e kam marrë një mijë përgjigje nga një mijë vende të botës...» Dhe papritmas m'u kthye: «Pse i morët priftërinjtë në anije, kapiten? Ata janë ters në lundrim.» Unë mblodha supet dhe iu përgjigja shkurt: «Urdhri është urdhër.» Po pikërisht me këtë frazë ai thuri një roman të



tërë gjatë atij lundrimi, që me të vërtetë na vajti shumë ters. Stuhia nisi në mesnatën tjetër. Era përplasej me forcë në direkët. Dallgët e mëdha kapërcenin kuvertën. Priftërinjtë u bënë dyllë të verdhë nga lemeria. Që të dhjetë i zuri deti keqas. Kurse don Kishoti qëndronte për mrekulli. Kish nisur një letër të gjatë për konsullin shqiptar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilit i kërkonte të gjente tregje për lëkurët e ushurnjézave, sepse nga shitja e tyre tregtarët dhe ekonomia mbretërore do të përfitonin shumë. Pastaj në «post scriptum» shkruante: *Ju falënderoj, zoti konsull, që numri i të emigruarve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara vazhdon të rritet. Mundet që një ditë, me një anije velore, ashtu si Kolombi, të vij edhe unë si emigrant. Juaji don Kishoti i...* Kur e mbaroi letrën, erdhi në kabinën time dhe ma zgjati për ta lexuar. Nuk ia prisha qejfin dhe, ndërsa unë zura ta lexoja, ai kishte fluturuar në kuvertë. U ngrita menjëherë pas tij, i frikësuar se mos e rrëmbenin dallgët. E gjeta të kapur fort në direkun e kicët. Thërriste me gjithë zërin: «Urdhri është urdhër! Po pse Parlamenti urdhëroi që barkat tona të paguajnë më shumë taksë se anijet italiane, pse?! Urdhri është urdhër! Po pse ju transportoni me anije këta priftërinj?! I mjeri unë, që s'kam një Sanço!» U përpoqa ta qetësoja. Ligji i ri që kish mira-

tuar parlamenti e dëmtonte shumë detarinë tonë e për këtë ne detarët protestuam edhe në qeveri, edhe në Parlament, dërguam delegacione edhe te mbreti, po më kot. Si duket, të vetëhequrit don Kishot papritmas i ish kujtuar ky fakt dhe shprehte zemërimin e tij përballë erës së fortë. Nën dritën e vetëtimave pashë se dy vela ishin grisur. «Mos u mërzit, kapiten, — më tha Kishoti, — mos u mërzit. Çdo hall e ka një zgjidhje. Ti po shikon velat e grisura, po mos u mërzit, kapiten. Zbresim poshtë të të jap një zgjidhje.» Ajo që ndodhi pastaj qe kulmi vetë. Kalonte në dhomat e priftërinjve duke ulërirë: «Urdhri është urdhër! Lartmadhëria e tij mbreti ka urdhëruar: hiqini veladonët! E kuptoni? Hiqini!» Priftërinjtë zgurdullonin sytë pa jetë përpara demonit të hekurt, që po u jepte një urdhër të çmendur. Të detyruar nga shpata e tij e zhveshur, të dhjetë veladonët u dorëzuan në duart e don Kishotit të frymëzuar tej mase. Detarët e mi vazhdonin të qeshnin me bëmat bujëmëdha të Kishotit. Edhe disa priftërinj qeshën nga zori.»

Këtu kapiteni thithi përsëri llullën dhe unë për të parën herë vura re se në të ishte gdhendur me mjeshtëri të rrallë velorja e dashur. Megjithatë nuk e ngacmova me ndonjë pvetje kureshtare, sepse nuk doja të largohesha nga ajo botë e gjallë ku më kish futur.

«Pastaj don Kishoti, — vazhdoi kapiteni, — me dhjetë veladonët e mbledhur si garçafë të zinj të palarë, vrapoi për në mensë. Kur iu afrova, qetë më tha: «Do ta kalojmë rrezikun, kapiten. Me këta veladonë do të bëjmë një ose dy vela të mëdha. Veçse duhen qepur fort!» Përsëri më habiti mendimi i tij i çmendur. Me shumë vështirësi e bindëm të na i jepte veladonët që sapo kish nisur t'i qepte. «Urdhri është urdhër!» m'u kthye ai duke m'i zgjatur cohat e zeza. Pastaj nxori letrën e penën e nisi të shkruante me një shkrim shatrapatra.

«Kujt ia shkruan këtë letër?» e pyeta.  
«Është sekret, po po ta besoj, — m'u përgjigj me ëmbëlsi, shtyu mënjane fletën e bardhë të saponisur dhe, si në humbje, vazhdoi: — Ju keni dëgjuar për një sirenë gjysmë grua e gjysmë peshk. E quanë Gitela. Ka lindur në Poloni në fundin e shekullit të kaluar. Tani jeton në Francë. Një nga shkaqet që kërkoja të shkoja në Francë ishte pikërisht takimi me Gitelën. Vendosa: ajo do të jetë Dylqinja ime!» «Po a shkua dot?» «Mos më ndërpritni!... Që thua ti, admiral, Gitela gjithë natën rri shtrirë në krevat, kurse nga mesi i natës e zbresin në një gjol të vogël të kopshtit, ku noton duke kënduar deri në mëngjes. Nuk gënjej, këto janë të vërteta gazetash.» «Po a e ke takuar ndonjëherë?» «Natyrisht, vetëm njerëz si unë mund të ta

kohen me të, — u mburr, dhe në sytë e tij vura re shkëlqimin e një aventure të pakryer. — «Dëgjomëni, më tha sirena Gitelë, unë jam poezia e personifikuar.» Dhe u puthëm...» Aventurën e tij me sirenën franceze, njeriu që hiqej si don Kishot ua tregoi edhe detarëve dhe të gjithë e dëgjonin gojëhapur, ashtu si dhe tregimet e tjera të tij. Po kur njëri nga shokët i bëri Kishotit një pyetje të vështirë: «Meqë ajo sirenë, nga mesi e poshtë është peshk, atëherë si do të mund të bëhet nënë», Kishoti qetë ia ktheu: «Ti nuk merr vesh fare nga bota... Rëndësi ka që Gitelë është një rast i veçantë dhe, duke qenë gjysmë peshk, do të notojë në det pa pasur nevojë të hipë në anije e të paguajë taksë, sipas ligjit të ri të parlamentit.» E qeshura jonë shpërtheu përsëri dhe kështu e kapërcyem atë det me tramundanë. Kur arritëm në molin e Durrësit, të dhjetë priftërinjtë i shtruam urgjentisht në spital, kursë i vetëhequri don Kishot, si gjithnjë, u zhduk pakuptuar dhe që atëherë ne nuk e pamë më, megjithëse aventurat e tij të cuditshme vazhduan të dëgjoheshin edhe disa vite më vonë.»

Kapiteni heshti. Heshta dhe unë. Kabina ishte mbushur me tymin e duhanit, ndaj nisën të më lotonin sytë.

«Edhe ti po qan?» — më pyeti.

«Jo, për çfarë?»

«Thashë, kushedi... don Kishoti... Gitelë...»

«Po me priftërinjtë çfarë u bë?»

«Kjo dihet. Ata u shpërndanë nëpër kishat katolike të vendit. Unë duhej t'i sillja në mol dhe i solla. Kaq e kisha detyrën.»

«Urdhri është urdhër!» — bëra shaka. Po kapiteni nuk qeshi. Nga buzët e tij vazhdimisht dilte e ngrihej vala e tymit të duhanit dhe mes nesh ishte krijuar një perde e trashë, si e thurur me fantazi legjendash. Në një çast kapiteni m'u zhduk pas perdes, si fantazmat para këngës së gjelit të parë. Atëherë e kuptova që me të vërtetë ai ishte një lloj fantazme me rrënjë kujtimesh, ndaj dhe nuk e kërkova, por ula sytë në ditarin e vjetër. Vazhdoja të isha fëmijë.

«Koha u zbut, saqë velat kishin fjetur fare dhe anija nuk po shkonte më shumë se një milje e gjysmë në orë.»

«Kostandinopol... Mars 1928. Para zbardhjes së ditës pati thyerje të drekut të parë.»

«Era e detit në drekë ishte e fortë. Ecëm me të gjitha velat.»

Në një ditar anijeje fjalët janë të kursyera, tepër telegrafike, po mes fletëve zbardhin vela, fryjnë erëra, përplasen dallgë, dritësojnë qytete mesdhetare... Papritmas një emër heroi. Më 1939, në një ditë të zakonshme prilli, ngjau dicka e rëndësishme, që kishte lidhje me detin: ushtria fashiste italiane sulmoi Shqipërinë. Një hero bie mbi

kështjellën e lashtë të Durrësit. Lotët e të vëllait, edhe ai marinar. Heshtja e detarëve të tjerë. Sapo ishin kthyer nga lundrimi i largët. Dhe toka — zi. Dhe qielli — zi. Dhe deti — zi. Dhe mbi këtë zi — e kuqja e gjakut...

Herën tjetër kapiteni Met Ceka m'u shfaq i veshur me rroba dimërore dhe çuditërisht, i ri. Kjo do të thotë se jemi në vitin 1943, atëherë kur anija e ngarkuar me cimento lundronte nga Bari për në Durrës. Valëzimi — mesatar. Kapiteni kishte kërkuar ta braktiste përkohësisht detin dhe të merrej me punën ilegale në qytet, po shokët e Qarkorit të Partisë i kishin thënë se ai mund t'i shërbente luftës edhe në anijen e tij. Dhe vërtet, nuk i kish shërbyer keq. Në këtë udhëtim në zemër të shkurtit papandehur velorja u sulmua nga një nëndetëse e fuqive aleate. Komanda e nëndetëses ishte signalizuar se një anije velore italiane do të transportonte municion në Shqipëri e do të nisei pikërisht nga porti i Barit. Goditjet e predhave të artilerisë së nëndetëses ishin të rënda dhe velores i shkaktuan dëme të mëdha. Met Cekës i dridhej buza dhe nofulla e poshtme kur shikonte që anijes i dëmtohejshin me radhë të tre direkët, bastuni i flokos, tamoretaja e bashit, kaushët e bukaporteve, një pjesë e kuvertës dhe një pjesë e kamari-nës së kicët në afërsi të kuzhinës...

Urdhrin «Hidhuni në det!» e dha atëherë kur bombardimi arriti pikun. Pjesëtarët e ekuipazhit u hodhën menjëherë mes dallgëve dhe përpiqeshin të shpëtonin me ç'të mundnin. Shumë predha kishin goditur në thasët e çimentos dhe kjo e ndihmoi anijen që të mos fundosej. Dhe komanda e nëndetëses, si duket pasi nuk pa shpërthimin e mundshëm, e kuptoi gabimin dhe u largua pa zhurmë, mbase në kërkim të anijes që i duhej. Po velorja e vogël e pësoi keq. E rikthyen përsëri në portin e Barit dhe, pasi shkar-kuan çimenton, e çuan për riparim në një port të afërm. Kështu kapiteni Met Ceka dhe detarëve të tjerë iu dha mundësia të ktheheshin në portin-mëmë atëherë kur lufta ishte në kulmin e saj. Po për këtë luftë ditari nuk fliste. Dhe kapiteni, që e dinte qëllimin tim, s'më foli për të. Tani përsëri ishte i thinjur dhe llulla përsëri i mbiu te buzët.

«Ti do të dish për anijen?» — vazhdoi ai.

«Po, — i thashë, — më intereson fati i saj. Në ditar nuk është shkruar asnjë rresht për jetën e saj në gjashtë vjet.»

Met Ceka qeshi duke më rrahur supet:

«Djalosh, — më tha, — në këta gjash-të vjet anija u paralizua.»

Fliste si për një njeri.

«Po, u paralizua në port. Të thashë, ne u kthyem disa ditë pasi na bombardoi nën-

detësja, kurse anija mbeti. Lufta ishte ndezur keqas. Italia kapitulloi dhe anija vazhdonte të rrinte në portin e Moltetës. Unë e dija çfarë ndodhte në anije.»

«Si e dinit?»

«Fare thjesht. Në anije pronari la rojë një nga detarët e ekuipazhit, Lorenc Pekun. Unë kisha letërkëmbim me Lorencin gati çdo muaj. Ja, shikoji sa letra kam këtu.»

Hapi sirtarin e tryezës së tij të vjetër dhe nxori një tufë letra të lidhura me fjongo të kaltër.

«Hapi, lexoji, po deshe», — më tha dhe, sipas zakonisht tonë të njohur, m'u zhduk prapa tymit të duhanit.

Zgjidha fjongon e kaltër dhe nisa të lexoja letrat, tashmë të vjetruara, po tepër të qarta për të kuptuar jetën e një anijeje në paralizë.

«... Jam bërë derr nga mërzia. Pothuajse gjithë kohën e kaloj në anije. Dal vetëm dy herë në javë për të bërë pazarin. Më është shpifur një zakon i ri: flas me zë dhe gjithnjë i drejtohem anijes. Bredh nëpër kuvertë, në kabina, në korridore, në kuzhinë, në hambarë, në timoneri, ngjitem në shkallëzat e direktëve dhe kudo flas, vetëm flas. Tani që jam i vetmuar, po e kuptoj, o kapiten, se ç'peshë të madhe kanë kujtimet!»

«... Pardje u ktheva herët. Hapa radion dhe dëgjova për kapitullimin e Italisë. Të



nesërmen nëpër rrugët e qytetit kishte një zhurmë të çuditshme, një si zukatje grerëzash. Një miku ynë, Emilioja, nëse të kujtohet, më ftoi për një birrë. Hymë në lokal dhe më foli për të vëllanë. Ka frikë se mos është vrarë. E quajnë Bepin Gracia. Po munde, interesohu njëherë dhe, nëse merr vesh gjë, më shkruaj.»

«... Emilioja vjen shpesh për vizitë në anije. U gëzua që i vëllai, Bepini, lufton si partizan në batalionin «Antonio Gramshi». Tani i tregoj vazhdimisht italianit për ndodhitë e velores sonë. Është shumë kureshtar dhe më dëgjon sikur do të më përpijë. Historinë e njeriut që hiqej don Kishot e pëlqen pa masë dhe deri tani ia kam treguar gati dhjetë herë me gjithë imtësitë. Më shkruaj për luftën, kapiten. Së shpejti do të shihemi.»

«... Sapo mora vesh që Shqipëria u çliroi, u bëra fëmijë e shkuar fëmijës. Dola në pazar, bleva një tortë të madhe, në formë vapori, bleva dhe ca verë të mirë dhe ftova në anije Emilion me dy shokë të tjerë. Emilioja pret t'i kthehet i vëllai. Dhe e di si më tha? «Ah, sikur të ishte anija në rregull, do të nisesha menjëherë.» S'ka faj. Tani jeton vetëm me nënën. Të tjerët ia hëngri lufta.»

«Ka mundësi që së shpejti të vij disa ditë në Shqipëri. Më ka marrë malli shumë. Zakonin që të flas me anijen nuk e kam hequr. Dhe ajo më dëgjon, megjithëse është

vjetruar ca dhe ka hallet e veta. Nuk e di si do t'i vejë fati. Interesohu për të, kapiten, si për babanë tënd.»

Si për babanë tënd... Çdo gjë po më bën-te përshtypje. Letrat ishin të shkurtra e plot mall. Ngrita kokën se mos shihja përsëri kapitenin, por akoma nuk kishte ardhur skena e shfaqjes së tij. Si duket, Met Ceka donte që unë të vazhdoja leximin e letrave të detarit të vetmuar atje, në anën tjetër të Adriatikut.

«... Emilioja u bë helm kur mori vesh vrasjen e Bepinit. Tani të kam ty në vend të vëllait, më thotë. Ka shumë dëshirë që të vijë në Shqipëri, të shohë vendet ku ka luftuar i vëllai. Është djalë i mirë, kapiten. Më vjen keq për fatin e familjes së tij... Çfarë thuhet për anijen tonë? A do të vijë dita ta shkulum që këtej? Më duket se natën, kur bie të fle, dëgjoj rënkime. Ne detarët e dimë mirë si dhembin plagët e një anijeje prej lisi e pishe. Si duket kërkon riatdhesim.»

Ngrita sytë dhe pashë kapitenin.

«Erdha, — më tha, — kisha pak punë në kuvertë.»

Nuk mund ta mendoja se ç'punë konkrete kishte lart kapiteni. Në atë çast bile harrova se ai ishte njeri i vdekur. Po kjo s'kishte aspak rëndësi. Më e rëndësishme ishte se ai njeri i mirë po më ndihmonte me kujtimet e tij të shumta, si dallgët.

«Vetëm disa ditë pas Çlirimit doli një

vendim edhe për sekuestrimin e mjeteve të transportit detar. Filluan të merreshin masa për kthimin e të gjitha anijeve shqiptare të mbetura në portet e huaja që nga vitet e Luftës së Dytë Botërore. Unë vazhdoja lehtërkëmbimin me Lorencin, të cilin këto lajme e gëzonin së tepërmi. Pastaj filloi remonti i plotë i anijes sonë dhe Lorenci më tregonte për plagët e saj të mbyllura, për motorin dhe velat e reja. Prisnim me padurim kthimin e anijes në port. Mua më bënë përsëri kapiten të saj dhe bashkë me ekuipazhin na u ngarkua detyra e marrjes së anijes. Pra shkuam ne te motovëlorja jonë. Ishte bërë si e re. Lorenci nuk përmbahej nga gëzimi. Kur po gatiteshim të niseshim për në Shqipëri, morëm një urdhër me rëndësi të veçantë: Me anijen tonë do të lundronte delegacioni italian i ngarkuar të merrte nga Shqipëria eshtrat e dëshmorëve partizanë të batalionit «Antonio Gramshi». Mes pjesëtarëve të delegacionit ishte një senator, ish-komisari i batalionit, si dhe një njeri që ti e njeh mirë nga letrat që lexove.»

«Emilioja?»

«Po, Emilioja. Më në fund dëshira e tij ishte plotësuar. Lundrimi i kthimit ishte i zakonshëm.»

Kur arritëm në Durrës, anijen e pritën me brohorima, si të të them, ja, ashtu siç pritën «Faraonin» e ri të «Konti i Montekris-

tos», veç me një ndryshim, anija s'ishte dhuratë e ndonjë konti milioner. Më në fund kishim arritur. Detarët e ekuipazhit të vjetër u çmallën me motoveloren e tyre. Ditarin e mëparshëm e mbyllëm nëpër sirtarë dhe hapëm një ditar të ri. Tani çdo gjë ishte e re, si koha.

Zëri i kapitenit Met Ceka këtu sikur u këput. E kish mbytur ngashërimi. Nuk fola.

U krijua një heshtje e shkurtër. E prisja që tani kapiteni Met Ceka të megjullohej e të largohej për të m'u shfaqur përsëri atëherë kur ai do ta shihte të domosdoshme. Thithi dhe një herë duhanin, pashë si shkëlqeu xixa — xhind në vatrën e vogël të llullës, si dredhoi tymi i duhanit dhe pastaj m'u zhduk. Atëherë unë qetë ula sytë në ditarin e ri dhe vazhdova leximin. Disa dete: Mesdheu, Egjeu, i Ziu, Joni, Adriatiku, zvogëloheshin e ngurtësoheshin për t'u kthyer në fletë të shkruara ditari.

Lexova edhe ca, derisa anija u plak. Tani e kishin lënë në një cektinë dhe ashtu, e zhveshur nga velat, me tre direktë të shtrembër e të konsumuar, dukej si një tavllë duhani, ku kishin shuar tri cigare kujtimesh. Atëherë kur anijen e nxorën përjetësisht në breg, si një ushtar në pension, ne fëmijët shkonim atje për të luajtur. Unë bëhesha kapiteni, të tjerët ishin detarët e saj. Kanë qenë vite të bukura. Fantazia jonë gjithnjë

vishte rroba të reja; anija jonë gjithnjë çante dete të reja imagjinare. Pikërisht në atë kohë për herë të parë unë vendosa lidhjen me kapitenin e vërtetë të anijes. Po shikoja timonin e gdhendur. Isha përqendruar në figurën e një delfini që mbante mbi kurriz një njeri. Dëgjova një të kollitur të lehtë e, kur ngrita kokën, u stepa. Kapiteni me një llullë të madhe në buzë, më qeshte ngrohtë, si një prind. Por unë u tremba nga befasia.

«Mos u tremb, — më tha, — unë jam kapiteni.»

«E di», — i thashë.

«Nga e di, o muço?» — më pyeti.

«Ngaqë keni marrë oxhakun e anijes për llullë», — iu përgjigja.

Anija u lëkund nga dallgët shpërthyesë të qeshjes së tij.

Për herë të parë shihja një njeri që qeshte me kaq forcë e të tundej kaq shumë. Por ishte i mirë, ashtu siç e ëndërroja. Dhe ai më tregonte e më tregonte deri në lodhje. Disa prej këtyre tregimeve i shënoja, të tjerat mbeteshin aty-këtu, si thërrime. Do të rritesha një ditë e do të kërkoja t'i mblidhja dhe ato.

...Filmin e lava shpejt. Në solucionin e lëngshëm anija u lëkund si në det. E stampova në letrën fotografike e pastaj përsëri e futa në solucionin e zakonshëm të zhvillimit.

Dalëngadalë figura u qartësua dhe, për habinë time, nuk ishte ai mozaiku i fotografuar në oborrin e shtëpisë shkodrane. Ishte një arije origjinale, prej dru lisi e pishe dhe, çuditërisht, mbi kuvertë, mbështetur në bandën e drunjtë, më përshëndetnin detarët.

— Lundrim të mbarë! Deti bunacë! — i urova unë.

Kapiteni vazhdonte të tymoste lullën e tij të madhe, ku ishte gdhendur me finesë motoveloja e dashur.

**Shtator, 1987**

## Rebelimi

Frau Delda Shenkman ishte një grua e egër, leshatore, që rruhej si burrat e që nuk kish lindur fëmijë. Ajo ishte martuar me Zelen Shenkmanin pas përfundimit të gjyqit të Nurembergut. Të dy, burrë e grua, kishin shpëtuar nga ky gjyq e tani jetonin të lirë,

pa telashe. E vetmja fatkeqësi kish qenë se frau Shenkmani nuk kish lindur fëmijë. Vetëm një herë, në vitin e tretë të martesës, ajo ndjeu një fryrje barku dhe, e lumtur sa më s'ka, gëzohej me Zelenin. Muaj pas muaji barku fryhej dhe gjithnjë e më shumë çifti priste të dilte në dritë krijesa e tyre. Po shpresat kishin qenë të kota. Fryrja s'ishte gjë tjetër veçse një pseudobarrë dhe në muajin e nëntë Shenkmani «polli erë», siç i thonë në gjuhën e popullit kësaj «lindjeje» të rrallë. Meqë s'u bënë dot me fëmijë, adoptuan njërin nga tre djemtë e Stefënit, vëllait të Zelenit, dhe, duke e edukuar e shkolluar me kulturë të moderuar, më në fund u dukej sikur kishin arritur të gatuanin diçka të tyren, një djalosh të qetë e karrierist. Ai quhej Ralf dhe punonte si gazetar në radiotelevizionin e Veriut.

Aspiratori thithte pluhurat e tapetit me rombe, kurse e zonja e shtëpisë, si një aspirator i madh, thithte pluhurat e kujtimeve. U dëgjua zilja e ajo nxitoi të hapte derën. Bashkë me të shoqin kish ardhur dhe një burrë tjetër, të cilin ajo ishte e bindur se e kish parë diku.

— Delda, sot kemi për darkë një mik tepër të dëshiruar, — i tha i shoqi.

— Mirë se erdhët! — uroi e zonja e shtëpisë dhe shtrëngoi dorën e vogël e qullace të mesoburrit elegant.



— Kris Çarlov, — u prezantua miku i shtëpisë.

Zoti Kris, i bardhë dhe i squllur si kandidil deti, po me sy tepër dhelparakë, u ul në kolltukun e madh, përballë Zelen Shenkmanit.

— Zoti Kris është tregtar i njohur dhe sot në mëngjes ka ardhur nga Britania e Madhe me «Princ Hamletin».

— Ou, dy ditë lundrim në det! Besoj të jeni lodhur, — tha frau Shenkmani me një notë false interesimi në zërin e saj të burrëruar.

— Pak, zonjë. Dhe pse plot njëzet orë udhëtim, te «Princ Hamleti» nuk e ndien lodhjen, madje nuk ka as fantazma.

Të tre qeshën.

— Mua më falni, — tha pas pak frau dhe doli nga salloni për në kuzhinë.

Të dy burrat mbetën në sallonin e madh.

— Tani një surprizë për ju, zoti Kris, — tha i zoti i shtëpisë duke shkuar gati me hap rreshtor drejt një skrivanie të madhe në fund të sallonit.

Sytë e mikut s'levizën. Ai ishte mësuar me «surprizat» e admiruesve të Hitlerit, të cilat nuk ishin gjë tjetër veçse uniforma, flamuj e dekorata naziste, ditare të atyre viteve... Ktheu kokën dhe ndoqi zotin Zelen, që kërkonte relikthin e tij të shtrenjtë. U dëgjua zhurma e sirtarit që mbyllej dhe menjë-

herë afaristi u kthye në pozicionin e mëparshëm, futi dorën në xhepin e xhaketës dhe nxori që andej një «Marlboro». Hapat e zotit Zelen afroheshin me ritmin e njohur ushtarak.

— Nuk e besoj ta përfytyroni thesarin tim, — tha zoti Zelen, duke mbajtur në dorë një kuti të zezë, të vogël, sa një libër.

— Jo, nuk e marr dot me mend. Mbase ndonjë dekoratë të asaj kohe, — tha zoti Kris dhe qeshi me zor.

— Oh, jo, është fjala për diçka tjetër. Ja, shikojeni më mirë.

I zoti i shtëpisë, duke parandier përshtypjen që do t'i bënte tregtarit special relikti i shtrenjtë, hapi me solemnitet kutinë. Kur në atë kutizë u duk një kryq i bukur, i bardhë, i veshur me shtresë argjendi, sytë e tregtarit morën një vezullim lakmiqar:

— Ç'është ky kryq?

Me një krekosje të zakonshme, zoti Zelen shpjegoi:

— Ky kryq, Kris i dashur, është pikërisht ai me të cilin papa Paçeli bekoj ushtrinë e Adolf Hitlerit para marshimit për pushtimin e Evropës.

— Origjinali?! — pyeti plot ethe tregtari.

— Origjinali, natyrisht.

— Po si ju ra në dorë?!

— Kjo nuk ka rëndësi. Neve na intere-

son fakti që kryqin e bekimit hitlerian e kemi në dorë.

— Atëherë, sa keni vendosur të ma shitni?

— Hëpërhë nuk e shesim. Kemi disa synime...

— Po atëherë pse më keni thirrur? Ju e dini se unë jam një tregtar special dhe si i tillë vetëm blej...

— Zoti Kris, mos ngulmoni më kot. Unë e di se cili jeni ju. Po, fundja, nëse unë do t'jua shitja me një çmim të lartë, pas pak kohe ju do të na e rishitnit po neve, me dyfishin e çmimit. E kuptoni se kjo është diçka absurde?

— Po...

— Ne jemi organizatë, madje e madhe, e kuptoni?

Zoti Kris u gëlltit duke menduar se mbase ky admirues do t'i bënte «surpriza» të tjera më me leverdi.

Në sallon hyri frau Shenkmani dhe u serviri limonadë, kafe e çokollata. Tregtari i mori të gjitha, pa e pasur shumë mendjen tek e zonja e shtëpisë, po duke i buzëqeshur asaj ngrirë, ashtu siç buzëqeshin maskat.

— Mbase keni dëshirë të luajmë shah?  
— pyeti i zoti i shtëpisë duke treguar skakierën e shahut, të vizatuar mbi syprinën e tryezës.

— Oh, jo. Më mirë ndjekim ndonjë program televiziv.

Televizori ishte në qoshen tjetër të sallonit, thuajse përballë mikut. Zoti Zelen, gjithnjë me atë hapin e dashur ushtarak, shkoi drejt aparatit dhe shtypi çelësin. Pas pak në ekran u dukën Tomi dhe Xherri.

— Përsëri macja me miun, — tha si me humor zoti Zelen.

— Dhe gjithnjë miu del i fituar, — ia ktheu tregtari.

— Tashmë kjo është në modë.

— Por ama vetëm në filma.

— Jeta... natyrisht, megjithëse dhe ajo ka regjisorët e saj. — Këto fjalë i zoti i shtëpisë i tha turbull, sepse thellë në kujtesë iu zgjua ndofta për të njëmijtën herë një skenë rrëqethëse, që i kish ndodhur pikërisht atij, në një vend të Ballkanit.

Në verën e vitit 1944 e kishin zënë rob në Shqipëri dhe, partizanët e kishin përplasur në një bodrum të errët. Më mirë të vdiste, të vriste veten, kish menduar, sesa të burgosej. Dhe në kohën kur vetmia gati po e mbyste, ai ndjeu një sinjal të një jete tjetër. Një mi i madh kish nxjerrë kokën në një vrimë. Kafsha e pështirë nuk kishte frikë, e shikonte drejt e në sy të burgosurin, sikur ta kuptonte mirë gjendjen e tij. Pastaj nisi të cijaste. «Vajtojca e vetme e rinisë sime!» kish thënë oficeri i Rajhut të Tretë. Pastaj kish ardhur,

si gjithnjë, ai partizani çalaman, me këmbë të fashuar dhe i kish zgjatur nga një e çarë gavetën me fasule dhe pak bukë. Partizani kish ikur dhe i burgosuri kish ndier përsëri atë sinjalin e miut si një «sos» urie. E kish ndarë bukën me miun dhe për herë të parë kish qarë në moshë të rritur. . .

Zoti Kris ndiqte në ekran atë lojë të pafund të Tomit dhe Xherrit, qeshte me kënaqësi, duke futur herë pas here në gojë ndonjë copë çokollatë. E qeshura e tij gurgulluese ia kish këputur kujtimet të zotit të shtëpisë.

— Këta filma sikur të largojnë nga hallët e mëdha, — tha në të përtypur e sipër afaristi nazist.

— Po, të largojnë. Është një lojë që t'i merr mendtë, — ia ktheu Zeleni, duke vëzhguar fytyrën e bardhë e qullace. — Ju e dini se numri i anëtarëve të organizatës sonë çdo ditë vjen duke u rritur.

— E di, — tha zoti Kris me vështrim gjithnjë nga ekрани.

— Na duhen pesëdhjetë uniforma si ato të esesëve.

— Pesëdhjetë? — Tregtari sikur ngriu në kolltuk. — Po unë nuk jam përgjegjës rrobapësie. Unë mund t'ju siguroj dhe t'ju shes ndonjë relik të asaj kohe. . . kurse për kërkesën tuaj mund t'ju ndihmojë ndonjë ish-shef prapavije.

— Mos bëni shaka, Kris Çarlov. Për në shefi i prapavijës jeni ju!

Zoti Kris u kollit. Nga toni i të zotit të shtëpisë ai kish kuptuar se këtë kërkesë e bënte dikush më lart, ndoshta ai që pak kohë më parë i kish blerë maskën e fytyrës së Hitlerit, vetë Fyhreri Fridhelm.

— Duam dhe disa dekorata si dhe flamurë të Rajhut të Tretë, — vazhdoi me një ton disi më të thyer zoti Zelen. — Kurse për çmimin ti vetëm hap gojën. Ne i duam origjinale, kjo ka rëndësi, kuptoni, zoti Kris, o-ri-gji-na-le!

Afaristi buzëqeshi. «Origjinalja» tashmë për nazistët e vjetër e të rinj ishte bërë një sëmundje kronike.

Turbull, si përmes një magme të trashë, erdhi tingulli i një zileje.

U dëgjuan hapat e nxituar të zonjës Shenkman, e cila doli nga kuzhina.

Ralf Shenkmani hyri në shtëpi me një mërzhiti të thellë.

— Nuk qenke mirë, — i tha e ëma.

— Jam i lodhur. Puna e gazetarit ta merrka frymën... Paskemi mysafirë?

— Po, një mik i babait. Shkoni edhe ju pak në sallën, sa të bëhet darka gati.

Ralfi nuk foli. Hoqi xhaketën dhe këpucët, veshi pantoflat dhe shkoi drejt sallës.

— Zotërinj, një lajm i hidhur për ju,

— tha Ralfi me një ton disi solemn, pasi njo-  
hu mikun e të atit.

Të dy burrat moshëthyer ngulën shi-  
kimin tek i sapoardhuri dhe po prisnin ç'do  
t'u thoshte ai.

— Vdiq Frank Dënic.

— Vdiq!? — Zoti Zelen nuk e fshehu  
dot habinë, kurse kandili i detit u tkurr, si-  
kur mblodhi tentakulat gati për vetëmbroj-  
tje.

— Po, vdiq. Infarkt. S'ka veçse gjys-  
më ore që na telefonuan në redaksi.

Ralfi u ul në një kolltuk pranë zotit  
Kris.

— Po unë e takova mbrëmë! — habitej  
Zeleni. — Më tha se kthehej nga pushimet  
verore. Dhe, me të vërtetë që ishte shumë  
mirë me shëndet. Çudi si paska vdekur! Pa-  
staj, kanë harruar dhe të më telefonojnë!

U krijua një heshtje e shkurtër. Zoti  
Zelen ndjeu një dhembje therëse në zemër.  
E kish lënë një shok i fëmijërisë. Të dy ki-  
shin lindur në një qytet të vogël buzë rrje-  
dhës së lumit. Mozel. Shpesh dilnin bashkë  
aty mbi kodër, te kështjella e bukur, ndër-  
tuar që më 1320 dhe, duke soditur qytetin e  
lumin rebel, ëndërronin për bëma të mëdha.  
Kur u rritën ca, shkolin të pinin në Mejs-  
shob, në kantinën e vjetër, që kish prodhuar  
verëra për tre mbretër. Pinin e shpesh, të  
ndezur nga afshi i verës, diskutonin me

zjarr për zgjedhjet e Odenburgut. Pastaj thirrjes së Hitlerit për luftë i ishin përgjigjur të dy me një gatishmëri të rrallë. Të dy kishin luftuar, Frank Dënici në Francë, kurse Zeleni në Ballkan. Vetëm pas lufte, më 1947, ishin takuar dhe ashtu, të përmalluar, kishin përfunduar sërish në kantinën e nëndheshme, ku kishin pirë për fatin e madh — shpëtimin e kokave. Atëherë ishin nga 23 vjeç...

— Duhet t'i bëjmë një varrim madhështor. Ai ka qenë një patriot i madh, një gjerman i vërtetë, — tha Zeleni.

Kandili i detit vazhdonte të kontrollonte kot së koti në çantën e vet, kurse Ralfi ndiqte intervistën e një trajneri futbollit. Zonja Shenkman, që ende nuk dinte gjë për vdekjen e Frank Dënicit, hyri në sallon duke kënduar lehtë një motiv të njohur nga valset e Shtrausit.

— Ka vdekur Franku, shoku im i mirë, — i tha së shoqes Zeleni, me një notë të thellë mallëngjimi.

— Po si kështu?! — pyeti gruaja dhe u ul në kolltukun e madh, me kurriz nga hyrja e sallonit.

— Ralfi thotë infarkt... Prit të marrim njëherë në telefon...

— Alo... Alo... Familja Dënic? Jam unë, Zeleni... Ti, Merin, je? Ngushëllime!... Po si kështu?!... Përmbaje veten, moj bijë, mos qaj



tani... Akoma në spital?!... Atëherë prit se erdha....

Ai uli receptorin dhe iu drejtua së shoqes:

— Po shkoj. Duhet të jem atje akoma pa e sjellë kufomën në shtëpi. Më takon të merrem me organizimin... Ju, zoti Kris, të më falni... Po ja që rrethanat... Këtu keni tim bir dhe gruan, që mund t'ju bëjnë shoqëri.

— Jo, edhe unë mendoj të ngrihem. Porositë që më dhatë, kërkojnë punë. Mbase edhe për ceremoninë e varrimit mund t'ju duhet diçka simbolike, për shembull shiritat-fjongo me tri ngjyra.... Për çdo gjë më telefononi.

Zoti Kris u ngrit.

— Na u prish kjo mbrëmje, — tha zonja Shenkman.

— E po gjëra që ndodhin. Tani herë tjetër, — tha tregtari me sytë si copa akulli gjithnjë gati në të shkrirë dhe u zgjati dorën qullace të tre pjesëtarëve të familjes.

— Jo, unë po dal me ju, — i tha zoti Zelen.

Ralfi dukej i qetë dhe vazhdonte të ndiqte intervistën për futbollin. Por, sapo i ati dhe tregtari dolën, ai iu drejtua nënës:

— Hansi është shtruar urgjent në spital.

— Pse?! — pyeti ajo, gjoja si e interesuar.

— Helmim nga merimangat, atje në depot e kantierit.

— Kush të tha? — Këtë radhë zëri i saj ishte i squllët.

— Helmi i këtyre merimangave që kanë mbushur hambarët e anijeve është tepër i rrezikshëm, thonë, vdekje prurës.

Delda Shenkmani nuk deshë ta vazhdonte këtë bisedë, sepse kish frikë mos i biri, papritmas, prishte gjithë rregullsinë familjare dhe i bënte një vizitë në spital atij, dajës së vet.

— Po sikur t'i bëjmë një vizitë? — pyeti vërtet Ralfi dhe ajo sikur pësoi një goditje.

— Mbase jeta e tij nuk është kaq në rrezik. Pastaj ai tip asnjëherë nuk na ka pëlqyer, as mua, as tyt eti.

— Çuditë për një gjë, — tha Ralfi, i përmbajtur.

— Për çfarë?!

— Që më shumë ju tronditi lajmi për vdekjen e Franc Dënicit, sesa lajmi për helmimin e njeriut tonë, Hansit.

E ëma nuk foli. Nuk ndihej mirë, tensioni patjetër duhej t'i kish lëvizur shumë në atë gjysmë ore, ndaj, e lodhur, shkoi të pinte një adalat.

Korteu i përmortshëm, si një gjarpër i zi, zvarritej nëpër rrugë. Flakadanët shkarravitnin ajrin me figura të ndryshme. Një marsh i njohur hitlerian nxiste korteun, ashtu siç nxit fakiri i shkretëtirës gjarprin e fjetur.

— Hajl! Zig hajl! — thërriste herë pas here korteu.

Thirrja ishte e fortë. Kurorave të shumta u dridheshin fjongot me ngjyrë të zezë, të bardhë, të kuqe.

— Hajl! Zig hajl!

Zeleni ishte në krye, në vertebrën e dytë të gjarpërit të zi. Uniforma e esesit i shkonte për mrekulli. Ndërsa në gjoksin e gjerë i ndritnin dekoratat, shumica të blera të Kris Çarlovi. Djathtas dhe majtas tij, para dhe prapa, ishin përfaqësuesit e organizatave naziste të ardhura nga Britania, Kili, Izraeli, Afrika e Jugut, Japonia, Spanja, Guatemala, Salvadori, ShBA, Italia... Shumë prej tyre Zeleni i njihte, veçanërisht evropianët. Kish shkëmbyer me ta mendime në mbledhje të ndryshme dhe thujse gjithnjë kish mbetur i kënaqur për besnikërinë e tyre. Ata të gjithë ishin personalitete të rëndësishme, afaristë të regjuri, milionerë të krimbur, me emra që përmendeshin thujse çdo ditë nëpër revista e gazeta, në emisionet e radiotelevizio-

neve. Kish dhe nga ata, si Zeleni, që ishin të rëndomtë në shoqëri, por që, për besnikëri ndaj kryqit të thyer nuk mbeteshin aspak më pas.

— Zig, hajl!

Në këtë muzg flakadanët në duart e pjesëmarrësve të korteut ishin si ato kryqet e kalorësve teutonë kur niseshin në kryqëzatat e famshme. Zeleni solli ndër mend fytyrën e dashur të shokut të fëmijërisë, zërin e tij, humorin e hollë dhe dashurinë e zjarrtë që kish Frank Dënici për muzikën e Vagnerit. Muzika funebre vazhdonte. Hapat hidheshin prerë, sikur do të ngulnin diçka në asfaltin e rrugës së gjerë. Fjongot tringjyreshe dridheshin pa ndërprerë në gjokset e jeshilta të kurorave. Burri majtas, ngjitur me Zelenin, nuk e mbajti dot të tështiturën. Ishte nga Johanesburgu dhe për të Zeleni kish dëgjuar të thoshin se ishte marrë vetë me Nelson Mandelën.

— Po ju, ishit këtu apo ju njoftuan në Johanesburg? — e pyeti ngadalë Zeleni.

— Rastisa këtu... Humbje e madhe, — tha me një gjermanishte të zvargur bosi nga Afrika e Jugut. — Ka disa vdekje që të bëjnë të mendosh se janë të porositura për tronditje masive.

— Në ç'kuptim e thoni këtë — pyeti Zeleni.

— Ne kishim nevojë për një vdekje të tillë, e kuptoni?

— E kuptoj. Gazetat thonë se Nelson Mandela qëndron i shtruar në spitalin e burgut. Po nëse ai vdes?

— Nuk besoj, — ia ktheu njeriu i Pretorias. — Fizikisht është akoma i fortë, megjithëse po i mbush të shtatëdhjetat. Po nëse vdes Hesi juaj? Natyrisht që do të ishte një vdekje nxitëse për ne, apo jo?

«Po nëse vdes»... këto ishin hamendësimet për të tjerët, gjithnjë duke përjashtuar veten.

— Patjetër, — u përgjigj shkurt Zeleni, duke ndier një tjetër pickim të hidhur në zemër.

Ja, pra, Hesin, ndihmësin e njohur të Hitlerit, e kishin mbyllur në Shpandau, ashtu si dikur atë në bodrumin e errët. Thoshin se Hesin e pyesnin vazhdimisht agjenturat e vendeve të ndryshme dhe pyetja kryesore ishte: a dinte gjë Hitleri për udhëtimin e ndihmësit të tij me avion drejt Anglisë? Gjykatësi i Nurembergut, i cili kish marrë në pyetje Gëringun, kishte bindjen se Hitleri kish qenë në dijeni për këtë fluturim të fshehtë e të pasuksesshëm.

Zeleni ktheu pak kokën për të parë bashkëbiseduesin nga Afrika e Jugut; ai ishte zhytur në të thella. Atëherë Zeleni hodhi shikimin përreth për të parë edhe një herë

se ç'përshtypje po bënte te njerëzit ky kortejo i zakonit, si për rëndësinë e të vdekurit, që i udhëhiqte, ashtu dhe për tërë ato uniformë, shumica origjinale, që përfaqësonin gjithë llojet e armëve të ushtrisë së Rajhut. Ai e vuri re frikën e disa kalimtarëve dhe kjo e ngrohu më shumë. Unë dhe ti, Frank i dashur, megjithëse të thyer në moshë, nuk mund të jemi pensionistë, Ne punojmë, Frank, dhe nuk thyhemi. Madje, dhe të vdekur, punojmë.

— Dje në Këln u zhvillua një demonstratë proteste ku morën pjesë qindra veta, — dëgjoi prapa krahëve të tij.

— Po pastaj? — pyeti një zë tjetër.

— Ndaj u pezullua edhe mbledhja e organizatës sonë.

Zeleni ktheu kokën me kujdes dhe njo hu një djalosh me mjekër të zezë të rritur shumë. Ishte një nga udhëheqësit e neonazistëve, djalosh i zgjuar dhe i shkathët. Po si nuk i ngjante një çikë Ralfi i tij!

— Mbledhjen duhet ta bëni patjetër, sa më shpejt. Dhe veproni! — foli prerë djaloshi mjekërzi, dhe Zeleni ndjeu një dallgë të ngrohtë t'i pushtonte kraharorin.

Korteu po u afrohej varrezave. Zelenit i zuri syri Ralfin, që, me aparatën e magnetofonit në dorë, vraponte, siç duket, për të qënë sa më afër vendit ku do të mbaheshin fjalimet e rastit. U ndie krenar që kish rri-

tur një djalë të urtë, fjalëpak e jo plangprishës, si fëmijët e tjerë të të vëllait, që kishin përçafuar idetë e socializmit. Por edhe Ralfi se ç'kishte diçka të panjohur e të ftohtë. Po fundja nuk ishte krejtësisht gjaku i tij.

Një çast banda muzikore që printe kor-teun heshti. Dëgjohej vetëm zhurma e pish-tarëve që digjeshin. Ralfi rishtypi butonat e incizimit. Pak heshtje origjinale në fillim me zhurmën e flakadanëve nuk do të ishte keq për radioreportazhin, mendoi. U dëgjua një e kollitur dhe filloi fjala e rastit.

*... Frank Dënic, shoku ynë i shtrenjtë, kishte gjak arjani të kulluar dhe gjithmonë punoi e luftoi për të mirën e atdheut.*

Zeleni e kish lexuar dhe më parë fjalën e rastit, po tani, mes kësaj atmosfere të për-zishme, iu duk me tingëllim të veçantë, tepër solemn. Pastaj, ky fjalim i shkurtër se ç'kishte diçka që të ngacmonte kujtesën e të çonte larg, shumë larg, në ato vitet e rinisë së hershme, buzë lumit Mozel, atëherë të palun-drueshëm, kur bashkë me Frankun peshko-nin te vendi i tyre i dashur, poshtë kështje-llës së vjetër. Madje një ditë Franku kish shpëtuar një fëmijë dhjetëvjeçar që po mby-tej. Ishte futur në lumë me gjithë rroba dhe e kish nxjerrë viktimën ndjenjahumbur. Pa-si e kish kthyer me kokë poshtë e fëmija kish nxjerrë gjithë atë ujë, Franku kish qe-shur i lehtësuar.

*Këto vepra të të dashurit tonë Frank Dënic, veçanërisht heroizmat e tij në Francë, do të vlejné në mënyrë të jashtëzakonshme për edukimin e brezit të ri me frymën e epërsisë së racës sonë...*

Me vështrim të ngulur te dheu i freskët ngjyrëkafe, që pas pak do të mbulonte Frankun e mbyllur në arkivolin-frigorifer, Zeleni mendoi për ditëvdekjen e vet, për homazhet dhe ceremoninë e përmortshme. Edhe për të mbase do të organizohej një korte i tillë, ku ta dish, më pak a më shumë madhështor, e do të mbaheshin një apo disa fjali-me të dhembshme, të shkruara nga njerëz që dinin të të preknin me forcën e fjalës. Do të flisnin dhe për heroizmat e tij në Gadishullin Ballkanik, do t'u thurnin lavde viteve të pasluftës, përpjekjeve për ringjalljen dhe forcimin e nazizmit. Megjithatë ata një gjë nuk do ta dinin e nuk do ta përmendnin kurrë — atë sinjalin «sos» të miut të uritur.

Himni «Dojçland Yber ales», që nisi të këndohej nga i gjithë korteu-gjarpër, tashmë i mbledhur kutulaç, ia largoi mendimet Zelenit dhe instinktivisht vazhdoi vargjet:

*Hajl! Zig, hajl!*

Ceremonia e varrimit kishte mbaruar. Pjesëmarrësit në korte u shpërndanë dhe, me një zhurmërimë që dukej sikur vinte nga thellësia e varreve, zbritën në autostradë, ku i prisnin veturat e shumta.



— Ralf, hip në makinën time, — i tha Zeleni të birit, që nxitonte të arrinte dikë.

— Mirë, — ia ktheu Ralfi. — Do të më çosh deri në radio, se materiali duhet urgjent.

Radha e makinave ishte e gjatë dhe Zelenit iu deshën disa minuta që të kalonte në shpejtësinë normale. Ralfi shtypi një buton dhe ktheu shiritin.

— Pa të dëgjojmë njëherë se ç'na ke thënë ti si reporter, — i tha i ati.

Ralfi nuk foli.

— Do të ishte mirë të vije në konferencën që organizojmë sot në sallën tonë, — foli përsëri Zeleni. — Ora tani është gjāshtë. Pas dy orësh në do të mblidhemi. Ty, Ralf, mund të të interesojë, se edhe mëson gjëra të reja, edhe propagandon, edhe forcon pozitat e tua në radio.

Ralfi qeshi me logjikën e të atit, po nuk foli. Tani Zeleni kish filluar të nervozohet me të birin. Ç'dreqin kishte që nuk hapte gojë!

*Lajmi i vdekjes së nazistit Frank Dënic pikëlloi familjen, si dhe zemrat e miqve e të shokëve të tij.* Tani në altoparlantin e vogël të magnetofonit ishte zëri i Ralfit. Zeleni, i zhytur në ndenjësë, i thithte ato fjalë. Çka, çka, mendonte. E ndiente se në zërin e të birit kishte diçka që nuk shkonte me tërë atë madhështi të korteut. I biri duhej ta kuptonte: më shumë se një ceremoni varrimi, ajo

ishte paradë e një ushtrie që është gati për kryqëzata të reja.

— Më duket se nuk po të pëlqen, — i tha Ralfi, që ia kishte blerë mendimet.

— Megjithatë nuk është keq, — ia ktheu Zeleni. — Mbase e ka fajin gjinia e radioreportazhit, e cila s'ta jep dot çdo gjë para syve. Një telereportazh do të dilte më ndryshe, fjalët e gazetarit do të ilustronin një korte madhështor, që ti, Ralf, duhet ta kuptosh se ishte më shumë një..

— Nuk është vështirë për ta kuptuar, — e ndërpreu i biri.

Mënyra se si e tha atë konstatim, ftohtë, shumë ftohtë, si dhe heshtja pikërisht atje në fund, ku, si zakonisht, duhej të ishte fjala «baba», e bëri zotin Zelen të ndiente një lloj largësie prej atij çunakut që ai e kish rritur për njëzet e pesë vjet me radhë me tërë të mirat. Për të i kish harxhuar paratë me grushte. Gjer në festivalin javor të borës në Sapore të Japonisë e kishte shpënë. Sa ngazëlleheshin ata, burrë e grua, kur vogëlushi i tyre u gëzohej ditëve të borës, humbte në botën përrallore të akullit, vraponte pas karrocave e kuajve të bardhë si pas magjive festive... Borëbardha.. a...a!....

Borëzeza, më mirë!

— Ralf, sot në darkë të pres të vish në mitingun tonë, — i tha me një ton gjysmëur-

dhërues të birit, kur përpara u shfaq ndërtesa e madhe e radiotelevizionit.

— Nëse mbaroj punë shpejt, mund të vij, baba, — u përgjigj i biri dhe zoti Zelen mori frymë i lehtësuar e i buzëqeshi.

### 3

Shefi i sektorit të informacionit e priti Ralfin si gjithnjë, me të shkelurën e lehtë të syrit të djathtë, sepse syrin e majtë e kish të vënë.

— Do të ketë dalë i mirë, besoj, — i tha shefi gazetarit të ri.

— Mendoj se mund të jepet, megjithatë dëgjojeni njëherë.

— Ralf, — tha shefi dhe i shkeli përsëri syrin e djathtë, — ndonjë fshirje të vogël, po të jetë nevoja, e marr unë përsipër. Puna është se në lajmet kryesore të mbrëmjes ti do të kesh dy reportazhe. Dhe pikërisht atë të dytin duhet të shkosh ta gatuash tani.

Ralfit i shkoi mendja te mitingu që do të organizonin nazistët në sallën e madhe.

— Ka ardhur një delegacion nga Shqipëria. Janë të rinj. Kanë edhe një grup të vogël artistik. Fut dy-tri këngë, merr një

intervistë dhe eja shpejt. Nisu tani! — urdhëroi shefi, pa marrë asnjë mendim të varësitet të tij.

Ralfi mori përsëri «Uherin». Në xhepat e xhaketes kishte dy bobina rezervë. Ndiene një si turbullim të përgjithshëm. I dukej sikur thellë, në stomak, kish hedhur rrënjët një bimë kacavjerrëse, e cila rritej me shpejtësi të habitshme, në fillim lart, në gjoks, pastaj në krah, pastaj në kokën e rënduar si plumb. Ishte më shumë se lodhje fizike. Një delegacion shqiptar! Patjetër ata që morën pjesë në takimin e rinisë antiimperialiste të zhvilluar në afërsi të vendlindjes së Karl Marksit, Tririt. Ajo bima kacavjerrëse ishte e pabindur, e egër, kështu që tani i kish pushtuar gjithë qelizat e trupit. Asnjëherë nuk kish dashur të dinte shumë për shqiptarët. Kjo i qe bërë si një lloj edukate, sepse, siç i thonë një fjale, në shtëpinë e të varurit nuk flitet për litarin. Babai i tij, që kish qenë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë, heshte, nuk tregonte gjë, megjithëse në vitet e fundit kish nisur të krekosej me bëmat e tij të pashembullta si oficer i Rajhut. Patjetër që edhe atje, në viset e Ballkanit, i ati duhej të kish vrarë, se lufta kërkon gjak... «Dreqi ta marrë! Më mirë të mos kisha pranuar ta bëja këtë radioreportazh.» Në qarqet diplomatike si dhe në bisedat e gazetarëve, flitej se mi-dis vendit të tij dhe Shqipërisë do të vendo-

seshin marrëdhënie diplomatike. Në fillim Ralfi këtë s'e kish besuar, mbase ngaqë prindërit e tij, gjithnjë alergjikë ndaj atij vendi të vogël ballkanik, nuk e pranonin kursesit këtë lidhje, megjithatë, pavarësisht nga dëshirat e disave, përpjekjet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike vazhdonin nga të dyja palët. Këtë duhej ta kishte parasysh edhe në radioreportazhin e tij.

Lokali ku do të zhvillohej mitingu, ndodhej midis ndërtesave të ngjeshura, të vjetra, që nga Lufta e Parë Botërore. Vitet e fundit lokali ishte bazë e Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri.

Zbriti nga makina dhe, sapo hapi derën, ndjeu zëra të gëzuar e të qeshura. Porositi një gotë birrë «Pilzen» dhe atje, në banak, e ktheu me gllëjka të mëdha. Banakieri, një djalë i ri simpatik, po e vëzhgonte. Ralfi vuri re se edhe të tjerët rrotull kishin ngulur shikimin te magnetofoni që kish hedhur në krah.

— Kërkoni njeri? — pyeti banakieri.

— Jo. Kam ardhur të ndjek aktivitetin.

Banakieri i ri heshti dhe, si për të larguar vëmendjen e gazetarit, mbushi një gotë tjetër me birrë, ia zgjati një shoqes përballë dhe pastaj doli nga dera e pasme. Ralfi pa se nga një aneks i restorantit dolën disa të rinj e të reja.

— Këta janë shqiptarët, — dëgjoji zërin e një gruaje.

Ktheu kokën dhe pa Ursulën, xhaxheshën, po në të vërtetë nënën e tij, të cilën, siç dukej, e kish lajmëruar banakieri. Këtë nuk e priste.

— Si jeni? — pyeti Ralfi. — Xhaxhai si është?

— Mirë janë. Vetëm Hansin, dajën tënd, e kanë helmuar merimangat.

— E mora vesh. E vizitova sot në mëngjes.

— Ashtu?! — u habit ajo. — Më bëhet qejfi.

Ralfi ishte stepur. Këto fjalë të ëmbla ajo, nëna e tij e vërtetë, po ia thoshte për herë të parë. Ndjeu një prushëritje në gjoks. I përmbajti emocionet.

— Ata po duartrokasin. Eja hyjmë, — e ftoi ajo.

Ursula ndenji në radhën e fundit, bashkë me pjesëtarët e grupit të vogël artistik, kurse Ralfi zuri vend në krye, që gjithçka ta incizonte sa më pastër. I doli parasysh fytyra e rrudhur e shefit të tij, syri i djathtë, që shkelej vazhdimisht si një semafor në udhëkryq, dhe syri i majtë, i ngrirë, i vdekur. Shtypi butonat e incizimit. Disa gjermanë dhe emigrantë ekonomikë bënë pyetje të ndryshme dhe një grua e re përgjigjej shkurt dhe qartë. Ishte kryetarja e delegacionit. Pas cdo përgjigjeje të pranishmit duartrokitnin. Pastaj filloi shfaqja e grupit artistik. Ralfi u

përpoq që këngët t'i incizonte sa më pastër. I shkoi mendja tek i ati. Në atë çast ai patjetër përgatitej të shkonte në mitingun e madh. Pa orën. Dhe dyzet minuta e mitingu i nazistëve fillonte. Nuk besoj të më dalë koha që të jem atje në orën e caktuar, mendoi. Të rinjtë shqiptarë po këndonin një këngë që atij i bëri përshtypje të veçantë; ngjante me brambullimën e zjarrit në një pyll të thatë. Duartrokitjet e të pranishmëve dukeshin sikur e merrnin këtë zjarr në pëllëmbë, e hidhnin në ajër; e prisnin përsëri e pastaj e ruanin diku thellë në qeniet e tyre. Padashur, ashtu si pa vëmendje, dhe ai nisi të duartrokiste. Pastaj buzëqeshi lehtë kur mendoi si do të reagonte shefi i tij kur të dëgjonte në magnetofon këtë simpati të hapur të atij, Ralf Shenkmanit. Patjetër do të lehte si qen.

Pas intervistës telefonoi në redaksi që të vinin ta merrnin me makinë. Lokali kish rënë në qetësi. Vetëm tri çifte bisedonin me zë të ulët; në një tryezë ngjitur me xhamin e fasadës. I zoti i lokalit kish ndezur qirinjtë në çdo tryezë. U ul në tryezën pranë portës kryesore. Ndrigimi i dobët e tepër familjar i ndolli gjumë. Ishte lodhur shumë. Në mëngjes kish qenë në spital, pranë dajës së enjtur nga helmi i merimangavë. Pastaj kish shkuar në një korte të mërzitshëm. Tani këtu, në mbrëmjen festive, mes shqiptarëve, dhe mbase do ta mbyllte tek ai mitingu i zi. Jashtë u dë-

nin së shpejti në një nga poligonet e mëdha. Ralfit i hipën të rrëqethura kur kujtoi skenat, fotot dhe shifrat e librit «Stuhi zjarri në Hamburg», të cilin e kish shfletuar rastësisht ato ditë. Tmerret e luftës, bombardimet, shkatërrimet, viktimat e panumërta ai i shikonte qartë dhe forca e imagjinatës vepronte në ndërgjegjen e tij. «Këta pleq të çmendur, por dhe të tjerë, si shefi im për shembull, vuajnë dhe kanë një nostalgji të madhe për të shkuarën. Dhe më e rrezikshme është se ata janë të sëmurë agresivë, mendonte Ralfi. Ata besojnë se një ditë do ta marrin pushtetin dhe do të ringjallin kohën e kryqit të thyer.»

— Radhët tona po shtohen dita-ditës, — vazhdonte Fyhreri, — dhe akoma më shumë mëndo të shtohen. Atëherë na del si detyrë që të shpeshtojmë aksionet, sepse aksionet konkrete janë dielli që pjek frytet. Këto fryte nesër do t'i vjelim të sigurt e krenarë.

— Hail! Zig' hail!

— Hail Hitler!

Fyhreri hoqi për një çast maskën e Hitlerit dhe e vendosi mbi podium. Megjithëse në atë veprim kishte diçka qesharake deri në grotesk, salla thërriste me një solemnitet të rrallë. «Ku, vallë, i kanë ngulur sytë në këto çaste, mendoi Ralfi, te fytyra e Fyhrerit të gjallë, apo te maska e Fyhrerit të vdekur?» Në ato çaste skizofrenie patjetër që sytë e



tyre ishin prishur dhe në retinat e tyre ishte kryqëzuar përjetësisht Hitleri, idhulli i tyre. Fyhrer Fridhelmi mori maskën në dorën e djathtë dhe tërë pompozitet shkoi të ulëj në qendër të presidiumit.

«Po babai ku është?» — pyeti Ralfi gati me zë dhe kërkoi me sy në të gjithë sallën.

Ai nuk i kishte vënë re që në fillim gjes-tikulacionet e të atit, i cili kish zënë vend në qendër të sallës. Po tani që fjalimi kryesor kishte mbaruar, Zelen Shenkmani ishte ngritur në këmbë dhe i bënte shenjë të birit që të afrohej e të ulëj në një vend pranë tij. Ralfi e pa, po në atë kohë ndiente një turbullirë të çuditshme, i vinte për të vjellë, si ta kish zënë deti i tallazitur. Në një heshtje të menjëhershme pas bubullimës iu duk sikur dëgjoji një oshëtimë tjetër, madje më të fortë. Disa thirrje të fuqishme vinin nga jashtë.

Një rojë i armatosur hyri nga porta kryesore dhe u drejtua për nga presidiumi. drejt e te Fyhreri. Hitleri pa maskë qeshi. afroi mikrofonin dhe iu drejtua sallës:

— Qytetarët civilë po protestojnë për mbledhjen tonë. Kjo s'ka fare rëndësi. Ne do të vazhdojmë sipas programit.

Ralfit i merreshin mendtë. Ishte mes dy zjarresh. Kishte bërë gabim të madh që kishte ardhur mes këtyre të çmendurve. Dhe e keqja ishte se edhe nuk mund të dilte përpara atyre të tjerëve, qytetarëve të ndershëm,